

**GJYKATA E APELIT  
PRISHTINË**

NË EMËR TË POPULLIT

---

**Numri i lëndës:**                   **PAKR 52/14**  
**Më:**                                   **6 nëntor 2015**

**Gjykata Themelore:**           **Prishtinë, P 309/10 & 340/10**

Origjinali: **anglisht**

---

Gjykata e Apelit, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari Gjykatës së Apelit të EULEX-it Radostin Petrov, kryetar dhe gjyqtar raportues, gjyqtarja kosovare e Gjykatës së Apelit Mejreme Memaj dhe gjyqtari i Gjykatës së Apelit të EULEX-it Dariusz Sielicki, anëtarë të kolegjit, të asistuar nga zyrtarët ligjorë të EULEX-it Dr. Bernd Franke dhe Alan Vasak, në cilësinë e procesmbajtësve,

Në lëndën lidhur me të pandehurit:

L. D.

Emri i të atit:

Emri dhe mbiemri i vajzërisë së ëmës:

Numri personal i letërnjoftimit:

Kombësia:

Shtetas:

Data e lindjes :

Vendi i lindjes :

Vendi i B.mit :

Gjendja familjare:

Profesioni :

Niveli A.or:

Të ardhurat vjetore:

Gjendja financiare :

Procedurë tjetër gjyqësore :

Masa e paraburgimit:

H. D.

E. M.

shqiptar kosovar

Kosovar

Prishtinë

nuk ka

Nuk është në paraburgim

A. D.

Emri i të atit: L. D.  
Emri dhe mbiemri i vajzërisë së ëmës: V. S.  
Numri personal i letërnjoftimit:   
Kombësia: shqiptar kosovar  
Shtetas: Kosovar  
Data e lindjes :   
Vendi i lindjes :   
Vendi i B.mit : Prishtinë  
Gjendja familjare::   
Profesioni :   
Niveli A.or:   
Të ardhurat vjetore:   
Gjendja financiare :   
Procedurë tjetër gjyqësore :   
Masa e paraburgimit: Nuk është në paraburgim

S. H.

Emri i të atit: R. H.  
Emri dhe mbiemri i vajzërisë së ëmës: S. S.  
Numri personal i letërnjoftimit:   
Kombësia: shqiptar kosovar  
Shtetas: Kosovar  
Data e lindjes :   
Vendi i lindjes :   
Vendi i B.mit : Prishtinë  
Gjendja familjare::   
Profesioni :   
Niveli A.or:   
Të ardhurat vjetore:   
Gjendja financiare :   
Procedurë tjetër gjyqësore : nuk ka  
Masa e paraburgimit: Nuk është në paraburgim

I. B.

Emri i të atit: I. B.  
Numri personal i letërnjoftimit:   
Kombësia: shqiptar kosovar  
Shtetas: Kosovar  
Data e lindjes :   
Vendi i lindjes :

Vendi i B.mit :   
Gjendja familjare::   
Profesioni :   
Niveli A.or:   
Procedurë tjetër gjyqësore : Nuk ka  
Masa e paraburgimit: Nuk është në paraburgim

S. D.

Emri i të atit: B. S.  
Numri personal i letërnjoftimit:   
Kombësia: shqiptar kosovar  
Shtetas: Kosovar  
Data e lindjes :   
Vendi i lindjes :   
Vendi i B.mit : Prishtinë  
Gjendja familjare::   
Profesioni :   
Niveli A.or:   
Procedurë tjetër gjyqësore : nuk ka  
Masa e paraburgimit: Nuk është në paraburgim

Të akuzuar nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) me aktakuzën e ndryshuar PPS 02/09, të datës 22 mars 2013, për këto vepra të mbetura penale:

*Pika 1*

Trafikim me njerëz, në kundërshtim me nenin 139 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK), vepër e dënueshme me burgim prej dy deri në dymbëdhjetë vjet, e kryer në bashkëkryerje, sipas nenit 23 të KPPK-së, kundër të pandehurve L. D., A. D. dhe S. H..

*Pika 2*

Krim i organizuar, në kundërshtim me nenin 274, par. 3, i KPPK-së, vepër e dënueshme me gjobë prej deri në 500 000 € dhe me burgim prej shtatë deri në njëzet vjet, e kryer në bashkëkryerje, sipas nenit 23 të KPPK-së, kundër të pandehurit L. D..

*Pika 3*

Krim i organizuar, në kundërshtim me nenin 274, par. 1, i KPPK-së, veprë e dënueshme me gjobë prej deri në 250 000 € dhe me burgim prej së paku shtatë vjetësh, kundër të pandehurve A. D. dhe S. H..

#### *Pika 7*

Lëndim i rëndë trupor, në kundërshtim me nenin 154 i KPPK-së, veprë e dënueshme me burgim prej 1 deri në 10 vjet apo me nenin tjetër or 5, veprë e dënueshme me burgim prej 6 muaj deri në 3 vjet, ose me nenin tjetër 1 (4), veprë e dënueshme me burgim prej 6 muaj deri në 5 vjet, e kryer në bashkëkryerje, sipas nenit 23 të KPPK-së, kundër të pandehurve L. D., S. H., I. B. dhe S. D..

Të gjykuar në shkallë të parë nga Gjykata Themelore në Prishtinë me aktgjykimin P 309/10 dhe 340/10, të datës 29 prill 2013, me të cilin:

Të pandehurit L. D. dhe A. D. janë shpallur fajtorë për pikën 1, kryerje e veprës penale trafikim me njerëz, në kundërshtim me nenin 139 KPK, e kryer në bashkëkryerje (Neni 23 KPK), duke qenë - thënë shkurtimisht - në lëndën kundër të pandehurit L. D., personalisht i përfshirë në shumë prej operacioneve të kundërligjshme të transplantimit në klinikën Medicus. Si pronar i kësaj klinike, ai ka qenë përgjegjës për mbarëvajtjen dhe funksionimin e tërësishëm të saj lidhur me transplantimet e veshkave; në lëndën kundër të pandehurit A. D., si menaxher i klinikës i njëjti ka pasur rolin qendror dhe ka qenë përgjegjës për aktivitetet e shumta që lidheshin me operacionet për transplantimin e kundërligjshëm të veshkave.

Pika 1, vepra penale Trafikim me njerëz, në kundërshtim me nenin 139 KPK, e kryer në bashkëkryerje (Neni 23 KPK), kundër të pandehurit S. H. është ri-cilësuar si mundësim nga pakujdesia i veprës penale të trafikimit, në kundërshtim me nenin 139, par. 4, KPK dhe është refuzuar.

I pandehuri L. D. më tutje është shpallur fajtor për pikën 2, kryerje e veprës penale të krimit të organizuar, në kundërshtim me nenin 274, par. 3, KPK, duke - thënë shkurtimisht - e organizuar, nisur, mbikëqyrur dhe drejtuar aktivitetin e gjithmbarshëm të kundërligjshëm nën pikën 1, në bashkëpunim me personat Dr. Y. S., M. H., A. D., Dr. K. D. dhe të tjerë, me qëllim të përfitimit të dobive pasurore financiare.

I pandehuri A. D. është shpallur fajtor për pikën 3, kryerje e veprës penale të krimit të organizuar, në kundërshtim me nenin 274, par. 1, KPK, duke qenë - thënë shkurtimisht - menaxher i klinikës Medicus dhe duke kryer aktivitetin e kundërligjshëm sipas pikës 1, me qëllim të përfitimit të dobive pasurore financiare.

I pandehuri S. H. është liruar nga Pika 3, vepra penale e krimit të organizuar, në kundërshtim me nenin 274, par. 1, KPK.

Pika 4, vepra penale ushtrim i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore, në kundërshtim me nenin 221, par. 1, KPK, e kryer në bashkëkryerje (Neni 23 KPK), kundër të pandehurve të pandehurit L. D., D. J., I. B., S. D. dhe S. H. është refuzuar.

Pika 5, vepra penale shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit, në kundërshtim me nenin 339, par. 1, KPK, kundër të pandehurit D. J. është ri-cilësuar lidhur me veprën Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit, në kundërshtim me nenin 339, par. 3, KPK dhe është refuzuar.

I pandehuri I. R. është liruar nga Pika 6, për veprën penale Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit, në kundërshtim me nenin 339, par. 1, KPK.

Pika 7, vepra penale Lëndim i rëndë trupor, në kundërshtim me nenin 154, par. 4, KPK, kundër të pandehurit L. D. është refuzuar. I pandehuri A. D. është liruar nga Pika 7, akuza për Lëndim të rëndë trupor, në kundërshtim me nenin 154, par. 1, nënpar. 2, KPK, e kryer në bashkëkryerje (Neni 23 KPK). Pika 7, vepra penale Lëndim i rëndë trupor e kryer në bashkëkryerje kundër të pandehurve të pandehurit S. H., I. B. dhe S. D. është ri-cilësuar sipas nenit 154, par. 1, nënpar. 2, KPK: si shkatërrim apo dobësim i përhershëm dhe substancial i një organi vital apo një pjese vitale të trupit të personit tjetër dhe të pandehurit janë shpallur fajtorë për këtë vepër penale, duke - thënë shkurtimisht – marrë pjesë me vetëdije në procedurat mjekësore të cilat ishin të kundërligjshme sipas ligjeve të Kosovës, përkatësisht në heqjen e veshkave për transplantim dhe me këtë duke e dobësuar në mënyrë të përhershme dhe substanciale një organ vital.

Pika 8, vepra penale e mashtrimit, në kundërshtim me nenin 261 KPK, kundër të pandehurve L. D. dhe A. D. është refuzuar.

Pika 9, vepra penale falsifikim i dokumenteve, në kundërshtim me nenin 332, par. 1, KPK, kundër të pandehurve të pandehurit L. D. dhe A. D. është refuzuar.

Pika 10, vepra penale falsifikim i dokumenteve zyrtare, në kundërshtim me nenin 348 KPK, kundër të pandehurve I. R. është refuzuar.

I pandehuri L. D. është dënuar me 8 (tetë) vjet burgim dhe me gjobë prej € 10.000 (dhjetë mijë eurosh). Përveç kësaj, të pandehurit L. D. i është ndaluar ta ushtrojë profesionin e urologut në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjetësh duke filluar nga dita kur aktgjykimi ta ketë marrë formën e prerë.

I pandehuri A. D. është dënuar me 7 (shtatë) vjet e 3 (tre) muaj burgim dhe me gjobë prej € 10.000 (dhjetë mijë eurosh).

I pandehuri S. H. është dënuar me 3 (tre) vjet burgim. Përveç kësaj, të pandehurit S. H. i është ndaluar ta ushtrojë profesionin e anesteziologut në kohëzgjatje prej 1 (një) viti duke filluar nga dita kur aktgjykimi ta ketë marrë formën e prerë.

Të pandehurit S. D. dhe I. B. janë dënuar me nga 1 (një) vit burgim me kusht, i cili nuk do të ekzekutohet në qoftë se të pandehurit nuk kryejnë ndonjë vepër tjetër penale gjatë periudhës kohore prej 2 vjetësh.

Secilës nga palët e dëmtuara W1, W2, W3, PM, DS, AK si dhe Y. A. i është ndarë kompensim i pjesshëm për dëmet psikologjike dhe ato fizike të shkaktuara gjatë heqjes së veshkës në shumën prej € 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë eurosh) nga L. D. dhe A. D., të cilat do t'iu paguhen jo më vonë sesa 6 (gjashtë) muaj duke filluar nga dita kur aktgjykimi ta ketë marrë formën e prerë.

Aktvendim i posaçëm është marrë lidhur me konfiskimin e hapësirave të klinikës Medicus;

Duke i shqyrtuar ankesat e parashtuara nga PSKR-ja, nga mbrojtësi Linn Slattengren për të pandehurin L. D., nga mbrojtësi Petrit Dushi për të pandehurin A. D., nga mbrojtësi Ramë Gashi për të pandehurin S. H., nga mbrojtësi Ahmet Ahmeti për të pandehurin I. B. si dhe nga mbrojtësi Hilmi Zhitia për të pandehurin S. D.,

Pas shqyrtimit të përgjigjeve të dhëna nga PSRK-ja (vetëm lidhur me aktvendimin mbi konfiskimin), nga mbrojtësi Petrit Dushi për të pandehurin A. D., nga mbrojtësi Ramë Gashi për të pandehurin S. H. si dhe nga mbrojtësi Ahmet Ahmeti për të pandehurin I. B.,

Pas shqyrtimit të propozimit të bërë nga prokurori i shtetit i apelit,

Pas mbajtjes së seancës publike të Gjykatës së Apelit më 4 dhe më 5 nëntor 2015,

Pas këshillimit dhe votimit të mbajtur më 6 nëntor 2015,

Duke vepruar në përputhje me nenet 409, 410, 411, 415, 417, 420, 421, 423, 424, 426 dhe 427 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (KPPPK),

E merr këtë:

---

**A K T G J Y K I M**

---

**I. Pranohet pjesërisht ankesa nga mbrojtësi Linn Slattengren për të pandehurin L. D. kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës P 309/10 & 340/10 të datës 29 prill 2013, sa i përket vërtetimit të gjendjes faktike lidhur me numrin e transplantimeve të veshkave të cilat janë shtatë sosh e jo njëzet e katër, të gjitha të provuara se janë bërë në Klinikën Medicus, në organizimin kriminal të të cilave ka qenë i përfshirë i pandehuri L. D.. Pjesa tjetër e ankesës refuzohet si e pabazë.**

**II. Pranohet pjesërisht ankesa nga mbrojtësi Petrit Dushi për të pandehurin A. D. kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës P 309/10 & 340/10 të datës 29 prill 2013, sa i përket vërtetimit të gjendjes faktike lidhur me numrin e transplantimeve të veshkave të cilat janë shtatë sosh e jo njëzet e katër, të gjitha të provuara se janë bërë në Klinikën Medicus, në organizimin kriminal të të cilave ka qenë i përfshirë i pandehuri A. D.. Pjesa tjetër e ankesës refuzohet si e pabazë.**

**III. Pranohet pjesërisht ankesa nga mbrojtësi Ramë Gashi për të pandehurin S. H. kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës P 309/10 & 340/10 të datës 29 prill 2013, sa i përket vërtetimit të gjendjes faktike lidhur me numrin e transplantimeve të veshkave të cilat janë shtatë sosh e jo njëzet e katër, të gjitha të provuara se janë bërë në Klinikën Medicus, në organizimin kriminal të të cilave ka qenë i përfshirë i pandehuri S. H.. Pjesa tjetër e ankesës refuzohet si e pabazë.**

**IV. Pranohet ankesa nga mbrojtësi Ahmet Ahmeti për të pandehurin I. B. kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës P 309/10 & 340/10 të datës 29 prill 2013, ashtu që i pandehuri I. B. lirohet nga Pika 7, përkatësisht shkaktim i lëndimit të rëndë trupor duke kryer procedura të kundërligjshme mjekësore në cilësinë e anesteziologut, duke përfshirë në to heqjen e organeve (veshkave) dhe transplantimet.**

**V. Pranohet ankesa nga mbrojtësi Hilmi Zhitia për të pandehurin S. D. kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës P 309/10 & 340/10 të datës 29 prill 2013, ashtu që i pandehuri S. D. lirohet nga Pika 7, përkatësisht shkaktim i lëndimit të rëndë trupor duke kryer procedura të kundërligjshme mjekësore në cilësinë e anesteziologut, duke përfshirë në to heqjen e organeve (veshkave) dhe transplantimet.**

**VI. Pranohet pjesërisht ankesa nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës P 309/10 & 340/10 të datës 29 prill 2013, në pjesën ku i pandehuri S. H. dënohet për veprën penale Krim i organizuar, lidhur me veprën Trafikim me njerëz, në atë mënyrë që i pandehuri A. D. dënohet me një dënim më të lartë dhe ashtu që dënimet plotësuese do të fillojnë të zbatohen pasi të pandehurit ta kenë vuajtur dënimin e caktuar me burgim.**

**VII. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës P 309/10 & 340/10 i datës 29 prill 2013 ndryshohet si më poshtë:**

**Pika 7**

**I. B. dhe S. D. lirohen nga Pika 7, akuza për Lëndim të rëndë trupor, në kundërshtim me nenin 154 i KPPK-së,  
Për shkak se në bazë të nenit 390, par. 3, të KPPPK-së, nuk është provuar se të akuzuarit në fjalë e kanë kryer veprën penale me të cilën janë ngarkuar.**

**Pikat 1, 2 dhe 3**

**L. D. është fajtor për kryerjen e veprës penale Krim i organizuar, në kundërshtim me nenin 274, par. 3 i KPPK-së, lidhur me veprën Trafikim me njerëz në kundërshtim me nenin 139, par. 1 të Kodit Penal të Kosovës, të kryer në bashkëkryerje, sipas nenit 23 të KPK-së.**

**A. D. është fajtor për kryerjen e veprës penale Krim i organizuar, në kundërshtim me nenin 274, par. 1 i KPPK-së, lidhur me veprën Trafikim me njerëz në kundërshtim me nenin 139 të Kodit Penal të Kosovës, të kryer në bashkëkryerje, sipas nenit 23 të KPK-së.**

**S. H. është fajtor për kryerjen e veprës penale Krim i organizuar, në kundërshtim me nenin 274, par. 1 i KPPK-së, lidhur me veprën Trafikim me njerëz në kundërshtim me nenin 139 të Kodit Penal të Kosovës, të kryer në bashkëkryerje, sipas nenit 23 të KPK-së.**

**Kjo është ngase prokurori e ka provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se:**

**Më ose rreth datës 1 janar 2008 e deri më 4 nëntor 2008, Dr. L. D. në cilësinë e tij të kirurgut për transplantime dhe të pronarit të Klinikës Medicus, A. D. në cilësinë e drejtorit / menaxherit të Klinikës Medicus; Dr. S. H. në cilësinë e anesteziologut kryesor; si bashkë-konspirator në cilësinë e kirurgut për transplantime; si bashkë-konspirator në cilësinë e rekrutuesit dhe lehtësuesit; së bashku me një bashkë-konspirator në cilësinë e kirurgut për transplantime; dhe të tjerët, kanë rekrutuar, transportuar, transferuar, strehuar dhe pranuar persona prej shteteve të tjera brenda në Kosovë me qëllim të heqjes së organeve (veshkave) të tyre në Klinikën Medicus dhe transplantimin e këtyre organeve në pranuesit që ishin në pritje.**



**L. D., si pronar i Klinikës Medicus, ka qenë përgjegjës për mbarëvajtjen dhe funksionimin e tërësishëm të klinikës në fjalë lidhur me transplantimet e kundërligjshme të veshkave. Ai ka qenë personalisht i përfshirë në shumë prej operacioneve të përmendura më poshtë, për transplantimin e kundërligjshëm të veshkave.**

**A. D., në cilësinë e menaxherit të klinikës në fjalë, ka qenë përgjegjës për shumë aktivitete të domosdoshme të cilat lidheshin me operacionet për transplantimin e kundërligjshëm të veshkave në Klinikën Medicus, duke i përfshirë këto: aranzhimin e bartjes së dhuruesve dhe pranuesve të organeve nga aeroporti i Prishtinës në Klinikën Medicus si dhe kthimin e tyre në aeroport e në disa raste duke i bartur personalisht ata; drejtimin e të gjitha aktiviteteve logjistike për operacionet e transplantimit, siç është caktimi dhe sigurimi i pajisjeve të duhura mjekësore; nënshkrimi dhe dërgimi i ftesave me shkrim dhuruesve dhe pranuesve të organeve me qëllim të mundësimit të hyrjes së tyre brenda në Kosovë; asistenca financiare dhe dhënia e faturave të pagesës në disa raste; mbajtja nga afër e kontaktit me një bashkë-konspirator sa iu përket përgatitjeve logjistike; dhe angazhimi në aktivitete tjera përkatëse në klinikë, siç është mbajtja e kontabilitetit. Të gjitha këto aktivitete janë kryer me qëllim të kryerjes së operacioneve për transplantimin e kundërligjshëm të veshkave në Klinikën Medicus.**

**S. H., si anesteziologu kryesor në Klinikën Medicus, ka bashkëvepruar me shumicën nëse jo me të gjithë dhuruesit dhe pranuesit të cilët kanë qenë të përfshirë në të 7 operacionet për transplantimin e veshkave, gjatë përgatitjes së tyre për ndërhyrje kirurgjike, prandaj e ka ditur se të gjithë ata kanë qenë shtetas të huaj. Vetë ky fakt i çuditshëm, është dashur më së paku, t'ia ngre dyshimin se klinika në fjalë ishte duke u marrë me trafikim. Ai po ashtu ka marrë pjesë në secilën prej këtyre operacioneve kirurgjike, prandaj më së paku, është dashur ka dijë se operacionet për transplantim të organeve kanë qenë të kundërligjshme në Kosovë dhe se klinika në fjalë nuk ka pasur licencë apo autorizim për të kryer operacione të tilla.**

**Duke filluar në vitin 2008, persona të shumtë ishin rekrutuar nëpër shtete të huaja, ishin transportuar në Kosovë, ishin bartur nga aeroporti i Prishtinës në Klinikën Medicus, ishin pranuar në klinikë dhe pastaj ishin strehuar në klinikë, të gjithë me qëllim të shfrytëzimit të tyre duke ua hequr veshkat dhe duke i transplantuar këto veshka tek pranuesit në pritje. Dhuruesit kanë qenë të gjitha viktimat të abuzimit të pozitës së tyre të ndjeshme si pasojë e rrethanave jashtëzakonisht të vështira financiare, e në disa raste po ashtu edhe viktimat të shtrëngimit, të mashtrimit dhe / ose të hileve ndaj tyre. Një veprim i këtillë bie në kundërshtim me nenin 139 (1) dhe (8), nënpar. 1 dhe 2 të KPK-së.**

Në pajtim me nenin 139, par. 8, nënpar. 3 të KPK-së, marrja e pëlqimit nga viktima e trafikimit me synim të shfrytëzimit të tij është e parëndësishme për qëllime të nenit 139, par. 1 të KPK-së.

Duke filluar nga marsi i vitit 2008 e deri në nëntor të vitit 2008, heqja e organeve në Klinikën Medicus nga dhuruesit dhe transplantimi i këtyre organeve tek pranuesit në pritje, ka ndodhur në 7 raste të ndara, në secilin prej të cilëve kanë qenë të përfshirë dhuruesi dhe pranuesi, siç do të përshkruhet në vazhdim në mënyrë kronologjike.

Dhuruesit e përfshirë kanë dhënë dëshmitë e tyre në shqyrtimin gjyqësor dhe është provuar se kanë qenë viktima të abuzimit të pozitës së ndjeshme të tyre e në disa raste kanë qenë edhe viktima të shtrëngimit, të mashtrimit ose të hileve ndaj tyre si dhe janë shfrytëzuar duke ua hequr veshkat, në kuptim të nenit 139.

- (1) Më 15 maj 2008, grupi i kirurgëve dhe anesteziologëve, i përbërë nga Dr. L. D., Dr. S. H. dhe bashkë-konspiratorët e tyre kanë kryer operacionin për heqjen e veshkës nga viktima dhuruese Dëshmitarja e mbrojtur “W2”. Dëshmitares së mbrojtur “W2” i ishin premtuar 15,000 \$ (dollarë amerikanë) në këmbim të veshkës por i njëjti kishte pranuar vetëm 12,000 \$. Dëshmitarja e mbrojtur “W2” kishte imigruar në Izrael nga ish-Bashkimi Sovjetik në vitin 2007 dhe ishte në pozitë të vështirë financiare. Ajo ishte viktimë e abuzimit me pozitën e saj të vështirë financiare si dhe viktimë e mashtrimit. Nuk është vërtetuar se sa para ka paguar pranuesi “S.” për këtë transplantim të organit;
- (2) Më 19 qershor 2008, grupi i kirurgëve dhe anesteziologëve, i përbërë nga Dr. L. D., Dr. S. H. dhe bashkë-konspiratorët e tyre kanë kryer operacionin për heqjen e veshkës nga viktima dhuruese Dëshmitari i mbrojtur “W1”, dhe pastaj transplantimin e organit (veshkës) tek pranuesi. Dhuruesi viktimë e kishte parë në media një reklamë ku premtoheshin 12,000 \$ si pagesë për dhurimin e veshkës. Dhuruesi viktimë kishte pësuar vuajtje të konsiderueshme fizike dhe psikologjike dhe gjendja e tij shëndetësore i ishte përkeqësuar pas operacionit si pasojë e keqfunksionimit të veshkës së mbetur dhe e komplikimeve post-operative;
- (3) Më 24 korrik 2008, grupi i kirurgëve dhe anesteziologëve, i përbërë nga Dr. L. D., Dr. S. H. dhe bashkë-konspiratorët e tyre kanë kryer operacionin për heqjen e veshkës nga viktima dhuruese Dëshmitarja e mbrojtur “W3,” dhe pastaj transplantimin e organit (veshkës) tek pranuesi. Hetimet kishin

vërtetuar se operacionin për transplantimin e veshkës ishte bërë në këtë datë; megjithatë, prokurori nuk ka mundur ta lidhë viktimën dhuruese me pranuesin e organit. Dëshmitarja e mbrojtur “W3” kishte qenë në vështirësi financiare dhe kishte imigruar në Izrael nga ish-Bashkimi Sovjetik. Asaj i ishin ofruar 10,000 € përmes një shpalljeje në gazetë për ‘dhurimin’ e një veshke, prandaj ajo kishte ra viktimë e abuzimit të vështirësive të saj financiare. Bashkë-konspiratorët i kishin bërë përgatitjet e nevojshme që ajo të udhëtojë për Prishtinë për procedurën e heqjes së veshkës. E njëjta ishte paguar në emër të shumës së barasvlershme prej 10,000 \$ në valutën euro (8100 apo 8200 €);

- (4) Më 9 shtator 2009, grupi i kirurgëve dhe anesteziologëve, i përbërë nga Dr. S. H. dhe bashkë-konspiratorët e tyre kanë kryer operacionin për heqjen e veshkës nga viktima dhuruese “PM”, dhe pastaj transplantimin e organit (veshkës) tek pranuesi. Viktima dhuruese ishte duke u përballur me vështirësi të rënda financiare në vitin 2008 për shkak të gjendjes së tij familjare prandaj ra viktimë e abuzimit me vështirësitë e tij financiare. Pas një reklame që e kishte parë një faqe ruse të internetit, ai kishte kontaktuar me një person të panjohur i cili i kishte premtuar pagesën e një shume prej 30,000 \$ për dhurimin e një veshke. Ai është bindur që të shkojë në Stamboll për testim të mëtejshëm ku u takua me një bashkë-konspirator i cili ishte duke i bërë përgatitjet për një operacion transplantimi në Kosovë. Pas operacionit ai i kishte pranuar personalisht 1000 \$ nga vëllai i pranuesit. Dëshmitari i mbrojtur ‘PM’ kishte pasur vuajtje të mëdha pas operacionit dhe ishte penduar pse ishte pajtuar ta jepte veshkën. Viktima dhuruese nuk kishte pranuar kurrfarë pagese për organin (veshkën) e hequr në Klinikën Medicus dhe kishte rënë viktimë e mashtrimit.
- (5) Më 21 tetor 2008, grupi i kirurgëve dhe anesteziologëve, i përbërë nga Dr. S. H. dhe bashkë-konspiratorët e tyre kanë kryer operacionin për heqjen e veshkës nga viktima dhuruese “DS,” shtetas i Kazakistanit, dhe pastaj transplantimin e organit (veshkës) tek pranuesi. Viktima dhuruese i ishte nënshtruar procedurës në fjalë pasi që kishte probleme të rënda familjare dhe financiare si prind i vetëm dhe kishte rënë viktimë e abuzimit me pozitën e tij të vështirë financiare. Ai ishte bindur nga një njeri me emrin Y., i cili ishte gjoja vetë viktimë dhuruese e veshkës së transplantuar, që ta hiqte veshkën në Kosovë në këmbim të shumës prej 20,000 \$. Pasi i ishte nënshtruar ndërhyrjes kirurgjike për heqjen e veshkës ai e kishte pranuar vetëm shumën prej 6,000 \$ si dhe premtimin për më shumë para vetëm nëse do të rekrutonte të tjerë “dhurues” të veshkave, duke rënë kështu viktimë e mashtrimit të radhës.

Derisa ishte në klinikë, i njëjti nuk ishte informuar për pasojat e heqjes së veshkës dhe ishte shtrënguar nga A. D. t'i nënshkruante dokumentet e dhënies së pëlqimit, të cilat nuk i kuptonte. Nuk është mundur të vërtetohet nga hetimet se çfarë shumash të parave janë paguar nga pranuesi i organit (veshkës) së transplantuar;

- (6) Më 26 tetor 2008 grupi i kirurgëve dhe anesteziologëve, i përbërë nga Dr. S. H. dhe bashkë-konspiratorët e tyre kanë kryer operacionin për heqjen e veshkës nga viktima dhuruese “AK”, dhe pastaj transplantimin e organit (veshkës) tek pranuesi. Viktima dhuruese i ishte nënshtruar heqjes së veshkës në këmbim të kryerjes së studimeve dhe ndihmës ndaj babait të sëmurë dhe kishte rënë viktimë e abuzimit me pozitën e vështirë financiare. Ai e kishte parë në internet një reklamë dhe përmes dy ndërmjetësve, Y. dhe J. (Y.), i ish in ofruar 10,000 € në këmbim të veshkës. Pas operacionit, megjithatë, i njëjti kishte pranuar vetëm 8,000 \$ si dhe premtimin se pjesën tjetër të parave të mbetura borxh do ta merrte vetëm pasi të kishte rekrutuar ‘dhurues’ të tjerë të veshkave. Në fund, i ish in paguar edhe 500 \$ në emër të borxhit të pashlyer dhe ishte kërcënuar nga i njëjti person ndërmjetësues me emrin J. që nëse nuk do ta mbante gojën mbyllur do të vuante pasoja të rënda. Kështu, edhe ky kishte rënë viktimë e mashtrimit.
- (7) Më 31 tetor 2008 grupi i kirurgëve dhe anesteziologëve, i përbërë nga Dr. L. D., Dr. S. H. dhe bashkë-konspiratorët e tyre kanë kryer operacionin për heqjen e veshkës nga viktima dhuruese Y. A., dhe pastaj transplantimin e organit (veshkës) tek pranuesi B. S.. Anëtarët e familjes së pranuesit të veshkës, Dëshmitari i mbrojtur “A3” dhe Dëshmitari i mbrojtur “A4” e kanë konfirmuar se B. S. i kishte paguar 90,000 € për operacionin e transplantimit të veshkës. Këto para ishin transferuar në xhirollogarinë bankare të një bashkë-konspiratori në Turqi. Viktima dhuruese Y. A. ishte rekrutuar në Stamboll përmes një ndërmjetësuesi, i cili i kishte garantuar se do t'i merrte 20,000 \$ për veshkën, duke rënë kështu viktimë e abuzimit me gjendjen e tij të rëndë financiare. Aranzhimi i udhëtimit të tij deri në klinikën në Prishtinë ishte drejtuar nga një bashkë-konspirator. Pas ndërhyrjes kirurgjike, si dhe në kohën e zhvillimit të seancës së posaçme dëgjimore, viktima dhuruese nuk kishte pranuar kurrfarë parash në këmbim të veshkës së tij, duke rënë kështu viktimë e mashtrimit.

Dhe në këtë mënyrë

Prej ose rreth datës 1 janar 2008 deri më 4 nëntor 2008 në Klinikën Medicus, Dr. L. D., në cilësinë e kirurgut të transplantimit dhe pronarit të Klinikës Medicus, me përgjegjësi të plotë për funksionimin e klinikës, i ka organizuar, i ka nisur, i ka mbikëqyrë, i ka menaxhuar dhe i ka drejtuar aktivitetet e grupit të organizuar kriminal, të cilat kanë ndodhur në Klinikën Medicus. Grupi i organizuar kriminal ka qenë grup i strukturuar i përbërë prej tre a më shumë personash, duke përfshirë në të L. D., A. D., S. H. dhe të tjerë. Grupi në fjalë ka ekzistuar për së paku disa muaj gjatë vitit 2008 dhe nuk është formuar rastësisht për kryerjen aty për aty të një vepre penale. Ky grup është formuar me synimin për të kryer një a më shumë krime të rënda në mënyrë të vazhdueshme, në veçanti trafikim me njerëz, në kundërshtim me nenin 139 të KPK-së, me qëllim të përfitimit në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë të të mirave financiare apo dobive të tjera pasurore, përmes heqjes së organeve (veshkave) dhe transplantimit të tyre tek pranuesit që kishin paguar shuma të mëdha parash për veshkat e tyre.

Duke filluar nga marsi i vitit 2008 e deri në nëntorin e vitit 2008, heqja e organeve në Klinikën Medicus dhe transplantimi i tyre tek pranuesit është bërë në 7 raste të heqjes së organeve dhe transplantimit të tyre ashtu siç është specifikuar në përshkrimin e mësipërm të akuzës për trafikim në Pikën 1, të cilit përshkrim i referohemi edhe këtu. Ky aktivitet i kundërligjshëm është zhvilluar nën organizimin, fillimin, mbikëqyrjen dhe drejtimin e plotë të L. D., duke vepruar në bashkëpunim me personat tjerë të përmendur me emra si më lart.

Dr. L. D. dhe grupi i organizuar kriminal ka përfituar të mira financiare dhe dobi të tjera pasurore, duke përfshirë këtu edhe pagesat në para të gatshme të bëra drejtpërdrejt në Klinikën Medicus dhe/apo personave të tjerë nga pranuesit e organeve (veshkave) duke i përfshirë por pa u kufizuar vetëm në këto pagesa në para të gatshme:

- (1) Nga dëshmitari i mbrojtur "T3" shumën prej 100,000 \$
- (2) Nga dëshmitari i mbrojtur "T4" shumën prej 70,000 €
- (3) Nga dëshmitari i mbrojtur M2 shumën prej 108,000 \$
- (4) Nga dëshmitari i mbrojtur A1 shumën prej 79,000 €
- (5) Nga T. S. shumën prej 25,000 €
- (6) Nga R. F. shumën prej 80,000 €
- (7) Nga dëshmitari i mbrojtur "M1" shumën prej 77,000 €
- (8) Nga dëshmitari i mbrojtur "T2" shumën prej 90,000 €

Si dhe

**Prej ose rreth datës 1 janar 2008 deri më 4 nëntor 2008 në Klinikën Medicus, A. D., në cilësinë e drejtorit / menaxherit të Klinikës Medicus, me synimin për të kryer një a më shumë krime të rënda, ka kryer veprën penale trafikim me njerëz, në kundërshtim me nenin 139 të KPK-së, me qëllim të përfitimit në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë të të mirave financiare apo dobive të tjera pasurore, përmes heqjes së organeve (veshkave) dhe transplantimit të tyre tek pranuesit.**

**A. D. dhe grupi i organizuar kriminal ka përfituar të mira financiare dhe dobi të tjera pasurore duke përfshirë këtu edhe pagesat në para të gatshme të bëra drejtpërdrejt në Klinikën Medicus dhe/apo personave të tjerë nga pranuesit e organeve (veshkave):**

- (1) Nga dëshmitari i mbrojtur “T3” shumën prej 100,000 \$**
- (2) Nga dëshmitari i mbrojtur “T4” shumën prej 70,000 €**
- (3) Nga dëshmitari i mbrojtur M2 shumën prej 108,000 \$**
- (4) Nga dëshmitari i mbrojtur A1 shumën prej 79,000 €**
- (5) Nga T. S. shumën prej 25,000 €**
- (6) Nga R. F. shumën prej 80,000 €**
- (7) Nga dëshmitari i mbrojtur “M1” shumën prej 77,000 €**
- (8) Nga dëshmitari i mbrojtur “T2” shumën prej 90,000 €**

**Dhe**

**Prej ose rreth datës 8 mars 2008 deri më 4 nëntor 2008 në Klinikën Medicus, Dr. S. H., duke qenë në cilësinë e anesteziologut, me vetëdije ka marrë pjesë në procedurat mjekësore të cilat kanë qenë kriminale dhe të kundërligjshme në bazë të ligjeve të Kosovës, përkatësisht heqjen e organeve (veshkave) për transplantim, dhe në këtë mënyrë ka kryer veprën penale trafikim me njerëz, në kundërshtim me nenin 139 të KPK-së, me qëllim të përfitimit në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë të të mirave financiare apo dobive të tjera pasurore, përmes heqjes së organeve (veshkave) dhe transplantimit të tyre tek pranuesit.**

**S. H. dhe grupi i organizuar kriminal ka përfituar të mira financiare dhe dobi të tjera pasurore duke përfshirë këtu edhe pagesat në para të gatshme të bëra drejtpërdrejt në Klinikën Medicus dhe/apo personave të tjerë nga pranuesit e organeve (veshkave):**

- (1) Nga dëshmitari i mbrojtur “T3” shumën prej 100,000 \$**

- (2) Nga dëshmitari i mbrojtur "T4" shumën prej 70,000 €
- (3) Nga dëshmitari i mbrojtur M2 shumën prej 108,000 \$
- (4) Nga dëshmitari i mbrojtur A1 shumën prej 79,000 €
- (5) Nga T. S. shumën prej 25,000 €
- (6) Nga R. F. shumën prej 80,000 €
- (7) Nga dëshmitari i mbrojtur "M1" shumën prej 77,000 €
- (8) Nga dëshmitari i mbrojtur "T2" shumën prej 90,000 €

### Dënimet

Në bazë të nenit 6, 11, 15, par. 1, nenit 23, 274, par. 3 si dhe nenit 39, par. 1 dhe 2 të KPK-së, L. D. dënohet me 8 (tetë) vjet burgim dhe me gjobë prej 10,000 € (dhjetë mijë eurosh), e cila duhet të paguhet jo më vonë sesa gjashtë muaj pasi aktgjykimi ta ketë marrë formën e prerë.

Në bazë të nenit 6, 11, 15, par. 1, nenit 23, 274, par. 3 si dhe nenit 39, par. 1 dhe 2 të KPK-së, A. D. dënohet me 8 (tetë) vjet burgim dhe me gjobë prej 2,500 € (dy mijë e pesëqind eurosh), e cila duhet të paguhet jo më vonë sesa gjashtë muaj pasi aktgjykimi ta ketë marrë formën e prerë.

Në bazë të nenit 6, 11, 15, par. 1, nenit 23, 274, par. 3 si dhe nenit 39, par. 1 dhe 2 të KPK-së, S. H. dënohet me 5 (pesë) vjet burgim dhe me gjobë prej 2,500 € (dy mijë e pesëqind eurosh), e cila duhet të paguhet jo më vonë sesa gjashtë muaj pasi aktgjykimi ta ketë marrë formën e prerë.

Në bazë të nenit 57, par. 1 dhe 2 të KPK-së, L. D. ti ndalohet ushtrimi i profesionit të urologut në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjetësh duke filluar nga dita e vuajtjes së plotë të dënimit me burgim.

Në bazë të nenit 57, par. 1 dhe 2 të KPK-së, S. H. ti ndalohet ushtrimi i profesionit të anesteziologut në kohëzgjatje prej 1 (një) viti duke filluar nga dita e vuajtjes së plotë të dënimit me burgim.

**VIII. Pranohet ankesa e Linn Slattengren në emër të L. D. dhe të kompanive Klinika Kardiokirurgjike Medicus dhe Ordinanca Urologjike Medicus kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë P 309/10 & 340/10, të datës 25 nëntor 2013, pasi që nuk ka bazë për mbylljen dhe konfiskimin e hapësirave të Klinikës Medicus.**

**IX. Pranohet ankesa e F. I. në emër të subjektit ekonomik SHPK Qendra Mjekësore kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë P 309/10 & 340/10, të datës 25**

nëntor 2013, pasi që nuk ka bazë për mbylljen dhe konfiskimin e hapësirave të Klinikës Medicus.

**X. Refuzohet ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në P 309/10 & 340/10, të datës 25 nëntor 2013.**

**XI. Ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë P 309/10 & 340/10, i datës 25 nëntor 2013 në atë mënyrë që refuzohet si e pabazë kërkesa e prokurorit për konfiskimin e Klinikës Medicus, e datës 29 prill 2013.**

## A R S Y E T I M

---

### I. HISTORIKU I PROCEDURËS NË FJALË

#### A. Aktgjykimi

Më 12 nëntor 2008, është marrë aktvendimi mbi nisjen e hetimeve lidhur me veprat penale të cilat pretendohej se kanë ndodhur në vitin 2008, të cilat kishin të bënin me transplantimet e veshkave në Klinikën Medicus.

Më 15 tetor 2010, është ngritur aktakuza PPS 41/09, me të cilën L. D., A. D., D. J., I. R. dhe S. H. akuzoheshin për disa vepra penale. Më 21 tetor 2010, është ngritur aktakuza PPS 107/10, me të cilën I. B. dhe S. D. akuzoheshin me disa vepra penale. Të dyja këto aktakuza janë bashkuar në një aktakuzë të vetme më 29 nëntor 2010, e cila është konfirmuar nga kolegji prej tre gjyqtarëve më 27 prill 2011. Aktakuza pastaj është ndryshuar dhe është zgjeruar më 22 mars 2013 dhe më 17 prill 2013.

Aktakuza e plotë dhe përfundimtare përmban këto pika të aktakuzës:

#### Pika 1

Trafikim me njerëz, në kundërshtim me nenin 139 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK), vepër e dënueshme me dy deri në dymbëdhjetë vjet burgim, e kryer në bashkëkryerje, sipas nenit 23 të KPPK-së, kundër të pandehurve L. D., A. D. dhe S. H..

#### Pika 2



Krim i organizuar, në kundërshtim me nenin 274, par. 3, i KPPK-së, vepër e dënueshme me gjobë prej deri në 500.000 € dhe me shtatë deri në njëzet vjet burgim, e kryer në bashkëkryerje, sipas nenit 23 të KPPK-së, kundër të pandehurit L. D..

#### Pika 3

Krim i organizuar, në kundërshtim me nenin 274 par. 1 i KPPK-së, vepër e dënueshme me gjobë prej deri në 250 000 € si dhe me së paku 7 vjet burgim, kundër të pandehurve A. D. dhe S. H..

#### Pika 4

Ushtrim i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore, në kundërshtim me nenin 221, par. 1 të KPPK-së, vepër e dënueshme me gjobë apo me burgim deri në një vit, e kryer në bashkëkryerje, sipas nenit 23 të KPPK-së, kundër të pandehurve L. D., D. J., I. B., S. D. dhe S. H.

#### Pika 5

Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit, në kundërshtim me nenin 339, par. 1 të KPPK-së, vepër e dënueshme me burgim prej një deri në tetë vjet burgim, kundër të pandehurit D. J.

#### Pika 6

Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit, në kundërshtim me nenin 339, par. 1 të KPPK-së, vepër e dënueshme me burgim prej një deri në tetë vjet burgim kundër të pandehurit I. R.

#### Pika 7

Lëndim i rëndë trupor, në kundërshtim me nenin 154 të KPPK-së, vepër e dënueshme me burgim prej 1 deri në 10 vjet burgim ose sipas nenit tjetër 5, vepër e dënueshme me 6 muaj deri në 3 vjet burgim ose sipas nenit tjetër 1 (4), vepër e dënueshme me 6 muaj deri në 5 vjet burgim, e kryer në bashkëkryerje, sipas nenit 23 të KPPK-së, kundër të pandehurve L. D., S. H., I. B. dhe S. D.

#### Pika 8

Mashtrim, në kundërshtim me nenin 261 të KPPK-së, vepër e dënueshme me 6 muaj deri në 5 vjet burgim kundër të pandehurve L. D. dhe A. D.

#### Pika 9

Falsifikim i dokumenteve, në kundërshtim me nenin 332, par. 1 të KPPK-së, vepër e dënueshme me gjobë apo me burgim deri në një vit kundër të pandehurve L. D. dhe A. D.

#### Pika 10

Falsifikim i dokumenteve zyrtare, në kundërshtim me nenin 348 të KPPK-së, veprë e dënueshme me tre muaj deri në tre vjet burgim kundër të pandehurit I. R.

Më 4 tetor 2011, kanë filluar seancat dëgjimore të shqyrtimit gjyqësor, të hapura për publikun dhe kanë vazhduar më datat 5, 6, 11, 12, 18, 19, 20 dhe 25 tetor 2011; pastaj më 9, 10, 15, 17, 22, 23, 29 dhe 30 nëntor 2011; më 19, 20 dhe 21 dhjetor 2011; më 6 dhe 13 shkurt 2012; më 16, 22 dhe 23 mars 2012; më 4 dhe 5 prill 2012; më 10, 18 dhe 24 maj 2012; më 13, 14, 18, 19, 20 dhe më 21 qershor 2012; më 24 korrik 2012; më 4, 6, 7, 11, 13 dhe më 25 shtator 2012; më 9 tetor 2012; më 14, 16 dhe 26 nëntor 2012; më 5 dhjetor 2012; më 29 janar 2013; më 11, 12 dhe 26 shkurt 2013; më 1, 8, 22, 27 dhe 29 mars 2013; më 2, 3, 5, 10, 12, 16, 17, 19, 23 dhe 24 prill 2013. Aktgjykimi është shpallur më 29 prill 2013 në gjykim të hapur.

Të pandehurit L. D. dhe A. D. janë shpallur fajtorë për Pikën 1, kryerje e veprës penale Trafikim me njerëz, në kundërshtim me nenin 139 të KPPK-së, e kryer në bashkëkryerje (sipas nenit 23 të KPPK-së), duke - thënë shkurtimisht - në lëndën kundër të pandehurit L. D., qenë personalisht i përfshirë në shumë operacione të transplantimit të kundërligjshëm në Klinikën Medicus. Si pronar i klinikës në fjalë, ai ka qenë përgjegjës për mbarëvajtjen dhe funksionimin e përgjithshëm lidhur me transplantimin e kundërligjshëm të veshkave; në lëndën kundër të pandehurit A. D., si menaxher i klinikës në fjalë, ai ka pasur rolin qendror dhe ka qenë përgjegjës për shumë aktivitete lidhur me operacionet për transplantimin e kundërligjshëm të veshkave.

Pika 1, vepra penale Trafikim me njerëz, në kundërshtim me nenin 139 të KPPK-së, e kryer në bashkëkryerje (sipas nenit 23 të KPPK-së), kundër të pandehurit S. H. është ri-cilësuar si mundësim nga pakujdesia i veprës penale të trafikimit, në kundërshtim me nenin 139, par. 4, të KPPK-së dhe është refuzuar;

I pandehuri L. D. më tej është shpallur fajtor për Pikën 2, kryerje e veprës penale Krim i organizuar, në kundërshtim me nenin 274, par. 3, PKPK, duke - thënë shkurtimisht – organizuar, filluar, mbikëqyrur dhe menaxhuar tërë aktivitetin e kundërligjshëm nën Pikën 1, në bashkëpunim me personat Dr. Y. S., M. H., A. D., Dr. K. D. dhe të tjerë, me qëllim të përfitimit të dobive pasurore financiare;

I pandehuri A. D. është shpallur fajtor për pikën 3, kryerje e veprës penale Krim i organizuar, në kundërshtim me nenin 274, par. 1, PKPK, duke - thënë shkurtimisht – qenë menaxher i Klinikës Medicus dhe duke kryer veprimtari të kundërligjshme nën Pikën 1, me qëllim të përfitimit të dobive pasurore financiare;

I pandehuri S. H. është liruar nga Pika 3, përkatësisht nga akuza për veprën penale Krim i organizuar, në kundërshtim me nenin 274, par. 1, të KPPK-së;

Pika 4, vepra penale Ushtrim i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore, në kundërshtim me nenin 221, par. 1, të KPPK-së, e kryer në bashkëkryerje (sipas nenit 23 të KPPK-së), kundër të pandehurve L. D., D. J., I. B., S. D. dhe S. H. është refuzuar;

Pika 5, vepra penale Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit, në kundërshtim me nenin 339, par. 1, të KPPK-së, kundër të pandehurit D. J. është ri-cilësuar si Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit, në kundërshtim me nenin 339, par. 3, të KPPK-së dhe është refuzuar;

I pandehuri I. R. është liruar nga Pika 6, përkatësisht nga akuza për Shpërdorim të pozitës zyrtare ose të autorizimit, në kundërshtim me nenin 339, par. 1, të KPPK-së;

Pika 7, vepra penale Lëndim i rëndë trupor, në kundërshtim me nenin 154, par. 4, të KPPK-së, kundër të pandehurit L. D. është refuzuar. I pandehuri A. D. është liruar nga Pika 7, përkatësisht nga akuza Lëndim i rëndë trupor, në kundërshtim me nenin 154, par. 1, nënpar. 2, të KPPK-së, e kryer në bashkëkryerje (Sipas nenit 23 të KPPK-së). Pika 7, vepra penale Lëndim i rëndë trupor e kryer në bashkëkryerje kundër të pandehurve S. H., I. B. dhe S. D. është ri-cilësuar sipas nenit 154, par. 1, nënpar. 2, të KPPK-së: asgjësim apo dobësim i përhershëm dhe substancial i një organi vital apo i një pjese vitale të trupit të personit tjetër dhe të pandehurit janë shpallur fajtorë për këtë vepër penale, duke - thënë shkurtimisht – marrë pjesë me qëllim në procedurat mjekësore të cilat ishin të kundërligjshme në bazë të ligjeve të Kosovës, përkatësisht duke hequr veshka për transplantim dhe duke e dobësuar në kështu në mënyrë të përhershme dhe substanciale një organ vital;

Pika 8, vepra penale Mashtrim, në kundërshtim me nenin 261 të KPPK-së, kundër të pandehurve L. D. dhe A. D. është refuzuar;

Pika 9, vepra penale Falsifikim i dokumenteve, në kundërshtim me nenin 332, par. 1, të KPPK-së, kundër të pandehurve L. D. dhe A. D. është refuzuar;

Pika 10, vepra penale Falsifikim i dokumenteve zyrtare, në kundërshtim me nenin 348 të KPPK-së, kundër të pandehurit I. R. është refuzuar;

I pandehuri L. D. është dënuar me 8 (tetë) vjet burgim dhe me gjobë prej € 10.000 (dhjetë mijë eurosh). Përveç kësaj, të pandehurit L. D. i është ndaluar ushtrimi i profesionit të urologut në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjetësh duke filluar nga dita kur aktgjykimi ta ketë marrë formën e prerë;

I pandehuri A. D. është dënuar me 7 (shtatë) vjet e 3 (tre) muaj burgim dhe me gjobë prej € 10.000 (dhjetë mijë eurosh);

I pandehuri S. H. është dënuar me 3 (tre) vjet burgim. Përveç kësaj, të pandehurit S. H. i është ndaluar ushtrimi i profesionit të anesteziologut në kohëzgjatje prej 1 (një) viti duke filluar nga dita kur aktgjykimi ta ketë marrë formën e prerë;

Të pandehurit S. D. dhe I. B. janë dënuar me 1 (një) vit burgim, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në qoftë se të pandehurit nuk kryejnë ndonjë vepër tjetër penale në periudhën kohore prej 2 vjetësh;

Secilës prej palëve të dëmtuara W1, W2, W3, PM, DS, AK si dhe Y. A., i është ndarë kompensimi i pjesshëm për dëmin psikologjik dhe fizik, të shkaktuar gjatë heqjes së veshkës, në shumën prej 15,000 € (pesëmbëdhjetë mijë eurosh), i cili duhet të paguhet nga L. D. dhe nga A. D. jo më vonë sesa 6 (gjashtë) muaj duke filluar nga dita kur aktgjykimi ta ketë marrë formën e prerë;

Aktvendim i posaçëm është marrë lidhur me konfiskimin e objektit të Klinikës Medikus;

Aktgjykimi me shkrim i është dorëzuar të pandehurit L. D. më datën 6 dhjetor 2013, ndërsa mbrojtësit të tij Linn Slattengren më 29 nëntor 2013. I pandehuri, përmes mbrojtësit, ka ushtruar ankesë ndaj aktgjykit, të cilën e ka parashtruar më 13 dhjetor 2013.

Aktgjykimi i formës së shkruar i është dorëzuar të pandehurit A. D. më 6 dhjetor 2013 dhe avokatit të tij mbrojtës Petrit Dushi më 13 nëntor 2013. I pandehuri, përmes avokatit të tij, paraqiti ankesë ndaj aktgjykit më 19 nëntor 2013.

Aktgjykimi i formës së shkruar i është dorëzuar të pandehurit S. H. më 29 nëntor 2013 dhe avokatit të tij mbrojtës Fazli Balaj më 13 nëntor 2013. I pandehuri, përmes avokatit të tij, paraqiti ankesë ndaj aktgjykit më 26 nëntor 2013.

Aktgjykimi i formës së shkruar i është dorëzuar të pandehurit D. J. më 30 nëntor 2013 dhe avokatëve të tij mbrojtës Ismet Shufta dhe Aqif Tuhina më 25 nëntor 2013. I pandehuri nuk paraqiti ankesë ndaj aktgjykit.

Aktgjykimi i formës së shkruar i është dorëzuar të pandehurit I. R. më 30 nëntor 2013 dhe avokatit të tij mbrojtës Florin Vertopi më 12 nëntor 2013. I pandehuri nuk paraqiti ankesë ndaj aktgjykit.

Aktgjykimi i formës së shkruar i është dorëzuar të pandehurit I. B. më 4 dhjetor 2013 dhe avokatit të tij mbrojtës Ahmet Ahmeti më 12 nëntor 2013. I pandehuri, përmes avokatit të tij, paraqiti ankesë ndaj aktgjykimit më 19 nëntor 2013.

Aktgjykimi i formës së shkruar i është dorëzuar të pandehurit S. D. më 4 dhjetor 2013 dhe avokatit të tij mbrojtës Hilmi Zhitia më 27 nëntor 2013. I pandehuri, përmes avokatit të tij, paraqiti ankesë ndaj aktgjykimit më 4 dhjetor 2013.

Aktgjykimi i formës së shkruar i është dorëzuar prokurorisë më 25 nëntor 2013. Prokuroria paraqiti ankesë ndaj aktgjykimit më 10 dhjetor 2013.

Më 9 janar 2014, avokati mbrojtës Petrit Dushi për të pandehurin A. D. paraqiti një përgjigje ndaj ankesës së PSRK-së. Më 10 janar 2014, avokati mbrojtës Ramë Gashi për të pandehurin S. H. paraqiti një përgjigje ndaj ankesës së PSRK-së. Më 9 janar 2014, avokati mbrojtës Ahmet Ahmeti për të pandehurin I. B. paraqiti një përgjigje ndaj ankesës së PSRK-së.

#### B. Aktvendimi për konfiskim

Gjatë tërë periudhës prej 4 deri më 10 nëntor 2008, Klinika Medicus është kontrolluar dhe pastaj mbyllur. Më 31 dhjetor 2008, pas pranimit të kërkesës nga avokati mbrojtës i Dr. T. P. për ta kthyer çelësin e klinikës apo të lëshojë një vendim të ankimueshëm, PSRK-ja lëshoi një vendim që pohon se çelësi duhet përkohësisht të qëndrojë i konfiskuar nën ruajtjen dhe kontrollin e prokurorit publik.

Më 15 janar 2009, PSRK-ja dorëzoi një Kërkesë për Konfiskim dhe mbyllje të lokalit lidhur me klinikën duke kërkuar nga gjyqtari i procedurës paraprake ta urdhërojë konfiskimin e Klinikës Medicus si dhe ta urdhërojë mbylljen e klinikës. Parashtrësja është përsëritur më 10 shkurt 2009 dhe më 6 mars 2009 ku gjyqtari i procedurës paraprake urdhëroi mbylljen e klinikës.

“Raporti i njoftimit lidhur me mbylljen e Klinikës Medicus” të datës 31 mars 2009 theksonte se në të njëjtën ditë në prani të pronarit Dr. L. D. dhe avokatit të tij mbrojtës klinika është hapur, inspektuar dhe pastaj mbyllur përsëri duke i vendosur dy shenja në klinikë ku shkruante “Klinika Medicus është mbyllur”. Hyrja është mbyllur me shirit ngjites të provave të furnizuar nga policia e Kosovës. Si Dr. L. D. ashtu edhe avokati mbrojtës Mexhid Sylja e nënshkruan raportin.

Më 1 prill 2009, avokatët mbrojtës Bajram Tmava dhe Mexhid Sylja paraqitën ankesë ndaj Urdhrit duke kërkuar nga gjykata që ta aprovojë ankesën e tyre dhe ta lejojnë klinikën që t'i rifillojë aktivitetet e saj. Më 3 prill 2009, gjyqtari i procedurës paraprake e refuzoi ankesën mbi bazën se “ankesa është e lejueshme vetëm kundër aktgjykimeve dhe aktvendimeve, jo kundër urdhrave”. Më 16 maj 2009, avokatët mbrojtës dorëzuan një kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë

në Gjykatën Supreme duke i propozuar Gjykatës Supreme që ta anulojë Urdhrin e datës 6 mars 2009 si dhe aktvendimin pasues të gjyqtarit të procedurës paraprake. Më 1 qershor 2009, Gjykata Supreme e Kosovës e hodhi poshtë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë si të papranueshme.

Më 18 maj 2009, mbrojtja i dërgoi një propozim gjyqtarit të procedurës paraprake duke kërkuar një urdher për klinikat (Klinika Kardiokirurgjike Medikus dhe Ordinanca Urologjike Medikus) “që të hapen dhe të operojnë si klinika kirurgjike kardiake dhe urologjike gjatë procedurës penale në pritje”. Në propozim përmenden emrat e personave që mund t’i menaxhojnë aktivitetet e klinikave në rast se gjykata do t’i lejonte klinikat që të rihapen. Më 19 qershor 2009, PSRK-ja dorëzoi një propozim për ta refuzuar propozimin e mbrojtjes.

Më 24 gusht 2009, avokati mbrojtës Linn Slattengren e informoi PSRK-në se “ndërtesa e klinikës tash është rihapur” dhe kërkoi kthimin e gjërave të sekuestruara. Më 8 shtator 2009, PSRK-ja i përgjigj Slattengrenit duke iu referuar vendimit të Gjykatës të datës 6 mars 2009 dhe duke shpjeguar se “hapja e Klinikës Medikus nuk është autorizuar ende”. Më 18 shtator 2009, Slattengreni i shpjegoi PSRK-së se “As Dervishët e as unë nuk e kemi parë vendimin e pretenduar të 6 marsit [...]”. Në letrën e datës 20 tetor 2009, e regjistruar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë më 2 nëntor 2009, avokatët mbrojtës Bejtush Isufi dhe Linn Slattengren dorëzuan një propozim ku deklarorin se ata ende nuk kishin pranuar ndonjë urdher nga gjykata që urdhëron bastisje, konfiskime apo mbyllje në lidhje me klinikën. Avokati mbrojtës pohoi se e kanë njoftuar gjykatën, policinë dhe të tjerët se ndërtesa do të rihapej më 4 gusht, përveç nëse do të merrnin njoftim për të mos e rihapur. Nuk është pranuar asnjë njoftim dhe prandaj klinika është rihapur.

Më 2 dhjetor 2009, dy hetues të EULEX-it e vizituan klinikën për të parë “nëse po respektohej zbatimi i urdhrin të gjykatës lidhur me mbylljen e klinikës Medicus [...] të lëshuar më 6 mars 2009”. Me të arritur hetuesit vërejtën se dera kryesore ishte e hapur dhe nuk kishte dry në të. Sipas raportit të tyre, avokati i Dr. D., Z. Bajram Tmava deklaroi se ata “kishin vendosur ta rihapin klinikën dhe t’i fillojnë aktivitetet përsëri më datën 7 tetor 2009”. Sipas raportit, L. D. deklaroi se pas këshillës së Z. Linn Slattengren, i cili e kishte siguruar atë për ligjshmërinë e hapjes, ai kishte vendosur të hyjë në klinikë dhe të kryejë aktivitete mjekësore.

Më 8 dhjetor 2009, hetuesit e njëjtë përsëri e vizituan klinikën ku e takuan Dr. D. dhe ia dhanë dy kopjet e autorizimit të shkruan në Shqip dhe Anglisht dhe të lëshuar më 4 dhjetor 2009. Ata e njoftuan Dr. D. se ai i kishte 48 orë për t’i transferuar pacientët dhe për ta përgatitur klinikën me qëllim që ndërtesa të vihet në dispozicionin e policisë. Më 10 dhjetor 2009, në prani të Dr. D. klinika është mbyllur me qëllim të vazhdimin të zbatimit të urdhrin të gjykatës. Në hyrjen kryesore të klinikës ishin vendosur dy shenja të mbylljes. Me propozimin e datës 2 shkurt 2010, avokati mbrojtës Bejtush Isufi kërkoi nga gjykata që të lëshojë një aktvendim me të cilin duhet të anulohet Urdhri i datës 9 mars (në fakt 6 mars).

Më 10 shkurt 2010, gjyqtari i procedurës paraprake lëshoi një aktvendim sipas të cilit ai e refuzoi kërkesën për rihapjen e klinikave. Ai e urdhëroi prokurorin publik që ta rishikojë mbylljen para skadimit të hetimit që po vazhdonte. Gjyqtari i procedurës paraprake konstatoi se “aktvendimi i mëparshëm i gjyqtarit të procedurës paraprake i datës 6 mars 2009 është ende i vlefshëm dhe i zbatueshëm sa i përket Klinikës Medicus”.

Në ankesën e datës 15 shkurt 2010, avokati mbrojtës Bejtush Isufi dorëzoi një ankesë kundër aktvendimit të 10 shkurtit 2010. Ai kërkoi që “trupi gjykues të lëshojë një urdhër me të cilin e refuzon dhe e shfuqizon aktvendimin e gjyqtarit të procedurës paraprake dhe e hedh poshtë urdhrin e gjyqtarit të procedurës paraprake për t’i mbyllur klinikat”. Ankesa është vendosur nga një trup gjykues prej tre gjyqtarësh më 17 maj 2010. Trupi gjykues lëshoi aktvendimin sipas të cilit ankesa është refuzuar si e pabazuar.

Gjata fazave përfundimtare të shqyrtimit gjyqësor për të cilin aktgjykimi ishte shpallur më 29 prill 2013, Prokurori më 23 prill 2013 dorëzoi një raport që tregonte se klinika ishte rihapur. Sipas avokatit mbrojtës Slattengren, Dr. D. e kishte shitur klinikën në shkurt të vitit 2012 dhe dorëzoi në gjykatë një kontratë me shkrim sipas të cilës klinika ishte shitur më 16 shkurt 2012 për € 300.000. Më 12 qershor 2013, është mbajtur një dëgjim në prani të Kryetarit të trupit gjykues ku nga blerësi i pronës, F. I., është kërkuar ta shpjegojë historikun e blerjes. Gjatë seancës, blerësi shpjegoi se ai është duke e paguar ndërtesën me kiste dhe se ai kishte aplikuar për licencë praktikuese për klinikën, tani të quajtur “Medical Center”, e cila e filloi punën në prill 2013.

Më 29 prill 2013, PSRK-ja paraqiti një Kërkesë për konfiskimin e objektit të Klinikës Medikus.

Më 25 nëntor 2013, Gjykata Themelore e Prishtinës lëshoi Aktvendimin P 309/10, P340/10, duke urdhëruar mbylljen dhe konfiskimin e Klinikës Medicus, që vlen për pronarët e tanishëm dhe të ardhshëm të lokaleve.

Aktvendimi me shkrim i është dorëzuar të pandehurit A. D. më 6 dhjetor 2013 dhe avokatit të tij mbrojtës Petrit Dushi më 27 nëntor 2013. Aktvendimi me shkrim i është dorëzuar të pandehurit L. D. më 6 dhjetor 2013. I pandehuri L. D. dhe kompanitë Klinika Kardiokirurgjike Medikus dhe Ordinanca Urologjike Medicus, përmesa avokatit mbrojtës Linn Slattengren, paraqitën ankesë ndaj aktvendimit më 6 dhjetor 2013.

Aktvendimi me shkrim i është dorëzuar blerësit F. I. më 30 nëntor 2013. F. I. – pronari i “Graniti Com” Sh.p.k dhe “Medical Center” Sh.p.k paraqitën ankesë ndaj aktvendimit më datën 2 dhjetor 2013.

Aktvendimi me shkrim i është dorëzuar PSRK-së më 26 nëntor 2013. PSRK-ja paraqiti ankesë ndaj aktvendimit më 29 nëntor 2013.

### C. Gjykata e Apelit

Lënda është transferuar në Gjykatën e Apelit për vendimmarrje lidhur me ankesat më datën 28 janar 2014.

Më 19 shkurt 2014, prokurori shtetëror i apelit paraqiti një parashtresë.

Lënda i është ri-caktuar kryetarit të trupit gjykues/gjyqtarit raportues më 29 shtator 2014 por ai nuk qe në gjendje t'i ushtrrojë funksionet e veta gjyqësore deri në mars të vitit 2015, kur ai zyrtarisht u emërua nga Presidentja e Kosovës.

Seanca e Gjykatës së Apelit është mbajtur më 4 nëntor 2015 në prani të të pandehurve, avokatit të tyre mbrojtës dhe prokurorit shtetëror të apelit Claudio Pala.

Trupi gjykues shqyrtoi dhe votoi më 6 nëntor 2015.

## **II. FUSHËVEPRIMI I ANKESAVE**

Aktgjykimi i Gjykatës Themelore u bë i formës së prerë për të pandehurit D. J. dhe I. R., pasi që asnjëri nga të pandehurit e as prokurori nuk paraqitën ankesë në lëndën e tyre.

Të pandehurit L. D., A. D., S. H., I. B. dhe S. D. të gjithë paraqitën ankesë kundër aktgjykimit.

PSRK-ja paraqiti ankesë kundër aktgjykimit lidhur me Pikat 1 dhe 3 kundër të pandehurit S. H., lidhur me Pikën 7 kundër të pandehurit L. D. dhe lidhur me ndëshkimin e caktuar kundër të pandehurve L. D., A. D., S. H., I. B. dhe S. D..

Përveç ndëshkimeve të caktuara, këto Pika janë në pritje të ankesës:

Pika 1, kundër L. D., A. D. dhe S. H.

Pika 2, kundër L. D.

Pika 3, kundër A. D. dhe S. H.

Pika 7, kundër L. D., A. D., S. H., I. B. dhe S. D..



### III. ÇËSHTJET FILLESTARE

#### A. Ligji procedural i zbatueshëm në këtë lëndë

Më 1 janar 2013 hyri në fuqi një ligj i ri procedural në Kosovë – Kodi i Procedurës Penale, ligji nr. 04/L-123. Ky Kod e shfuqizoi të mëparshmin Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës. Neni 545 i Kodit aktual të Procedurës Penale përcakton se vendimi nëse duhet zbatuar këtë kod të procedurës penale bazohet në datën e ngritjes së aktakuzës. Veprat të cilat janë kryer para hyrjes në fuqi të këtij kodi i nënshtrohen këtij kodi nëse procedura penale për hetimin apo ndjekjen e asaj vepre është filluar pas hyrjes në fuqi të këtij Kodi.

Aktakuza në këtë lëndë fillimisht është ngritur në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë më 15 dhe 20 tetor 2010 dhe pastaj është bashkuar në një aktakuzë të vetme më 29 nëntor 2010, para hyrjes në fuqi të Kodit aktual të Procedurës Penale. Në përputhje me nenin 545 të Kodit aktual të Procedurës Penale, ligji i zbatueshëm procedural rrjedhimisht do të ishte Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës, pasi që gjykimi në këtë lëndë ka filluar para hyrjes në fuqi të Kodit të tanishëm. Gjykata e Apelit, rrjedhimisht, e ka zhvilluar procedurën në përputhje me Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës.

#### B. Kompetenca

Në përputhje me nenin 121, paragrafi 1, të KPPPK-së-së, trupi gjykues e ka shqyrtuar kompetencën e vet dhe meqë nuk janë ngritur kundërshtime formale nga palët, trupi gjykues do të mjaftohet si në vijim. Në përputhje me Ligjin për Gjykatat Ligjin për Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë – Ligji nr. 03/L-053 e ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-273 dhe e qartësuar përmes Marrëveshjes ndërmjet Shefit të EULEX-it në Kosove dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës të datës 18 qershor 2014, trupi gjykues konkludon se EULEX-i ka juridiksion për këtë lëndë dhe se trupi gjykues është kompetent që të vendos për lëndën përkatëse në përbërje të një gjyqtari të Kosovës dhe dy gjyqtarëve të EULEX-it.

#### C. Pranueshmëria e ankesave

##### *a. Ankesat e paraqitura nga PSRK-ja dhe avokati mbrojtës në emër të të pandehurve*

Ankesat e paraqitura nga PSRK-ja, avokati mbrojtës Linn Slattengren për të pandehurin L. D., avokati mbrojtës Petrit Dushi për të pandehurin A. D., avokati mbrojtës Ramë Gashi për të pandehurin S. H., avokati mbrojtës Ahmet Ahmeti për të pandehurin I. B. dhe avokati mbrojtës Hilmi Zhitia për të pandehurin S. D. janë të pranueshme. Ankesat janë paraqitur brenda afatit

prej 15 ditësh në përputhje me nenin 398 të KPPPK-së-së. Ankesat janë paraqitur nga personat e autorizuar dhe i përmbajnë të gjitha informatat tjera relevante në përputhje me nenet 399 dhe 401 KPPPK-së.

*b. Parashtrësa e paraqitur në emër të të pandehurit L. D.*

Trupi gjykues vëren se aktgjykimi i kundërshtuar i është dorëzuar të pandehurit L. D. më 6 dhjetor 2013. Aktgjykimi i kundërshtuar i është dorëzuar avokatit të tij mbrojtës Linn Slattengren më 29 nëntor 2013. Ankesa e paraqitur nga avokati mbrojtës Linn Slattengren në emër të të pandehurit L. D. është paraqitur më 13 dhjetor 2013. Ankesa fillestare rrjedhimisht është paraqitur brenda afatit prej 15 ditësh siç parashihet me nenin 398 të KPPPK-së-së. Megjithatë, parashtrësa e dorëzuar gjatë seancës më 4 nëntor 2015 nga avokati mbrojtës Linn Slattengren duhet të hidhet poshtë si e paafatshme sa i përket bazave të pohuara së fundmi për kundërshtimin e aktgjykimit, gjegjësisht anësinë gjyqësor të kryetarit të trupit gjykues. Këto baza nuk janë përfshirë në ankesën fillestare dhe prandaj janë paraqitur pas afatit.

#### **IV. PARASHTRËSAT E PALËVE**

A. Ankesa e avokatit mbrojtës Linn Slattengren për të pandehurin L. D.

Avokati mbrojtës Linn Slattengren më 13 dhjetor 2013 paraqiti ankesë më datën 10 dhjetor 2013 (dhe i plotësuar më datën 18 dhjetor 2015) në Gjykatën Themelore në emër të të pandehurit L. D. dhe kërkoi që Gjykata e Apelit ta refuzojë aktgjykimin si të pabazuar dhe ta lirojë të pandehurin nga të gjitha pikat e akuzës.

Në përmbledhje, mbrojtja argumenton si në vijim:

Gjykata Themelore nuk ka pasur juridiksion pasi që hetimi u mbyll më 8 maj 2009 pa aktakuzë. Gjyqtari hetues e hodhi poshtë hetimin dhe hetimi nuk ka mundur të vazhdohet ligjërisht pas kësaj. Hetimi ka mundur të rifillohet. Megjithatë, kjo është bërë ilegalisht me një procedurë të fshehtë gjyqësore pa asnjë njoftim për të pandehurin dhe pa mundësi për të paraqitur ankesë. Gjyqtari me të drejtë e refuzoi vërtetimin e aktakuzës dhe lëndën e hodhi poshtë. Kjo është kthyer gabimisht në apel. Trupi gjykues është përbërë në mënyrë të parregullt, duke parë se kryetari i trupit gjykues më parë ka vepruar si gjyqtar hetues në lëndë.

Për më tepër, në thelb të gjitha provat në këtë lëndë janë siguruar në mënyrë të paligjshme. Nuk ka pasur urdhër gjykatë gjatë kryerjes së bastisjes të Klinikës Medikus. Neni 240 i KPPPK-së prandaj është shkelur dhe provat e siguruara gjatë bastisjes janë siguruar në mënyrë të paligjshme dhe duhet të shpallen të papranueshme. Gjithashtu nuk ka pasur rrethana të ngutshme që do të ofronin një përjashtim për obligimin e urdhrin të gjykatës, sipas nenit 245. Sa i përket nenin 201

të KPPPK-së-së, mbrojtja argumenton se neni 201 vetëm i jep autoritet policisë që ta kryejë bastisjen dhe sekuestrimin e provave; megjithatë mënyra dhe dispozitat specifike që duhen ndjekur nga policia gjatë bastisjes dhe sekuestrimit janë përcaktuar në ligj. Këto dispozita janë shkelur qartazi. Po ashtu, Ligji për Inspektoratin Shëndetësor nuk e eliminon nevojën për urdhër apo përjashtim të justifikuar, e as nuk mund vendos kundër kushtetutës. Rrjedhimisht, të gjitha provat e siguruara gjatë bastisjes në Klinikën Medikus janë siguruar në mënyrë të paligjshme. Për më tepër, sipas doktrinës 'Fruta e Pemës Helmuese' të gjitha provat e siguruara në mënyrë dytësore si rezultat i bastisjes dhe sekuestrimit të paligjshëm duhet gjithashtu të shpallen të papranueshme.

Edhe nëse provat do të ishin siguruar ligjshëm, ato nuk janë dorëzuar si duhet në procedurën gjyqësore. Mbrojtja nuk ka informata se cilat prova i ka pranuar gjykata dhe cilat i ka marrë parasysh në aktgjykimin e saj. Prokuroria asnjëherë nuk ka përgatitur apo dorëzuar në gjykatë një inventar të gjërave të sekuestruara në klinikë, e as nuk ka paraqitur një listë me pika të provave të dorëzuara në gjykatë si provave.

Përveç kësaj, prokuroria i ka penguar provat. "Libri i Protokollit të Operacioneve Mjekësore", një libër që i mban të gjitha regjistrat zyrtarë të të gjitha operacioneve mjekësore, personelit pjesëmarrës dhe rezultatet e operacioneve, ishin penguar qëllimisht nga ana e prokurorisë. Kjo është posaçërisht e papranueshme pasi që i pandehuri L. D. pohon se libri do të tregojë se ai nuk është fajtor i veprave të pretenduara penale. Parimi i 'barazisë së palëve' të nenit 6 të KEDN-së rrjedhimisht është shkelur.

Edhe nëse të gjitha provat pranohen, është e qartë se i pandehuri L. D. nuk është fajtor për veprat e pretenduara penale.

Në rastin e tanishëm të gjithë dhuruesit e dinin se ata do ta dhuronin një veshkë. Arsyeja pse ata i dhuruan veshkat e tyre ishte sepse dëshironin t'i ndihmon personave që ishin duke vdekur dhe njëkohësisht që të fitojnë pak para për ta ndihmuar situatën e tyre financiare. Në të gjitha rastet, dhuruesit vet iu afroreshin ndërmjetësve. Prandaj, elementet e veprës penale të Trafikimit me Njerëz nuk janë plotësuar. Sidoqoftë, i pandehuri L. D. nuk ka folur me asnjërin nga pacientët dhe në rastet e rralla kur e ka takuar ndonjë person, ajo ka qenë thjeshtë kalim rutinor përveç kur ai ka asistuar në operacion kirurgjik për shpëtimin e jetës. I pandehuri L. D. nuk ka qenë në dijeni për ndonjë marrëveshje të bërë ndërmjet dhuruesve dhe Dr. S.it. Për më tepër, i pandehuri L. D. nuk ka asnjë lidhje me M. H., A., Z., S., Y., etj. Nuk ka prova që vërteton se i pandehuri L. D. ka qenë i përfshirë apo madje se ka ditur për tregtinë e organeve që po ndodhte jashtë Kosovës. Pra edhe nëse do të kishte rast të Trafikimit me Njerëz dhe Krim të Organizuar, i pandehuri L. D. nuk ka pasur rol në këtë dhe ai duhet të lirohet nga të gjitha akuzat.

Gjithashtu, transplantet e veshkave janë kryer në përputhje të plotë me ligjin e Kosovës, por edhe nëse ka pasur shkelje të nenit 46 të Ligjit Shëndetësor të Kosovës, duhet të ketë vetëm pasojë administrative dhe jo penale.

Në rast se gjykata, në kundërshtim me të gjitha provat, konkludon se i pandehuri L. D. në fakt ka kërcënuar, mashtruar apo shtrënguar ndonjë dhurues, ai qartazi nuk e ka bërë atë me qëllim të

shfrytëzimit. Nuk ka prova se i pandehuri L. D. ka pranuar ndonjë kompensim për transplantet. Në konkludim, i pandehuri duhet të lirohet nga të gjitha akuzat.

#### B. Ankesa e avokatit mbrojtës Petrit Dushi për të pandehurin A. D.

Avokati mbrojtës Petrit Dushi në emër të pandehurit A. D. ka paraqitur ankesë më datën 19 nëntor 2013 mbi baza të:

- Shkeljes substanciale të dispozitave të procedurës penale;
- Shkeljes së të drejtës penale;
- Vendimit ndëshkues dhe aprovimit të kërkesës pronësore juridike.

Mbrojtja parashtron se sipas nenit 396 të KPPPK-së-së gjykata është e obliguar të ofrojë arsyetim të qartë për secilën pikë të aktgjykimit, të paraqes në mënyrë të qartë dhe të plotë cilat fakte dhe për cilat arsye ajo i konsideron ato të vërtetuara apo të pavërtetuara, ta vlerësojë në mënyrë të posaçme korrektësinë e provave kundërshtuese; arsyet mbi të cilat janë bazuar zgjidhjet e çështjeve ligjore, në veçanti me rastin e konfirmimit të ekzistimit të një veprë penale, dhe përgjegjësinë penale të të akuzuarit, dhe ta ofrojë arsyetim lidhur me rrethanat që i ka marrë parasysh gjatë caktimit të dënimit. Gjykata duhet ta përshkruajë kapacitetin e provave, besueshmërinë, rëndësinë dhe vlerën dëshmuese të provave mbi të cilat aktgjykimi bazohet.

Mbrojtja pohon se këto obligime nuk janë përmbushur. Prandaj, aktgjykimi është i paligjshëm. Nga dispozitivi nuk mund të kuptohet se në çfarë mënyre i akuzuari ka qenë pjesëtar i një grupi dhe në çfarë mënyrë ai e ka kryer veprën penale. Është e paqartë se për çfarë arsye i pandehuri është shpallur fajtor. Sa i përket të pandehurit, aktgjykimi është në kundërtënie të plotë me pjesën tjetër të dispozitivit, në kundërtënie të plotë me arsyetimin e aktgjykimit dhe në kundërtënie të plotë me përmbajtjen e provave në të cilat bazohet aktgjykimi. Provat jo vetëm që nuk e mbështesin fajësinë e të pandehurit, por po ashtu fuqimisht e mbështesin pafajësinë e tij. Mbrojtja konstaton se e tërë bastisja në Klinikën Medikus ka qenë e paligjshme. Prandaj, provat e konfiskuara janë të papranueshme. Aktgjykimi bazohet në shkeljen e nenit 403 paragrafi 1 nën-paragrafi 8 i KPPPK-së. Të gjitha të ashtuquajturat provat e mbledhura nuk e kanë cilësinë e provave për faktin se një veprim i tillë është i ndaluar me dispozitën e nenit 153 paragrafi 1 të KPPPK-së-së ish kodit të procedurës penale të Kosovës. Në këtë kontekst, mbrojtja i referohet parimit *excessus in modo* (gabim në formularin e veprimit).

Për më tepër, dispozitivi nuk është i kuptueshëm dhe është në kundërtënie me vetveten, ndërsa arsyet e aktgjykimit janë të paqarta si dhe kundërtëne. Gjykata e ka shkelur nenin 403, paragrafi 1, nën-paragrafët 10 dhe 12; prandaj, mbrojtja beson se këto veprime janë shkelje absolute dhe e dëmtojnë klientin e tij. Ai konstaton se autoritetet të cilat kanë marrë pjesë në procedurën e zbatimit të ligjit nga fillimi i saj deri në shpalljen e aktgjykimit të ankimuar kanë bërë ashtu duke kryer shkelje substanciale të dispozitave penale të parapara në nenin 403

paragrafi 2, pikat 1 dhe 2. Gjykata është e obliguar që t'i konfirmojë në mënyrë të saktë dhe në tërësi faktet që janë të rëndësishme për të marrë një vendim të ligjshëm. Dyshimet duhet të interpretohen në dobi të të pandehurit (*in dubio pro reo*). Në vend të kësaj, ky parim nuk është i pranishëm në asnjë fazë të procedurës. Në të kundërtën, veprimet kanë qenë në disfavor të këtij parimi (*in dubio contra reum*). Në të gjitha dëgjimet në gjykatë, kryetari i trupit e gjykues ka intervenuar gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve. Mbrojtja e kundërshton paanësinë e trupit gjykues dhe thekson se është e paligjshme të favorizohet ndonjë pale.

Për më tepër, mbrojtja konstaton se dispozitivi i aktgjykimit është i paqartë sa i përket të pandehurit. Veprimet e tij nuk janë identifikuar qartë dhe nuk ka ndërlidhje ndërmjet veprimeve. Periudha kohore nuk mund të konsiderohet si periudhë inkriminuese dhe nuk ka lidhje shkakore të veprimeve të ndërsjella; prokurori vetëm e ka pretenduar dyshimin e bazuar se i pandehuri e ka kryer veprën penale. Megjithatë, prokuroria nuk ka arritur të dëshmojë qoftë me prova materiale qoftë me dëshmitë e dëshmitarëve se i pandehuri ka qenë i ashtuquajtur "personi kontaktues". I ka bazuar akuzat në shkëmbimin e mesazheve të telefonave mobil ("SMS") që nuk e përmbajnë thelbin e komunikimeve. Si të tilla, ato nuk e kanë cilësinë e provave dhe nuk mund të quhen veprime inkriminuese. Po ashtu, dëshmitë e dëshmitarëve të dhëna gjatë shqyrtimit gjyqësor janë në kundërtënie me kundërshtimet e bëra nga i pandehuri gjatë bastisjes së klinikës.

Sa i përket gjendjes faktike, mbrojtja nuk konteston se transplantimet janë kryer në Klinikën Medicus. Megjithatë, ai e kundërshton periudhën kohore të inkriminimit dhe veprimet konkrete të të akuzuarit. Shkeljet e përshkruara të dispozitave të procedurës penale kanë ndikim të drejtpërdrejtë në gjendjen faktike. Gjatë bastisjes, policia ka dështuar t'ia tregojë urdhrin për bastisje. Pastaj policia kërcënoi, sulmoi, dhe e prangosi atë dhe e detyroi të ulët në një karrige. Në stacion të policisë ai përsëri është shantazhuar dhe kërcënuar në forma të ndryshme. Edhe tani, i pandehuri nuk e di se për çka e kanë arrestuar dhe paraburgosur atë. I pandehuri deklaroi se ai i ka kryer aktivitetet e veta në klinikë në përputhje me ligjin në fuqi. Klinika ka qenë klinika e parë e licencuar në Kosovë, gjegjësisht klinika që i respektonte ligjet në fuqi. I pandehuri i ka kryer të gjitha detyrat administrative dhe ai nuk ka pasur asnjë problem me personelin e Medicusit gjatë kohë që ai ka punuar në klinikë, e as me ndonjë person jashtë klinikës.

Për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, gjykata po ashtu e ka shkelur kodin penal pasi që i pandehuri është shpallur fajtor për dy pika të akuzës të cilat ai kurrë nuk i ka kryer. Nuk ka baza, prova dhe fakte për veprat e përmendura.

Për më tepër, Gjykata Themelore është dashur ta përcaktojë dënimin për secilën pikë të akuzës veçmas dhe pas kësaj ta caktojë dënimin unik në përputhje me dispozitën e nenit 71 paragrafi 1 dhe 2. Duke iu referuar kësaj, mbrojtja pretendon shkeljen e nenit 71.

Në fund, Gjykata Themelore ka dështuar t'i paraqes dhe t'i shqyrtojë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ta gjejë një dënim proporcional. Vet ky dështim e bën aktgjykimin të paqëndrueshëm.

Mbrojtja propozon aprovimin e ankesës dhe lirim të pandehurit nga të gjitha akuzat apo të anulohet aktgjykimi dhe lënda të kthehet për rigjykim.

C. Ankesa e avokatit mbrojtës Ramë Gashi për të pandehurin S. H.

Avokati mbrojtës Ramë Gashi në emër të S. H. ka paraqitur ankesë më datën 26 nëntor 2013 në Gjykatën Themelore të Prishtinës mbi bazat e:

- Shkeljes themelore e dispozitave të procedurës penale siç parashihet me nenet 383 dhe 384 të KPPPK-së-së;
- Shkeljes së drejtës penale siç parashihet me nenet 383 dhe 385 të KPPPK-së-së;
- Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, siç parashihet me nenet 383 dhe 386 të KPPPK-së-së;
- Vendimit mbi dënimin;
- Sanksioneve penale siç parashihet me nenet 383 dhe 387 të KPPPK-së-së; dhe
- Dënimin plotësues nga ushtrimi i anesteziologut profesionist për periudhën prej një viti.

Mbrojtja pohon se aktgjykimi nuk është në përputhje me nenin 384, paragrafi 1, nën paragrafi 1.8 dhe 12.1, paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 i KPPPK-së dhe prandaj përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabueshme lidh provat materiale jo vetëm me viktimat 3, 7, 19, 22, 23 dhe 24, por edhe me të gjithë personat e tjerë të listuar në dispozitiv të aktgjykimit të kundërshtuar në lidhje me S. H. Nuk është dëshmuar me asnjë formë të dyshimit se prova e paraqitur në aktgjykim ka të bëjë me veprime të paligjshme që mund të ishin ndërmarrë nga i pandehuri. Ai jo vetëm që nuk ka pasur asnjë rol në ardhjen e personave në klinikë, por ai gjithashtu nuk ka pasur asnjë rol në lidhje me pranimin fizik të pacientit apo dokumentacionin lidhur me pranimin ose procedurat e brendshme. Nuk ka asnjë lidhje në mes të S. H. dhe ndonjë prove të mbledhur gjersa ai ka qenë duke punuar në klinikën Medicus.

Sipas avokatit mbrojtës aktgjykimi nuk është në përputhje me nenin 370, paragrafin 6, 7 dhe 8 të KPPPK-së-së. Aktgjykimi nuk përmban një arsyetim të plotë të fakteve të përcaktuara dhe të papërcaktuara dhe ka dështuar që të vlerësojë provat dhe rrethanat shfajësuese dhe gjithashtu ka dështuar që të shqyrtojë nëse provat dhe propozimet e mbrojtjes janë pranuar apo jo. Në këtë drejtim, aktgjykimit të kundërshtuar i mungon një arsyetim i vlefshëm në lidhje me provat e dhëna nga i pandehuri gjatë gjykimit, dhe e njëjta nuk është shqyrtuar aty fare. Në fund, Ligji për Shëndetësi i Kosovës nuk mund të përdoret. Duke qenë i punësuar si anesteziolog, veprimet e të pandehurit nuk kanë shkelur asnjë dispozitë. Në asnjë situatë i pandehuri nuk e ka shkelur ndonjë dispozitë të Ligjit për Shëndetësi. Nga ana tjetër, ai nuk ka qenë i detyruar që të kujdeset për

regjistrime, formularë ligjorë dhe aktivitete të klinikës dhe licencimin e saj. Kjo nuk ishte nën kompetencën e tij dhe miratimi apo mosmiratimi i tij nuk kanë qenë relevant.

Për sa i përket shkeljes së pohuar të ligjit penal mbrojtja pohon se një lëndim trupor si element i veprës penale as nuk është shkaktuar nga veprimet e të pandehurit dhe as që ka ndërmarrë ai ndonjë akt tjetër të paligjshëm. Veprimet me të cilat i pandehuri është i akuzuar nuk përbën një lëndim të rëndë trupor në formën siç është paraparë me dispozitën e nenit 154 të KPPK-së. Elementet kryesore të konsiderueshme të veprës penale mungojnë siç ofrohet shprehimisht nga dispozitat ligjore përkatëse. Për më tepër, Gjykata Themelore e ka shkelur nenin 385 paragrafin 1, nënparagrafin 1.4 të KPPPK-së-së gjatë zbatimit të dispozitave të ligjit penal të Serbisë në dëm të të pandehurit. Mbrojtja e sheh shkeljen e nenit 154 paragrafi 1 nën paragrafi 2 i KPPK-së. Nuk është dëshmuar aspak se i pandehuri me dashje ka ndërmarrë veprime të paligjshme.

Për sa i përket vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, mbrojtja liston dhe përshkruan detyrat e një anesteziologu në mënyrë të detajuar në bazë të informacionit të dhënë nga Net Online Amerika Job Center Network Partner, Care Planer and Canadian Anesthesiologists. Në bazë të përshkrimit mbrojtja konstaton se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar gabimisht fakte të rëndësishme sa i përket përgjegjësisë penale dhe fajësisë së të pandehurit. Ai nuk ka bërë asnjë veprim i cili ka shkaktuar ndonjë lëndim të rëndë trupor. Ai nuk ka qenë kirurg dhe ai nuk ka ndihmuar në heqjen e veshkave. I pandehuri nuk kishte kompetenca dhe detyra e tij ishte vetëm që të marrë pjesë për mirëqenien e pacientit gjatë operacionit. Pra, ai nuk ishte në dijeni të aktiviteteve të paligjshme. Ai gjithashtu nuk ka mund të ketë qenë në dijeni për këtë. Ai nuk ka pasur as autoritet e as përgjegjësi sa i përket çështje juridikeve. Ai nuk kishte të bëjë asgjë me pagesën për personat dhe ai gjithashtu nuk ishte i përfshirë në rekrutimin e personave të mundshëm për largime të veshkave apo transplantime. Në këtë pikë as aktakuza e as aktgjykimi nuk jep ndonjë provë konkrete. Aktgjykimi gabimisht interpreton mendimin e mjekes ligjore C. B., pasi raporti i mjekësisë ligjore ofron fakte që nuk përputhen me dispozitat ligjore të nenit 154 të KPPK. Më në fund, ligji penal i Serbisë nuk është i zbatueshëm në Kosovë. Prandaj, elementet ligjore nuk mund të vendosen nga një dispozitë ligjore e një vendi tjetër.

Aktgjykimi i kundërshtuar duket i paqëndrueshëm në lidhje me vendimin mbi dënimin dhe kufizimin për të vazhduar më tutje profesionin e anesteziologut. Dënimi me 3 vjet burgim duket të jetë i lartë dhe hakmarrës dhe pra edhe i paligjshëm përkundrejt rrethanës se i pandehuri nuk ka rekrutuar, nxitur apo mashtruar personat. Gjatë urdhërimit të ndalimit të kryerjes së profesionit të tij gjykata e shkallës së parë nuk ka respektuar kushtet ligjore apo parakushtet. Masa është e paligjshme dhe nuk duhet të qëndrojë në fuqi kundër të pandehurit.

Mbrojtja propozon që të anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës në lidhje me të pandehurin S. H. në pajtim me nenin 398 paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 dhe 1.4 të KPPPK-së-së në lidhje me nenet 402 dhe 403 të KPPPK-së-së dhe lënda të kthehet në rigjykim . Në mënyrë

alternative, ai propozon që të ndryshohet vendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të lirohet i pandehuri nga veprat penale me të cilat ai është akuzuar. Mbrojtja propozon që të ndërpritet dënimi plotësues për të ushtruar profesionin e anesteziologut për periudhën prej një viti si një masë e paligjshme.

D. Ankesa e avokatit mbrojtës Ahmet Ahmeti për të pandehurin I. B.

Avokati mbrojtës Ahmet Ahmeti në emër të të pandehurit I. B. ka paraqitur një ankesë me 9 nëntor 2013 për shkak të:

- Shkeljes esenciale të dispozitave të KPPPK-së-së;
- Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike;
- Shkeljes së ligjit penal;
- Vendimit të gabuar mbi dënimin.

Në lidhje me shkeljen thelbësore të dispozitave të procedurës penale , mbrojtja konsideron se dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar është i pakuptueshëm dhe në kundërshtim me arsyetimin, ndërsa faktet e paraqitura në arsyetim janë të paqarta dhe në kundërshtim me provat e gjetura në dosjen e rastit. Aktgjykimi nuk është i bazuar në faktet relevante por në faktet jorelevante. Prokuroria speciale nuk siguroi prova të mjaftueshme. Gjykata e shkallës së parë ka dështuar të vërtetojë se i pandehuri i ka kryer veprat penale lëndimi i rëndë trupor paragrafi 154 paragrafi 1, nënparagrafi 2 i KPPK. Nuk e ka vlerësuar plotësisht dhe objektivisht mbrojtjen e të akuzuarit i cili e ka mohuar veprën penale lëndimi i rëndë trupor e cila gjithashtu përkrahet nga ai akuzuari S. H.. Gjykata duhet ta aplikojë parimin *in dubio pro reo*, të paraparë me nenin 3 paragrafi 2 të KPPPK-së i cili është shkelur dhe injoruar. Në bazë të nenit 387 paragrafët 1 dhe 2 të KPPPK-së-së gjykata duhet ta bazojë aktgjykimin në provat e prezantuara dhe të shqyrtuara në shqyrtimin gjyqësor. Prandaj mbrojtja pretendon që është shkelur neni 3 paragrafi 2, 7 paragrafi 2,8 paragrafët 1 dhe 2 dhe neni 387 paragrafët 1 dhe 2 të KPPPK-së-së. Zbrazëtitrat në aktgjykimin e ankimuar janë vet pjesë e shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, të paraparë ,e nenin 403 paragrafi 1 pika 12 e KPPPK. Si pasojë aktgjykimi i ankimuar, pika VII e dispozitivit ligjërisht bëhet e paqëndrueshme dhe si e tillë pika e VII në dispozitiv duhet të anulohet.

Me asnjë material të vetëm ose provë formale nuk është vërtetuar plotësisht dhe drejtë gjendja faktike lidhur me veprën lëndimi i rëndë trupor. Përrjashtohet mundësia që i pandehuri vetëm ose me dikë tjetër ka kontribuar në kryerjen e kësaj vepre. Pasi që i pandehuri ka qenë dhe ka mbetur vetëm anesteziolog profesional, i vetmi paramendim është në kuptimin subjektiv, por i ligjshëm dhe i drejtë ka qenë dhe mbetet realizimi i dëshirave dhe objektivave të tij profesionale. Kurrë nuk i ka shkuar mendja nëse klinika ka pasur licencë apo jo, pasi që pos gjërat të tjerave, pllakatet reklamuese me emërtimin “Medicus” ishin publike dhe të dukshme për çdokënd, në



çdo kohë. Mbrojtja thekson që i pandehuri ka tentuar ta bazojë tërë punën e tij në profesionalizëm, vazhdimisht duke qenë i dedikuar punës së kryer me nder dhe me përgjegjësi të plotë profesionale dhe në shërbim të ruajtjes së shëndetit të pacientit dhe jo për dëmtrimin e shëndetit të tij, siç është pretenduar nga prokuroria. Në fakt, i pandehuri ka vepruar si një anesteziolog. Ai nuk ka pasur asnjë kontakt fizik me pacientin pasi që transplantimi si një veprim është kryer nga kirurgët. Në përputhje me njërën nga këto parimet themelore të ligjit penal, përgjegjësia penale ka personi i cili me vetëdije i shkakton pasoja të dëmshme dhe të paligjshme një personi tjetër. Kundër këtij sfondi veprimet e të pandehurit nuk karakterizohen me synim apo as me pasojat e sakatuara nga njerëzit e tjerë. Në kundërshtim me këtë, veprimet e pretenduara nuk janë ndërmarrë dhe as që janë kryer me qëllim të shkakimit të dëmeve ndaj personalitetit dhe shëndetit të të tjerëve. Mbrojtja thekson se i pandehuri nuk ka kryer asnjë krim pasi që mungojnë elementet subjektive dhe objektive të veprimeve penale. Kështu që gjykata e nivelit të parë me shkeljen substanciale të dispozitave të KPPPK-së dhe KPPK dhe me vërtetim të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike e ka shpallur fajtor të akuzuarin në mënyrë të padrejtë dhe e ka shqiptuar vendimin për sanksion penal.

Mbrojtja propozon të aprovohet ankesa e saj si e bazuar të anulohet aktgjykimi i kundërshtuar i gjykatës Themelore të Prishtinës lidhur me dispozitivin e aktgjykimit, pika 7, lidhur me të akuzuarin I. B.t dhe ta kthejë rastin në gjykatën e shkallës së parë për rishqyrtim, ose ta ndryshojë aktgjykimin duke e liruar të pandehurin nga akuzat.

#### E. Ankesa e avokatit mbrojtës Hilmi Zhitia për të pandehurin S. D.

Avokati mbrojtës Hilmi Zhitia që e përfaqëson S. D. më 4 dhjetor 2013 e parashtroi ankesën në Gjykatën Themelore të Prishtinës në bazë të:

- Shkeljet fundamentale të dispozitave të nenit 403 paragrafi 1 pikat 5, 10, 12 paragrafi 2;
- Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike – neni 405 i KPPPK;
- Shkelja e ligjit penal – neni 404 paragrafi 1 pikat 1, 2, 3 dhe 4 të KPPPK-së; dhe
- Sanksioni penal – Neni 406 i KPPPK.

Mbrojtja thekson që në bazë të nenit 90 paragrafi 1 i ish KPPK gjykata e ka refuzuar pjesën e aktakuzës që ka të bëjë me veprën penale sipas nenit 221 të ish KPPK edhe pse përfaqësuesi i prokurorisë në fjalën përmbyllëse e ka parashtruar aktakuzën e re duke e akuzuar të pandehurin për veprën penale lëndim i rëndë trupor në bazë të nenit 154. Por prokuroria nuk e jep vendin, kohën, mënyrën e kryerjes dhe kundër kujt është kryer krimi. Ai vetëm i kufizon vërejtjet e tij ndaj përshkrimit të normës penale të nenit 154 të Kodit Penal duke shtuar komente lidhur me pretendimet e mbrojtjes. Ai pohon se gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar aktakuzën kundër të pandehurve I. B. dhe S. D.. Por një aktakuzë e atillë në fakt nuk është vërtetuar ngase gjykata e shkallës së dytë ka kërkuar të refuzohet aktakuza shkaku i parashkrimit. Edhe pse vepra penale

për të cilën i pandehur akuzohet e ka tejkalluar periudhën e parashkrimit , mbrojtja supozon që prokuroria e kam mbajtur atë nën akuza. Prokurori shtetëror në fjalën përmbyllëse e paraqiti aktakuzën e re kundër të pandehurit duke e akuzuar atë gjithashtu edhe për veprë penale lëndim i rëndë trupor sipas nenit 154 të ish KPPK, edhe pse gjatë procedurës penale asgjë nuk ka ndodhur apo ndryshuar. Nuk janë paraqitur faktet ose rrethana të tjera që do të kushtëzoni ndryshimin ose korrigjimin e atyre akuzave. Sa i përket kësaj prokurori pohon se është akuzë e re, ndërsa gjykata në disa raste pohon se është aktakuzë e re dhe në disa raste thotë që është zgjeruar. Kjo aktakuzë e re, e parashtruar nga prokurori, është plotësisht e papranueshme dhe e pakuptueshme dhe nuk ka elemente të akuzës siç parashihet me nenin 305 të KPPK-së. Nuk është e qartë se çfarë veprime janë ndërmarrë nga i pandehuri dhe nëse i ka shkaktuar me qëllim apo nga pakujdesia. Në këtë mënyrë, gjykata e shkallës së parë e shkeli nenin 403 paragrafi 1 pika 5 e KPPK, sepse nuk ishte akuzë të atillë për prokurorin. Ai vetëm thotë se është kryer vepra lëndim i rëndë trupor sipas nenit 154 paragrafi Prandaj, prokurori nuk la asnjë alternativë. Gjkata nuk u lejua ta shpallë të pandehurin fajtor. Duke vepruar kështu e shkeli parimin *in dubio pro reo*. Një aktakuzë me alternativa gjithmonë duhet të interpretohet në favor të të akuzuarit. Pasi që gjykata e tejkaloj qëllimin e aktakuzës , ajo e shkeli dispozitën e nenit 403 paragrafi 1 pika 10. Për më tepër mbrojtja i referohet shkeljes së nenit 403 paragrafi 1 pika 12 pasi që aktgjykimi është i paqëndrueshëm, i pavlefshëm dhe kontradiktor me arsyetimin e tij dhe me dispozitivin e tij dhe aktgjykimi bazohet në vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Për më tepër, mbrojtja e ngrit çështjen e shkeljes së të drejtës për mbrojtje. Nën një, mbrojtja kërkoi refuzimin e aktakuzës ndaj të pandehurit shkak i parashkrimit relativ. Gjkata e shkallës së dytë e udhëzoi gjykatën e shkallës së parë të vendosë për këtë, gjë që kurrë nuk e bëri. Nën dy, aktakuza e re e parashtruar nga prokuroria është në kundërshtim me nenin 305 të KPPK-së. Nuk ishte e qartë nëse vepra ishte kryer me dëshirë, nga pakujdesia, në bashkëkryerje, në bashkëpjesëmarrje, dhe kështu me radhë. Prandaj, kjo çoi në shkeljen e ligjit penal sipas nenit 1 paragrafi 3 por gjithashtu edhe të nenit 3 paragrafi 2 të ish KPPK.

Mbrojtja thekson se i pandehuri vetëm e ka ushtruar profesionin e tij, duke i respektuar metodat dhe standardet e përcaktuara nga rregullat mjekësore. Në këtë kontekst, gjykata gjithashtu e keqkuptoi shpjegimin në gjuhën serbe. Shkak i fakteve dhe rrethanave të vërtetuara, duhet të jep komentimin e vet. Gjkata duhet të vërtetoj drejtë gjendjen faktike dhe të jep arsyetimin në bazë të ligjit të aplikueshëm në Kosovë.

Pastaj, gjendja faktike nuk vërtetohet drejt dhe në mënyrë të plotë. Shkak i një letre nga sekretari permanent dhe kryearti i bordit për licencim, stafi ishte i bindur se licenca ekzistonte. Asnjë nga mekanizmat kontrollues të Ministrisë së Shëndetësisë nuk kundërshtoi apo kontrolloi klinikat private. Çdo individ, madje edhe stafi i angazhuar në veprimet ligjore paraprakisht ishin të sigurt se për gjithçka ekzistonte licenca ose që veprimi i kryer është bërë në bazë të ligjit,

përndryshe shteti do të kishte ndërhyrë me mekanizmat e tij dhe nuk do të lejonte një veprimtari të këtillë. I pandehuri si anestezist nuk dinte për asnjë vepër të paligjshme.

Mbrojtja konstaton se vepra penale lëndim i rëndë trupor duhet të trajtohet veçmas nga vepra penale trafikimi me njerëz pasi që i akuzuari nuk është akuzuar për këtë. Çështja duhet të trajtohet vetëm si kryerje e veprës penale lëndim i rëndë trupor pasi që nuk ekziston aktakuza për trafikim me njerëz dhe krim të organizuar. Në fund, i akuzuari nuk e kreu veprën lëndim i rëndë trupor ngase ai i përgatiti medikamentet për anesteziion dhe e plotësoi listën e anestezisë. Ai nuk e hoqi ndonjë veshkë, kjo është bërë nga ekipi i kirurgëve.

Mbrojtja pohon se nuk ka pasur rregulla ligjore që e dënonin transplantimin e veshkave. Nga perspektiva ligjore, rregullorja e UNMIK-ut 2000/1 ka qenë e aplikueshme në Kosovë në mungesë të rregullores adekuate. Sipas shpjegimit të ligjit penal të Serbisë në faqen 147 theksohet se në rast të pajtimit të pacientit, përjashtohet paligjshmëria. Në rastin vijues pacientët e dhanë pajtimin e tyre. Ata erdhën nga jashtë shkak i kërkesës së tyre dhe me ftesë. Nën dy, pacientët iu nënshtruan procedurave të rregullta duke filluar nga zyra e pranimit, ekzaminimet mjekësore, analizat e ekipit kirurgjik dhe në fund kanë arritur te anesteziologu. Shkak i pajtimit të tyre, përjashtohet paligjshmëria.

Pasi që veprimet e të akuzuarit nuk përmbajnë elemente të veprës penale, i pandehuri nuk mund të jetë përgjegjës për veprat penale në bazë të nenit 154 paragrafi 1 pika 2 e ish KPPK. Prandaj, nuk mund të shqiptohet asnjë sanksion. Me rastin e shqiptimit të dënimit gjykata i shkeli dispozitat e ish KPPK.

Ai propozon që ankesa të miratohet si e bazuar, të anulohet aktgjykimi që i është shqiptuar të pandehurit S. D. dhe rastin të kthehet në rishqyrtim ose të ndryshohet aktgjykimi dhe të lirohet i pandehuri në bazë të rrethanave që e përjashtojnë përgjegjësinë penale.

#### F. Ankesa e PSRK-së

PSRK më 10 dhjetor 2013 parashtroi ankesë në Gjykatën Themelore për:

- Shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale;
- Shkelje të ligjit penal;
- Vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike;
- Vendimin për sanksionet penale.

Në përmbledhje, prokuroria thekson se aktgjykimi i kundërshtuar duhet të ndryshohet pjesërisht si vijon.

Bastisja dhe marrja e provave në klinikën Medicus duhet të konfirmohet si ligjshme dhe provat të konsiderohen si të pranueshme sipas këtij arsytimi e jo sipas arsytimit të Gjykatës Themelore. Prokurori thekson se bastisja dhe konfiskimi i shënimeve mjekësore dhe afariste,

furnizimeve mjekësore dhe medikamenteve në klinikën Medicus ishin të arsyeshme dhe të ligjshme në bazë të nenit 201 të KPPPK-së. Ky nen i jep të drejtë autoritetit ligjor të bastisë dhe konfiskojë gjërat, ndaras nga kompetencat dhe detyrat e policisë e cila i ekzekuton bastisjet, në bazë të urdhrin të gjyqtarit të procedurës paraprake ose të gjykatës në përgjithësi. Ato kompetenca dhe detyra janë përcaktuar me nenet 240-253 të KPPPK-së. Është pretendimi i prokurorit se kushtet e nenit 201 janë përmbushur ngase ka qenë e domosdoshme që policia të merr pjesë në klinikën Medicus sa më shpejtë që ishte e mundur pasi që u informuan për krimet e mundshme të kryera atje. Pos kësaj, policia e paraqiti raportin e gjërave të konfiskuara siç parashihet me nenin 201 paragrafi 2 dhe neni 207 të KPPPK-së dhe kështu iu përmbajt kërkesave procedurale për kryerjen e bastisjes sipas nenit 201 të KPPPK-së.

Pastaj nuk ka asgjë në nenin 36 paragrafi 2 të Kushtetutës së Kosovës që sugjeron se gjykata gjithmonë duhet t'ia jep miratimin paraprak policisë për bastisje. Në fakt, fjalia e fundit e nenit 36 paragrafi 2 vetëm thotë se “gjykata duhet të qaset në veprimet e tilla në mënyrë retroaktive.”. Kjo nuk do të thotë se urdhri i gjykatës duhet të merret paraprakisht për të siguruar ligjshmërinë e bastisjes. Si të tillë, prokurori thekson se kushtetua nuk e përcakton detyrimisht që bastisja duhet të miratohet nga gjykata para zbatimit ose që më pas është miratuar nga gjykata në formë të urdhrin. Gjykata mundet në mënyrë të prerë të miratojë një bastisje të atillë duke u mbështetur në provat e konfiskuara gjatë bastisjes ose duke lejuar që provat e atilla të ekzaminohen.

Ndryshe, nëse gjykata e Apelit e refuzon këtë argument, atëherë prokurori pretendon se bastisja në klinikë është kryer në mënyrë të ligjshme sipas nenit 245 të KPPPK-së. Në këtë rast, ishte e qartë se policia duhej të hynte në hapësirat e Medicusit dhe të kryejë bastisjen sipas nenit 245 paragrafi 1 të KPPPK-së për të siguruar sigurinë e viktimave dhe të dëshmitarëve të mundshëm. Policia vetëm kishte informata se një transplantim ishte kryer. Ishte e domosdoshme për ata që të hynin në ndërtesë për të siguruar sigurinë e viktimave të tjera të mundshme. E dinin që ka pasur një “dhurues” të veshkës dhe prandaj ishte e sigurt që do të kishte edhe një marrës i cili mund të kishte nevojë për ndihmë mjekësore.

Në bazë të nenit 246 paragrafi 6 i KPPPK, shkelja e nenit 245 paragrafi 2 të KPPPK-së nuk është bazë për papranueshmërinë e provës. Ky nen vetëm e përjashton provën e siguruar ndesh me nenin 245 paragrafët 1, 3, 4 dhe 5 të KPPPK-së. Si rezultat prova e siguruar në bazë të bastisjes së kryer në bazë të nenit 245 (1) të KPPPK duhet të konsiderohet e pranueshme sipas nenit 246 paragrafi 6 të KPPPK-së. Gjithashtu policia e ka zbatuar nenin 245 paragrafi 6 të KPPPK-së ngase ata ia dërguan raportin prokurorit më 11 nëntor 2008, pas përfundimit të bastisjes më 10 nëntor 2008.

Përmbajtja e mesazhit tekstual pas urdhrin të prokurorit Manoj John më 19 nëntor 2008 duhet të pranohet si provë në këtë rast dhe kjo përmbajtje pastaj duhet të konsiderohet lidhur me dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarit.

Mesazhet tekstuale janë pranuar përmes regjistrimit të thirrjeve telefonike, jo përmes përgjimit. Në përputhje me ligjin për telekomunikim dhe KPPPK, në fuqi në atë kohë, një përvijim

substancial bëhet mes regjistrimit të thirrjeve telefonike sipas autorizimit të prokurorit dhe të përgjimit që mundësohet përmes urdhrit të gjykatës. Andaj urdhri i gjykatës nuk nevojitet dhe mjaftonte urdhri i prokurorit. Ndryshe, urdhri i prokurorit është lëshuar në përputhje me nenin 256, 257, 258 dhe 259 të KPPPK-së. Prokurori ishte shumë specifik në kërkimin e vetëm atyre regjistrimeve të cilat mund t'i urdhëronte që t'i siguroheshin në bazë të nenit 258 paragrafët 1 dhe 4 të KPPPK-së. Në asnjë çast prokurori nuk e ka kërkuar materialin në cilin nuk kishte të drejtë ta kërkonte sipas KPPPK. Prandaj konstatohet se neni 264 paragrafi 1 i KPPK sipas të cilit kjo provë mund të përjashtohet, nuk aplikohet për këtë çështjen në fjalë pasi që asnjë urdhër i kundërligjshëm nuk është lëshuar nga ana e prokurorit.

Më tej, i pandehuri S. H. duhet të dënohet për veprën trafikimi me njerëz. Pohimi i Gjykatës themelore se S. H. veproi vetëm në mënyrë të pakujdesshme është në mospërputhje me një interpretim të saktë të gjendjes faktike. Në vend të kësaj, gjykata duhet të vërtetojë se sa i përket të gjendjes faktike, i pandehuri veproi me qëllim të drejtpërdrejt, ose së paku me qëllim të tërthortë, sipas nenit 15 të KPPK në të cilin rast veprimet e tij janë të dënueshme për trafikim me njerëz sipas KPPK dhe Kodit Penal të Kosovës i cili është në fuqi aktualisht.

I pandehuri S. H. duhet gjithashtu të dënohet për veprën penale krimi i organizuar. Prokuroria thekson se kontributi i të pandehurit në arritjen e qëllimeve të paligjshme të grupit të krimit të organizuar ishte esenciale, dhe në shkakësi të drejtpërdrejtë me rezultatin e dënueshëm. Edhe pse nuk ka prova që e ndërlidhin të pandehurin me rekrutimin ose transportimin ose strehimin e personave të trafikuar, ai është provuar të ketë ndihmuar në realizimin e qëllimit të grupit: heqjen dhe transplantimin e organeve, që siguroi përftim material të kundërligjshëm për anëtarët e tij.

Më tej i pandehuri L. D. duhet të dënohet për lëndim të rëndë trupor. Shkaktimi i lëndimit të rëndë trupor nuk është mes shumë modalitetesh ose mjetesh për kryerjen e trafikimit me njerëz, sipas dispozitave të KPPK ose të Protokollit të UN-TOC (Krimi i Organizuar Gjithëkombëtar i KB). Sipas definicionit të trafikimi me njerëz sipas KPPK, nuk nevojitet lidhshmëria e shkakësisë mes modaliteteve të një vepre të atillë dhe rezultatit të shkaktimi të lëndimit trupor. Në praktikë është plotësisht e mundur që trafikimi me njerëz të kryhet në akëcilin prej modaliteteve dhe me cilindo nga mjetet e parapara me nenin 139 pa shkaktuar vërtet lëndime ndaj viktimës. Si rezultat, pohimi i Gjykatës Themelore sa i përket veprës penale lëndim i rëndë trupor nga i pandehuri L. D. e cila absorbohet në veprën trafikimi me njerëz të kryer nga i pandehuri i njëjtë, është i gabuar dhe nuk ka bazë ligjore.

Prokuroria më tej pohon se shumica e urdhëruar për dëmet psikologjike dhe fizike që viktimat i kanë pësuar gjatë transplantimit të veshkës është tepër e vogël dhe se duhet të rritet dukshëm.

Prokuroria thekson se gjykata Themelore ka konstatuar se të gjithë marrësit kanë qenë meshkuj, por së paku njëra nga marrësit (F. B. B.) ka qenë femër. Prokurori gjithashtu thekson se ndryshe nga pohimi i gjykatës Themelore, Y. K. nuk është gjykuar dhe dënuar në Ukrainë.

Prokurori thekson se aktvendimi për konfiskim sipas nenit 489 paragrafi 3 të KPPPK-së duhet të lëshohet lidhur me gjësendet e konfiskuara të klinikës Medicus.

Lidhur me dënimet, prokurori parashtron si vijon:

Dënimi i shqiptuar ndaj L. D. supozohet të jetë dënim unik për dy vepra edhe pse kjo nuk është cekur në aktgjykim. Dënimi është shumë i ulët duke marrë parasysh se dënimet minimale të aplikueshme për krim të organizuar dhe trafikim. Më tej, L. D. është dashur të dënohej për lëndim të rëndë trupor gjithashtu dhe kjo vepër penale duhet të përfshihet në dënim. Gjykata Themelore nuk e shpalli dënimin për çdo vepër dhe pastaj ta shqiptojë dënimin unik për të gjitha veprat. Kjo duhet të ndryshohet. Dënimi plotësues ndaj L. D. për ushtrimin e profesionit të urologut duhet të ndryshohet për ta përfshirë tërë përvojën e tij dhe duhet të rritet në maksimum 5 vjet duke filluar nga dita kur është liruar nga burgu.

Lidhur me të pandehurin A. D., Gjykata Themelore nuk e shpalli dënimin për çdo vepër dhe pastaj ta shqiptojë dënimin unik për të gjitha veprat. Kjo duhet të ndryshohet.

Lidhur me S. H., dënimi i shqiptuar është tepër i ulët. Pastaj dënimi plotësues ndalimi i ushtrimit të profesioni të tij duhet të ndryshohet për ta përfshirë tërë përvojën dhe duhet të rritet gjithashtu duke filluar nga dita kur të lirohet nga burgu.

Në fund, pezullimi i dënimet të shqiptuar për I. B. dhe S. D. duhet të rritet në pesë (5) vjet. Më tej, dënimi plotësues duhet të bëjë me tërë profesionin e tyre, jo vetëm specializimin.

G. Përgjigja e avokatit mbrojtës Ramë Gashi për të pandehurin S. H.

Në përgjigjen e tij ndaj ankesës së parashtruar nga prokurori special më 10 dhjetor 2013, avokati mbrojtës Ramë Gashi në emër të S. H. konstaton se pretendimet në ankesën e prokurorit janë të pabazuara. I pandehuri nuk ka lidhje me provat që janë gjetur, deponuar dhe marrë nga klinika. Provat dhje bastisja që ndërlidhen me të pandehurin janë të papranueshme dhe të paefektshme ndaj çdo përgjegjësie penale. Të vetme detyrë që e ka pasur ka qenë t'u ndihmonte pacientëve pa asnjë interes se kush mund të jetë pacienti që do të operohej dhe pse do të operohej. Tentativat për t'ia veshur të pandehurit elementet e krimit të organizuar nuk janë mbështetur me asnjë provë; arsyetimi në ankesën e prokurorit special është i paqartë, prandaj pretendimet janë të pabazuara. Pohimet që i pandehuri duhej të ishte në dijeni të një rrethane apo të një gjëje për çka nuk e kishte idenë është e paargumentuar nga ndonjë fakt relevant dhe paraqet keq-interpretim të ligjit. Gjykata Themelore seriozisht ka çorientuar gjendjen faktike. Mbrojtja thekson se dënimi dhe ndëshkimi dhe dënimi i shqiptuar janë joadekuate. Mbrojtja propozon që të refuzohet

ankesa e prokurorit special PPS. Nr. 2/09 e datës 10 dhjetor 2013 si e pabazuar dhe ta aprovojë ankesën e tij si të bazuar.

#### H. Përgjigja e avokatit mbrojtës Ahmet Ahmeti për të pandehurin I. B.

Në përgjigjen e tij ndaj ankesës së parashtruar nga prokurori special më 10 dhjetor 2013, avokati mbrojtës Ahmet Ahmeti në emër të I. B. konstaton se prokuroria nuk ka paraqitur ndonjë rrethanë të re që do të mund të çonte në ndryshimin e aktgjykimit të ankimuar dhe të shqiptohet një dënim mes tre (3) dhe pesë (5) vitesh. Ankesa e PSRK është e padrejtë, e pabazuar, e paarsyeshme dhe pa asnjë fakt të ri. Prandaj ai propozon që të miratohet përgjigja dhe të refuzohet ankesa e PSRK.

#### I. Përgjigja e avokatit mbrojtës Petrit Dushi për të pandehurin A. D.

Në përgjigjen e tij ndaj ankesës së parashtruar nga prokurori special më 10 dhjetor 2013, avokati mbrojtës Petrit Dushi në emër të A. D. konstaton se parashtresa e prokurorit është pa asnjë themel. Ai i referohet ankesës së tij duke e kundërshtuar aktgjykimin në bazë të: a)shkeljes substanciale të dispozitave të procedurës penale, b)vërtetimi të gabuar dhe të paplotë të gjendjes faktike, c) shkeljes së ligjit penal, d )vendimi mbi dënimin dhe e ) padisë pronësore. Ai i propozon gjykatës së apelit t'i pranojë ankesat e tij si të bazuara dhe të refuzojë ankesën e prokurorisë si të pabazuar në tërësi.

#### J. Parashtresa e Prokurorisë së Apelit

Prokurori i Prokurorisë së Apelit më 19 shkurt 2014 e paraqiti parashtresën të datës 19 shkurt 2014 duke i propozuar Gjykatës së Apelit të refuzojë ankesat e avokatit mbrojtës të pabazuara dhe të vendos për çështjet e ngritura në ankesën e SPRK, si dhe për ato që mund të shqyrtohen *ex officio*.

#### I. B.

Lidhur me ankesën në emër të I. B. prokurori i Prokurorisë së Apelit thekson se ankesa nuk i përmbush kushtet e nenit 401 paragrafi 1 i KPPPK dhe duset të hidhet poshtë në bazë të paragrafit 2 të të njëjtit nen. Ndryshe, prokurori i Prokurorisë së apelit thekson se aktgjykimi i kundërshtuar ofron prova të detajuara kundër të pandehurit, përfshirë deklaratat e dëshmitarëve të cilët e kanë njohur dhe e kanë parë I. B. duke punuar në klinikë si anesteziolog që u ka ndihmuar kirurgëve në transplantimin e organeve. Pohimet e mbrojtjes janë të pabazuara.

#### A. D.

Lidhur me ankesën në emër të A. D. prokurori i Prokurorisë së Apelit thekson se veprat penale për të cilat i pandehuri është shpallur fajtor janë të njëjtat akuza me të cilat i pandehuri është akuzuar në aktakuzë.

Pohimet se Gjykata Themelore e ka shkelur detyrën e saj për t'i vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë faktet të cilat janë të rëndësishme në marrjen e një vendimi të ligjshëm në bazë të nenit 7 të KPPPK-së; dhe se Gjykata e ka aplikuar parimin *in dubio contra reum* ndesh me nenin 3 paragrafi 2 të KPPPK-së, nuk përmbajnë ndonjë arsyetim të argumentuar.

Më tej, paligjshmëria e veprimeve të transplantimit të kryera në klinikë dhe të përmendura në dispozitiv janë detajuar mjaftueshëm në arsyetimin e aktgjykimit. Përkundër pohimeve të mbrojtjes, licenca për transplantimin e veshkave nuk i është dhënë kurrë klinikës Medicus. Pastaj prokurori i Prokurorisë së Apelit thekson se Gjykata Themelore në mënyrë të drejtë dhe të plotë e vërtetuar gjendjen faktike dhe se ka mjaft prova për ta dënuar të pandehurin. Prokurori i Prokurorisë së Apelit thekson se Gjykata Themelore i ka shqyrtuar të gjitha rrethanat relevante të rastit dhe në mënyrë adekuate i ka ekuilibruar rrethanat lehtësuese me ato rënduese.

Por gjykata Themelore nuk e ka vërtetuar dënimin për çdo veprë penale për të cilën i pandehuri është dënuar, sipas nenit 71 paragrafi 1 i KPPK.

#### S. H.

Lidhur me ankesën në emër të S. H. prokurori i Prokurorisë së Apelit thekson se mbrojtja pohon që është shkelur dispozita e procedurës penale pa i argumentuar ato me një arsyetim adekuat për gabimet e pretenduara të cilave gjykata i është nënshtruar. Si e tillë ankesa nuk i përmbushë kushtet e nenit 401 paragrafi 1 të KPPPK-së dhe duhet të hidhet poshtë në bazë të paragrafit 2 të njëjtit nen. Pastaj veprat penale dhe roli i të pandehurit janë vërtetuar drejt dhe janë shtjelluar mjaft. I pandehuri e ka ditur që ishte duke marrë pjesë në cilësinë e anesteziologut në një procedurë të kundërligjshme mjekësore në heqjen e veshkave për transplantim; dhe duke vepruar kështu ai ka kontribuar konsiderueshëm në dobësimin permanent dhe të konsiderueshëm të një organi jetik të dhuruesve me çka është kryer vepra penale lëndim i rëndë trupor.

Më tej prokurori i Prokurorisë së Apelit thekson se – pasi që asnjë gabim procedural, material ose faktik mund të vërehet në arsyetimin e Gjykatës themelore – vlerësimi i rrethanave të rastit dhe shqiptimi i dënimit plotësues ndaj të pandehurit i ndalimit të ushtrimit të profesionit të anesteziologut është i njëjtë me përgjegjësinë penale të S. H.

#### S. D.

Lidhur me ankesën në emër të S. D. prokurori i Prokurorisë së Apelit thekson se mbrojtja ka pasur mjaft kohë dhe konsideron të mundur që mbrojtja të përgatitet kundër akuzës së ndryshuar siç është ngritur nga prokurori i shtetit. Gjykata Themelore pastaj ka kompetencë të klasifikojë dhe të veprojë pa marrë parasysh cilësimin e aktakuzës dhe ka vepruar ashtu në bazë të gjendjes



faktike. Lidhur me çështjet e tjera të ngritura nga mbrojtja, Prokuroria e Apelit i referohet vërejtjeve të saj lidhur me ankesat e tjera të deritashme.

### *PSRK*

Lidhur me ankesën e prokurorit shtetëror, i Prokuroria e Apelit i referohet mendimit të saj të shprehur në rastin PPN 58/13, PN 577/2013 dhe PPS 425/2009 lidhur me ligjshmërinë e bastisjes së klinikës Medicus. Pos kësaj prokurori i Prokurorisë së Apelit thekson se asnjë dispozitë ligjore shprehimisht nuk e përcakton papranueshmërinë e procedurave penale të provave të veprimit penal legjitimisht të mbledhura nga institucionet shtetërore – të tjera pos policisë – në kryerjen e funksioneve të tyre institucionale. Fakti që rezultati i veprimeve hetuese të policisë mund të konsiderohen si të papranueshme shkaku i shkeljes së dispozitave të nenit 240 et seq. të KPPPK-së nuk ndikon negativisht në veprimet e inspektorëve shëndetësor të cilat janë kryer për qëllime të ndryshme institucionale dhe nuk i nënshtrohen të njëjtit regjim të pranueshmërisë si e kaluara. Fakti që në rastin e tanishëm veprimet e inspektorëve shëndetësor janë kryer në kontekst të hetimit penal nga policia e Kosovës, nuk ndikon në përndryshe statusin ligjor autonom të atyre veprimeve dhe Gjykata e ruan të drejtën që lirshëm të vlerësojë vlerën provuese dhe rëndësinë e provave të mbledhura.

Lidhur me pranueshmërinë e përmbajtjes së SMS mesazheve, gjykatat e Kosovës deri tash me sa duket e konsiderojnë se nxjerrja e përmbajtjes së mesazheve tekstuale bie në kategorinë e përgjimeve faktike të telekomunikimeve për çka nevojitet urdhri i gjykatës në bazë të nenit 258 paragrafi 2 nënparagrafi 4 të KPPPK-së. Neni 264 paragrafi 1 i KPPPK parasheh deklarinimin e papranueshmërisë së provave të mbledhura përmes masave të fshehura ose masave hetimore në dy raste: kur urdhri i (gjyqtarit ose prokurorit) është i paligjshëm, dhe kur zbatimi i urdhrimit të (gjyqtarit apo prokurorit) është i paligjshëm. Në rastin e tanishëm, çështja në fjalë është saktësisht një rast i zbatimit në kundërshtim me urdhrin e lëshuar nga prokurori.

Lidhur me çështjet e mbetura, prokurori i Prokurorisë së Apelit pajtohet me argumentet e paraqitura nga prokurori shtetëror dhe i propozon Gjykatës së Apelit të vendos në përputhje me rrethanat.

### *L. D.*

Lidhur me ankesën në emër të L. D. prokurori i Prokurorisë së Apelit thekson se ankesa e mbrojtjes se hetimi ka përfunduar pa aktakuzë nuk është meritore pasi që të gjitha kushtet ligjore për parashtrimin, zgjerimin dhe vërtetimin e aktakuzës janë përmbushur nga prokuroria dhe Gjykata themelore. Sa për ankesën se kryetari i trupit gjykues është dashur të përjashtohet nga pjesëmarrja në shqyrtimin gjyqësor, Prokuroria e Apelit thekson se pasi që vazhdimi i hetimit është thjesht një procedurë teknike e bazuar në vlerësimin e ndërlikueshmërisë së rastit pa hyrë gjyqtari në atë se nëse rasti është meritore, ankesa është e pabazuar.

Pastaj, lidhur me bastisjen e klinikës Medicus dhe çështjen e pranueshmërisë së provave, prokurori i Prokurorisë së Apelit i referohet vërejtjeve të tij të bëra lidhur me ankesat e tjera deri tash. Më tej provat janë dorëzuar si duhet në procedurat gjyqësore. Pretendimet se prokuroria i kishte dhënë fund ‘Librit protokollar të operimeve mjekësore’ janë komplet të pa merita dhe se pretendimi se libri do të tregonte se i pandehuri është i pafajshëm është e pabazuar. Për më tepër, prokurori i apelit vëren se situata faktike ishte e saktë dhe plotësisht e vërtetuar ku shihet se L. D., si pronar i klinikes private MEDICUS ka qenë përgjegjës për zhvillimin e gjithmbarshëm dhe funksionimin e klinikes për sa i përket transplantimeve të paligjshme të veshkave dhe personalisht ka qenë i përfshirë në shume operime për transplantim të veshkave të cilat janë kryer në këtë klinikë në bashkëkryerje me të pandehur të tjerë duke shfrytëzuar rastin e gjendjes së vështirë financiare të dhuruesve nën sigurimin mashtrues se transplantimi i veshkave në Kosovë ishte i ligjshëm.

## **V. GJETJET E TRUPIT GJYKUES**

### **A. Pranueshmëria e ankesave**

#### *a. Ankesat e parashtruara në emër të të pandehurve*

Ankesat e parashtruara nga ana e PSRK-së, për Linn Slatenngren, avokat mbrojtës i të pandehurit L. D., Petrit Dushi avokat mbrojtës i të pandehurit A. D., Ramë Gashi avokat mbrojtës i të pandehurit S. H., avokat mbrojtës Ahmet Ahmeti i të pandehurit I. B. dhe avokat mbrojtës Hilmi Zhitija i të pandehurit S. D., janë të pranueshme. Ankesat janë dorëzuar brenda afatit të paraparë ligjor prej 15 ditësh në përputhje me nenin 398 të KPPPK. Ankesat janë dorëzuar nga personat e autorizuar dhe përmbajnë tërë informacionin relevant sipas nenit 399 dhe 401 të KPPPK-së.

#### *b. Parashtrësia e dorëzuar në emër të të pandehurit L. D.*

Trupi gjykues vëren se aktgjykimi i atakuar i ishte dorëzuar të pandehurit L. D. më 6 dhjetor 2013. Aktgjykimi i atakuar i ishte dërguar avokatit të tij mbrojtës Linn Slatenngren me datën 29 nëntor 2013. Ankesa nga avokati mbrojtës në emër të të pandehurit L. D. ishte dorëzuar me datën 13 dhjetor 2014. Pra ankesa fillestare ishte dorëzuar brenda afatit 15 ditësh në përputhje me nenin 398 të KPPPK. Sidoqoftë, shkresa e dorëzuar gjatë seancës së 4 nëntorit 2015 nga avokati mbrojtës Linn Slatenngren të hedhet poshtë si e vonuar për shkak të bazave të reja të pohuara së fundmi për ankimimin e aktgjykimit, respektivisht paragjykimet gjyqësore të kryetarit të trupit gjykues. Kjo bazë nuk është përfshirë në ankesën fillestare se si e tillë është dorëzuar me vonë. Megjithatë, trupi gjykues do ta diskutojë këtë çështje në përgjithësi, duke e konsideruar këtë ashtu siç e ka ngritur avokati mbrojtës i A. D., si brenda afatit.

### **B. Paanshmëria e Gjykatës Themelore**

Mbrojtja e vë në pikëpyetje çështjen e paanshmërisë së kryetarit të trupit gjykues pranë gjykatës themelore Arkadiusz Sedek për shkak të përfshirjes së tij të mëhershme si gjykatës i procedurës paraprake me rastin e zgjatjes së hetimeve në këtë çështje me aktvendimin me nr.GJPP 36108 të datës 09 nëntor 2009.

Në zbatimin e vendimit të kryetarit të asamblesë së gjykatësve të EULEX-it, JC/EJUOPEJ2760/ch//1, të datës 11 janar 2012, trupi gjykues gjen se nuk ka asnjë element subjektiv apo objektiv që mund të gjendet dhe me të cilin do nuk do vuhej në dyshim paanshmëria e gjykatësit Arkadiusz Sedek. Fakti i thjeshtë se kryetari i trupit gjykues Arkadiusz Sedek ishte i përfshirë në vendimin mbi zgjatjen e hetimeve nuk e përjashton në mënyrë automatike atë nga një fazë e mëvonshme në çështjen e njëjtë. Qëllimi dhe natyra e vendimit të marrë nuk ishte e dukshme dhe ishte bazuar thjesht në ndërlikimin e çështjes. Në pajtim me praktiken e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, trupi gjykues konstaton se përbërja e trupit gjykues ka qenë e qartë dhe paanshme.

Mbrojtja më tej pretendon se gjykata themelore nuk ka qenë e paanshme kur ka ndërhyrë gjatë pyetje të shtruara nga avokati mbrojtës ndaj dëshmitarëve dhe duke qenë tepër e prerë në lidhje me parashtresat dhe kërkesat e mbrojtjes.

Pas shqyrtimit të kujdesshëm të procesverbalit nga seanca e seancës kryesore, paneli kishte konstatuar se pretendimi i mbrojtjes nuk ishte meritore. Sjellja e gjykatës themelore gjatë tërë kohës ka qenë në përputhshmëri me ligjin dhe trupi gjykues nuk ka gjetur asnjë element subjektiv as objektiv me të cilin do vuhej në dyshim paanshmëria e trupit gjykues.

Si përfundim, trupi gjykues e hedh poshtë ankesën e mbrojtjes si të pabazuar.

### C. Zgjatja e hetimeve

Mbrojtja argumenton se zgjatja e hetimeve ishte sjellë në mënyrë të paligjshme dhe në kundërshtim me procedurat e duhura dhe kështu që hetimet ishin mbyllur me datën 08 maj 2009 pa u ngritur asnjë aktakuza duke e bërë çështjen kundër të pandehurve si të papranueshme.

Paneli ka vërejtur këtë ecuri procedurale:

Më 12 nëntor 2008, një aktvendim mbi fillimin e hetimeve ishte lëshuar kundër të pandehurve L. D., A. D. dhe të tjerët lidhur me veprën penale Trafikimi me qenie njerëzore sipas nenit 139 paragrafi 1 dhe 23 të KPPPK.

Pas fillimit të hetimeve, hetimet ishin zgjatur dhe zgjeruar me dëshmitar të rinj.

Me 12 maj 2010, me aktvendimin Pn-Kr 238/2010 gjykata supreme ka aprovuar zgjatjen e jashtëzakonshme të hetimeve edhe për 6 muaj shtesë, deri më 12 nëntor 2010.

Aktakuzat ishin dorëzuar pranë kësaj gjykate me datat 15 dhe 21 tetor 2010.

Duke marrë parasysh vazhdimësinë, ku nuk ka zbrazëtira kronologjike. Për më tepër, të gjitha kërkesat dhe vendimet gjegjëse për zgjatjen e hetimeve ishin vendosur në përputhshmëri me nenin 225, paragrafi 4, KPPPK. Në raste të tilla të pandehurit nuk njoftohen në lidhje me hetimet dhe me kërkesën për zgjatje të hetimeve. Procedura është në përputhshmëri të plotë me ligjin.

Për me tepër gjykata supreme tanimë ka lëshuar aktvendim mbi zgjatjen e hetimeve dhe trupi gjykues në plotësi i përmbahet këtij aktvendimi dhe konstaton se zgjatja është në pajtim të plotë me ligjin dhe gjithashtu konstaton se edhe aktakuza është ngritur brenda afatit ligjor. Ankesa e mbrojtjes ishte refuzuar si e pabazë.

#### D. Lidhja logjike dhe kuptueshmëria e dispozitivit

Mbrojtja pretendon se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm në materie dhe në kundërshtim me faktet të cilat jepen në aktgjykim, dhe se aktgjykimi ka mungesë të fakteve të mjaftueshme për burgim. Mbrojtja pretendon se aktgjykimi i atakuar nuk është i propozuar në përputhshmëri me nenin 396 paragrafi 12 i KPPPK.

Kjo bazë e ankesës ishte refuzuar si e pabazë.

Dispozitivi është i qartë, logjik nuk është në kundërshtim me veten apo arsyetimin. Dispozitivi ofron përshkrim me lidhje logjike dhe të kuptueshëm të fakteve vendimtare dhe përmban të gjitha shënimet e duhura të parapara me nenin 396, paragraf 3 dhe 4, KPPPK në lidhje me nenin 391 të KPPPK.

Dispozitivi është plotësisht në lidhje logjike me arsyetimin e aktgjykimit të atakuar dhe reflekton të gjeturat të cilat elaborohen në të. Gjykata themelore ka paraqitur fakte për secilën pikë veç e veç në vendim të saj, në përputhshmëri me nenin 396, paragrafi 6, KPPPK.

Dispozitivi i lexuar së bashku me dispozitën e detajuar të aktgjykimit të atakuar ofron vlerësim gjithëpërfshirës, të provave dhe fakteve të gjykatës themelore janë konsideruar si të provuara dhe jo të provuara. Në pajtim me nenin 396, paragraf 7, KPPPK, gjykata themelore gjithashtu ka kryer vlerësim të detajuar të besueshmërisë së provave dhe arsytet që kanë shpënë gjykatën themelore në zgjidhjen e pikave faktike dhe ligjit.

Dispozitivi përmban tërë informacionin i cili konsiderohet të jete i obligueshëm.

Trupi gjykues i gjykatës së apelit e ndryshon dispozitivin e gjykatës themelore kur kërkohet edhe pajtim me gjetjet e cekura më lart.

#### E. Pranueshmëria e provave

##### *a. Kontrolli i objekteve të klinikes MEDICUS*

Mbrojtja pretendon se kontrolli i objekteve të klinikes Medicus dhe konfiskimi i provave aty janë të papranueshme, derisa prokuroria pretendon se kontrolli dhe konfiskimi i provave janë të pranueshme.

Çështja e ligjshmërisë të këtij kontrolli dhe konfiskimi janë diskutuar dhe shqyrtuar në detaje nga gjykata themelore në faqet nga 27 deri 45 të aktgjykimit të atakuar. Pas një analize të kujdesshme kushtuar vlerësimit dhe dosjes së lëndës si tërësi, trupi gjykues bien përfundim tjetër nga ai i gjykatës themelore. Trupi gjykues më tej shton se kontrolli i lokaleve të klinikës Medicus dhe konfiskimi i provave ishin të papranueshëm. Trupi gjykues pajtohet plotësisht me vlerësim e dhënë nga ana e gjykatësit Vitor Hugo Pardal në aktvendimin PPS.Nr.02/2009 lëshuar nga gjykata themelore e Prishtinës me datën 31 janar 2011. Trupi gjykues do t'i miratojë analizat dhe konkludimet e këtij aktvendimi si të veta dhe rithekson si në vijim (me disa korrigjime gramatikore):

“Siç parashihet me nenin 200, paragrafi 1 të KPPPK, “Policia heton veprat penale dhe pa vonesë ndërmerr të gjitha masat në mënyrë që të parandalohet fshehja e provave”. Ky nen duhet të merret si parim bazë lidhur me qëllimin e policisë gjyqësore (detyrat e përgjithshme dhe kompetencat e policisë – nënkapitulli 1, kapitulli XIII i KPPPK). Me këtë pra parashihet që të gjitha masat e pranueshme ligjore duhet ndërmarr pa vonesë. Për më tepër, sipas nenit 201, paragrafi 1, policia detyrohet (...) të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme (...) për të përcaktuar dhe të ruajë gjurmët dhe provat tjera (...) dhe sendet të cilat mund të shërbejnë si prova (...). Kurse sipas në paragrafin 2 thuhet, “policia ka autorizim të (...) ndërmarrë hapa të duhur për të përcaktuar identitetin e (...) sendeve (nën paragraf 4); konfiskojë sendet (...) (nën paragraf 7)”. Sidoqoftë, autorizimi për të ndërmarrë këta hapa nuk mund të konsiderohet përtej të gjitha këtyre neneve, posaçërisht atyre që parashohin procedurat gjegjëse. Përndryshe, disa kufizime siç parashihen, për shembull, nga neni i njëjtë do ishin absolutisht të padobishme (si kufizimi i kontrollimit vetëm për vetura, udhëtarë dhe bagazhin e tyre, ose kufizime për sa i përket subjekteve publike vetëm nën prezencën e personit përgjegjës, respektivisht nën paragrafi 2 dhe 6). E njëjta vlen edhe për të gjitha kufizimet sipas nenit 204 të KPPPK-së. Përveç kësaj, neni 245 i KPPPK-së në lidhje me kushtet me rastin e kontrollit të kryer nga ana e policisë gjyqësore do të ishte gjithashtu i padobishëm. Kështu që, një interpretim kaq preciz, hermeneutik dhe sistematik i neneve të cekura më lart shpion në një përfundim të pakontestueshëm: neni 240 deri 253 i KPPPK-së që thekson në veçanti kontrollin dhe konfiskimin e përkohshëm gjithëherë duhet të mbizotëroj dhe nuk duhet lënë asnjë zbrazëti për sa i përket përmbajtjes së neneve 200 dhe 201 të KPPPK-së. Ky është interpretimi i vetëm i mundshëm sipas nenit 36 paragraf 2 të kushtetutës së Kosovës sipas së cilës. “Kontrollet e çfarëdo vendi privat ose pasi që të vërtetohet se është e nevojshme që të zhvillohen hetime kundër një krimi dhe zgjaten vetëm nëse shihet e nevojshme dhe vetëm pasi ta këtë miratuar gjykata dhe vetëm pas shpalesjes së arsyetimeve se pse ky kontroll do t'i ishte i domosdoshme. Shmangja nga këto rregulla lejohet veten nëse shihet e nevojshme dhe nëse arrestimi është i ligjshëm, ka për qëllim grumbullimin e provave që janë në rrezik për tu humbur ose të behet shmangja direkte

dhe nëse paraqitet rreziku serioz ndaj njerëzve dhe pasurisë siç parashihet me ligj. Gjykata duhet në mënyrë retroaktive të miratojë veprimet e tilla”.

Duke marrë parasysh se, kontrolli i kryer duhet gjykuar kryekëput sipas përmbajtjes së veçantë dhe interpretimit të drejt të neneve 240 deri 253 të KPPPK-së.

Kjo gjetje nuk e mbyll çështjen. Nëse sipas nenit 240 të KPPPK-se Gjyqtari i procedurës paraprake mund të urdhërojë kontrollin e një shtëpie, të lokaleve të tjera dhe të pronës (paragrafi 1) ku vjen deri te plotësimi i kushteve ligjore dhe faktike për ta ndërmarrë një veprim të tillë (paragrafi 2). Gjithashtu duhet të sigurohen disa procedura strikte me rastin e ndërmarrjes së një veprimi të tillë (neni 242 dhe 243 i KPPPK-së).

Sidoqoftë, ato procedura ligjore mund të jenë subjekt përjashtimi nën kushte të jashtëzakonshme të parapara me nenin 36 paragraf 2 i kushtetutës së Kosovës. Ato kushte dhe përjashtimi i procedurave në mënyrë specifike parashihen me nenin 245, paragraf 1 të KPPPK, sipas të cilit, “Kur është e domosdoshme dhe në masë të nevojshme, policia mund të hyjë në shtëpinë dhe lokalet tjera të personit dhe të zbatojë kontrollin pa urdhrin e gjyqtarit të procedurës paraprake nëse (...) Personi përkatës me dije dhe me vullnet pajtohet me kontrollin (pika1); Personi thërret për ndihmë (pika 2); Kryerësi i kapur në flagrancë gjatë kryerjes së veprës penale duhet arrestuar pas ndjekjes (pika 3); Arsyet për mbrojtjen e njerëzve dhe pasurisë e kërkojnë një veprim të tillë (pika 4) ose Personi kundër të cilit është lëshuar urdhërarrest nga gjykata gjendet në shtëpi apo në lokale të tjera (nëpar. 5).

Është e qartë se, nëse varet prej kryetarit të trupit gjykues të autorizojë dhe urdhërojë kontrollin e lokaleve dhe pronës, kjo është gjithashtu e mundshme, në rrethana urgjente siç e parasheh edhe ligji, policia mund ta kryej kontrollin pa ndonjë urdhër të tillë kontrolli e që lëshohet paraprakisht në përputhshmëri me procedurat siç parashihet me nenin 240, paragrafi 4, neni 245 dhe paragrafët 2,3,4 dhe 6 të KPPPK-së.

Duke e marrë parasysh rastin konkret dhe kushtet e renditura sipas nenit 245, paragrafi 1 dhe nën paragrafët 1 dhe 5 të KPPPK-së, kontrolli e kryer mund të qëndroj vetëm sipas nën paragrafit 4- “arsyet e sigurisë së personave (...) e kërkojnë një gjë të tillë”. Në fakt, është e qartë se asnjë pajtim nuk është dokumentuar me dosje, asnjë person nuk ka kërkuar ndihmë, asnjë kryes i veprës nuk është zënë në vepër dhe nuk është lëshuar asnjë urdhërarrest paraprakisht nga gjykata, pra nuk ka nuk ka arsye tjera që merren për bazë lidhur me të.

Sipas të njëjtit nen, paragrafët 3 dhe 6, “përjashtimisht, në rrethana të ngutshme, kur urdhri me shkrim për kontroll nuk mund të merret me kohë dhe nëse ekziston rrezik real për vonesë, që mund të rezultojë me humbjen e provave, ose rrezik ndaj jetës ose shëndetit të njerëzve, policia gjyqësore mund të fillojë kontrollin në bazë të lejes gojore

nga gjyqtari i procedurës paraprake” dhe “kur policia ndërmerr kontroll pa urdhër të shkruar gjyqësor ajo brenda aftit njëzet e katër orësh lidhur me këtë i dërgon raport prokurorit publik dhe gjyqtarit të procedurës paraprake nëse për këtë çështje është caktuar ndonjë gjyqtar i procedurës paraprake.

Duke analizuar nenet e cekura më lart ne do të marrim parasysh këto: për të hyrë në shtëpi ose lokal të ndonjë personi, policia duhet së pari të këtë të lëshuar një urdhër gjyqësor, përveç në rastet kur verifikohet sipas paragrafëve 1, pikat 1 dhe 5. Sidoqoftë, për të kryer kontroll duhet të lëshohet urdhri me shkrim paraprakisht nga gjykatësi paraprak, përveç kur në kushtet të parapara me paragrafin 3, dhe gjithashtu urdhri gojor merret nga gjykatësi paraprak. Arsyeja për këtë ndryshim është gjithashtu e kuptueshme: urgjenca e hyrjes në shtëpi apo lokale mund të mos jetë ne nivel me zhvillimin e kontrollit që pason, pasi masa të tjera mund të aplikohen, gjegjësisht mundësia sipas ligjit të kufizohet liria e lëvizjes në atë zonë të veçantë e cila ka për tu konsideruar si masë domosdoshmërisht e nevojshme, siç kërkohet edhe me kushtetutën e Kosovës, me nenin 36, paragrafi 2.

Sipas nenit 246 të KPPPK-së, “provat e mbledhura nëpërmjet kontrollit janë të papranueshme nëse: kontrolli është zbatuar pa urdhër të gjyqtarit të procedurës paraprake në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi paragrafi 1); personat, prania e të cilëve është e detyrueshme, nuk kanë qenë të pranishëm gjatë kontrollit – pronari ose përfaqësuesi i tij dhe 2 dëshmitarë (paragrafi 5 sipas nenit 243, paragrafët 1 dhe 2 të këtij Kodi); ky kontroll ishte kryer në shkelje të nenit 245, paragrafët 1, 3, 4 dhe 5 të kodit aktual (paragrafi 6)”.

Duke marrë parasysh arsyet e ngritura, në mënyrë që të ndërmerret një kontroll, ashtu siç ishte ndërmarrë nga policia gjyqësore, i cili do të ishte valid dhe e të gjitha provat e lidhura përmes këtij kontrolli të jenë të pranueshme, urdhri me shkrim duhet të lëshohet paraprakisht, ndryshe, ekziston rrezik i dukshëm i vonesës që mund të çoj edhe në zhdukjen e provave ose rrezikim të jetëve dhe shëndetit të njerëzve – ose arsyeja e sigurisë së personave edhe urdhri gojor, sipas nenit 245, paragrafi 1, nën paragrafi d) duhet të vërtetohet nga kryetari i trupit gjykues (neni 245, par 3 të KPPPK-së). Nëse kjo është e obligueshme madje edhe për nisjen e kontrollit, atëherë aq më tepër është e obligueshme edhe kur ta kryej vet kontrollin e duhur.

Duke marrë parasysh analizën ligjore dhe kornizën faktike bazuar në vlerësimet e dokumentacionit në dispozicion, pasoja ligjore duhet të jete papranueshmëria e të gjitha provave të nxjerra me këtë kontroll.

Për sa i përket nenit 3 paragrafi 6 i Ligjit mbi Inspektoratin Shëndetësor, “me qëllim të zbatimit të autorizimeve ligjore nga fushë veprimtaria e tij Inspektorati Shëndetësor bashkëpunon dhe koordinon veprimtarin e tij edhe me Inspektoratin e Punës, Inspektoratin Sanitar, Inspektoratin e Mjedisit, Inspektoratin Ujor dhe Inspektoratet tjera përkatëse, Prokuroritë, Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK) si dhe me Shërbimin Policor të Kosovës (SHPK).”

Sa i përket nenit 7, paragrafët 1, 2, 4 dhe 8, “Inspektorët shëndetësor kanë autorizimin për qasje të papenguar në inspektimin e implementimit të akteve normative të institucioneve shëndetësore. Inspektori Shëndetësor hyn lirshëm në çdo kohë dhe në çdo vend pune në institucionin shëndetësor në suaza të inspektimit të tyre pa paralajmërim. Bënë inspektimin dhe hulumtimin e domosdoshëm për mbledhjen e provave që konsiderohen të rëndësishme për të siguruar se dispozitat ligjore nga ana e institucioneve shëndetësore janë duke u zbatuar. Bënë kontrollimin e të gjitha librave dhe dokumentet të cilat duhet t’i mbaj institucioni shëndetësor”.

Së fundi, sipas nenit 7 paragrafi 9, “Inspektori ka autorizim të kopjoj ekstrakte nga regjistrat dhe dokumentacioni t’i konfiskoj në raste nevojë të dëshmisë në prani të personelit apo dëshmitarëve, duke hartuar procesverbalin mbi konfiskimin e materialeve nga institucioni shëndetësor i caktuar, duke iu përmbajtur rregullave (apo akteve nënligjore) të parapara për ruajtjen e fshehtësisë së pacientit dhe institucionit(...)”. Interpretimi abuzues dhe mashtrues i neneve të cekura më lart do t’i mundësonte një kontrollim nga ana e prokurorisë ose nga policia e Kosovës, në bashkëpunim dhe në bashkërenditje me inspektoratin shëndetësor – në vend se ndiqnin autorizimin gjyqësor – për të zbatuar autorizimet ligjore nga fusha e veprimtarisë, pasi që inspektorati ka të drejtë me ligj të hyjë por edhe të kontrollojë dhe të konfiskojë prova.

Sidoqoftë, vlen të mbahet në mend kontrolli konkret nuk ishte i motivuar nga arsye shëndetësore siç parashihet me nenin 2 dhe 6 të ligjit në fjalë por “transplantimi i veshkës dyshohet se ka ndodhur pasi personi/shtetasi Turk i cili ishte arrestuar nga policia e Kosovës kishte deklaruar se e kishte shitur një veshkë në atë spital”, ndryshe nga ajo, siç përmendet në raportin e Z. K.. Në anën tjetër raporti i A. G. e thotë qartë se “me urdhër të prokurorit z. O. M. nga prokuroria e qarkut, ishte vendosur të bllokohen të gjitha lokalet e ndërtesës, dhe në ato tek të cilat do të duhej të ishin subjekt ekzaminimi ditëve në vijim”. Ishte e qartë se kishim të bënim me një kontroll kriminal, të motivuar pikërisht nga arsye kriminale, me urdhër të prokurorit, provat e siguruara ishin administruar në procedurën penale. Nuk ka qenë bashkëpunim i thjeshtë zbatimi i veprimeve sipas autorizimeve ligjore nga fusha e shëndetësisë.

Një rast i ngjashëm – Funke vs. France (Ank. 10828/84 me datën 25 shkurt 1993, numri Serial A no.256-A (1993) 16 EHRR 297 – duhet të adresohet këtu me një interpretim të ngjashëm, mutatis mutandis, por duke iu referuar forcave specifike me pushtet si policia



doganore dhe lidhjet e tyre me procedurën penale. Në këtë rast është marrë parasysh se shtrëngimet dhe kufizimet të siguruara që janë të parapara në ligj nuk mund të jenë shumë të pasakta dhe përplot me shtigje për ndërhyrje që të jenë proporcionale pikërisht me qëllimin e ushtruar legjitim. Dhe gjithmonë është e vlefshme të përmendim nenin 53 të Kushtetutës së Kosovës sipas së cilës “interpretimi i të drejtave të njeriut dhe lirive fundamentale duhet të interpretohet në përputhje me vendimin e gjykatës GJEDNJ”.

*b. Pasojat e bastisjes së kundërligjshme*

Si pasojë Trupi gjykues po ashtu vjen me të njëjtin përfundim sikur Gjyqtari Vitor Hugo Pardal në vendimin PPS.no.02/2009 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të datës 31 janar 2011, sa i përket disa provave të caktuara të papranueshme të konfiskuara gjatë bastisjes. Megjithatë kolegji shqyrtues e ka konfirmuar aktakuzën dhe ka përcaktuar se të gjitha dëshmitë e kundërshtuara është dashur të konsiderohen si të pranueshme, kolegji nuk i kufizuar me këtë vendim. Siç është theksuar më lartë në detaje, Kolegji është i mendimit se dëshmitë e caktuara janë marrë në kundërshtim me ligjin. Në pajtim me nenin 246 KPPK-së një dëshmi e tillë duhet të jetë e papranueshme. Për të përcaktuar se çfarë dëshmie specifike duhet të deklarohet si e papranueshme Kolegji duhet të zbatojë doktrinën e “frutat e rrënjës së helmuar”, kryesisht nëse burimi (“pema”) e dëshmisë apo vetë dëshmia është e kalbur, atëherë çdo gjë e fituar (“frutat”) nga janë të kalbura po ashtu. Sidoqoftë, përjashtime të caktuara mund të zbatohen, kryesisht nëse dëshmia është zbuluar në pjesë si rezultat i një burimi të paprishur dhe të pavarur apo nëse dëshmia në mënyrë të pashmangshme është zbuluar pavarësisht burimit të prishur po ashtu. Duke zbatuar doktrinën e lartpërmendur e “frutat e pemës së kalbur” Kolegji konsideron se dëshmia e papranueshme në vijim duke parë se është marrë drejtpërdrejt përmes bastisjes së kryer dhe/ose është bazuar drejtpërdrejt në bastisje, përderisa nuk është e mundur që të merret përmes burimeve të ndryshme, të pa prishura:

1. Librat e klinikës dhe dokumente tjera të konfiskuara gjatë bastisjes (Dosja IV. Faqe 6 deri 150);
2. Fotot e marra gjatë dhe pas bastisjes (Dosja V. Faqe 80)
3. Raporti i ekzaminimit të ekspertit për objektet e konfiskuara (Dosja V, faqe 128-131) e datës 20 janar 2009;
4. Rishikimi i dëshmive: krahasimi i librave të regjistrimit si dëshmi e konfiskuar (Dosja VII, faqe 647), e datës 9 korrik 2009;
5. Raportimi për ekspertizën në lidhje me dëshminë e konfiskuar gjatë bastisjes, e datës 9 korrik 2009, dhe 4 gusht 10 (Dosja VIII, faqe 1086, 1140 dhe 1144);
6. Rezultatet e analizave të regjistrit të Klinikës Medikus, e datës 24 nëntor 2010 (Dosja, dëshmitë pas ngritjes së Aktakuzës, faqe 75 deri 80);
7. Dëshmitë e renditura si rezultat i konfiskimit gjatë bastisjes (Dosja, dëshmitë pas ngritjes së Aktakuzës, faqe 45).
8. Fotot e marra gjatë bastisjes (Dosja A dhe B).

Siç është theksuar më lartë, çdo dëshmi e cila në mënyrë të pashmangshme do të zbulohet pa një bastisje duhet sidoqoftë të konsiderohet si e pranueshme. Kolegji konstaton se çdo listë e donatorëve eventual dhe/ose pranuesve mund të bazohet në listën e siguruar nga hyrjet dhe daljet nga regjistri zyrtar në kufi, dokumentet e udhëtimit dhe biletat e aeroplanit të lëshuara po ashtu nga të gjithë garantuesit dhe letrat ftesë të aplikuara dhe të siguruar para bastisjes. Edhe pse emrat e njëjtte mund të konfirmohen në librat e klinikës dhe regjistrat e konfiskuara, ky nuk ka qenë burimi definitiv i tyre. Për më tepër, zbulimi i dëshmitarit nuk është dëshmi në vete sepse dëshmitari është zbutur nga intervista të ndara, dëshmia në gjykatë dhe deklaratat e tij/saj. Duke marrë parasysh këtë, të gjitha deklaratat e dëshmitarëve me këtë konsiderohen dëshmi e pranueshme.

Me arsyetim të ngjashëm si më lartë , kryesisht bastisja duke mos qenë mjet i vetëm apo burim për marrjen e dëshmive, dëshmitë në vijim mendohen të jenë si të pranueshme:

- Të gjitha deklaratat e dëshmitarëve, si të detajuara në faqen 53 deri 88 dhe 107 deri 112 të aktgjykimit të kundërshtuar;
- Hyrje dhe daljet e të dhënave të Donatorëve, Pranuesve, Doktorëve të Huaj dhe të Tjera, sic janë dhënë në detaje në faqe 93 - 98 në aktgjykimin e kundërshtuar;
- Ekspertiza Mjekësore e Forensikës e përgatitur nga Dr. C. B. në lidhje me Donatorët DS dhe AK, siç janë dhënë në detaje në faqe 88 – 89 në aktgjykimin e kundërshtuar;
- Shkëmbimi i Emailave, siç është dhënë në detaje në faqe 98 – 104 në aktgjykimin e kundërshtuar;
- Përgjimi i Thirrjeve Telefonike, siç janë dhënë në detaje në faqe 112 në aktgjykimin e kundërshtuar;
- Komisioni i Etikës, siç është dhënë në detaje në faqe 112 në aktgjykimin e kundërshtuar;
- Ftesat, siç është dhënë në detaje në faqe 112 në aktgjykimin e kundërshtuar.

#### *c. SMS*

Prokuroria parashton se përmbajtja e tekst porosive SMS duhet të konsiderohet si pjesë e përgjimeve të thirrjeve telefonike, për të cilën urdhri nga Prokuroria është i mjaftueshëm, sidoqoftë është e pranueshme.

Kolegji refuzon ankesën e prokurorit dhe miraton dhe konfirmon konstatimet e Gjykatës Themelore se informacionet e tekst porosive SMS mund të zbulohen vetëm me një urdhër të lëshuar nga gjyqtari i procedurës paraprake sipas nenit 258, paragrafi 2, nën-paragrafi 4, KPPPK-së, sidoqoftë dëshmia është e papranueshme sipas nenit 264, paragrafi 1, KPPPK-së.

#### F. Vërtetimi i Gjendjes Faktike

Mbrojtja parashtron se Gjykata Themelore nuk i ka vlerësuar drejt dëshmitë e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe si pasojë ka ardhur në përfundim të gabueshëm në lidhje me veprat penale dhe rolit të pandehurve.

Para vlerësimit meritor të argumenteve, të paraqitura nga mbrojtja në lidhje me vërtetimin e gabueshëm dhe jo të plotë të fakteve, Kolegji e përsërit standardin e shqyrtimit sa i përket konstatimeve faktike të dhëna nga trupi gjykues.

Nga neni 405 KPPPK-së është e qartë se për ankuesin nuk është i mjaftueshëm demonstrimi vetëm për gabimin e pretenduar të fakteve apo vërtetimit jo të plotë faktik nga trupi gjykues. Më saktë, pasi që kodi i procedurës penale kërkon që vërtetimi i gabueshëm dhe jo i plotë i gjendjes faktike ka të bëjë me “faktet materiale”, ankuesi duhet po ashtu të konstatojë se vërtetimi i gabueshëm dhe jo i plotë i gjendjes faktike se vërtetë lidhet me faktet materiale, i.e. është kritike për aktgjykimin e arritur<sup>1</sup>. Për më tepër, është parim i përgjithshëm i procedurës ankuese që Gjykata e Apelit duhet të japë kufirin e respektimit për konstatimet e faktit të nxjerrë nga trupi gjykues sepse është trupi gjykues ai që më së miri vendos për vlerësimin e dëshmimeve. Gjykata Supreme e Kosovës shpeshherë ka mbajtur se duhet “*ti respektojë vlerësimet nga trupi gjykues për kredibilitetin e dëshmitarëve të gjykatës të cilët janë shfaqur individualisht para tyre dhe të cilët kanë dëshmuar individualisht para tyre. Nuk është e drejtë për Gjykatën Supreme të Kosovës që të shkel vlerësimin e trupit gjykues për kredibilitetin e atyre dëshmitarëve përveç nëse ka ndonjë përshtypje të bazuar për ta bërë.*”. Standardi të cilin Gjykata Supreme e Kosovës e ka zbatuar ka qenë “*mos i pengoni konstatimet e trupit gjykues përveç nëse dëshmia në të cilën mbështetet trupi gjykues nuk ka mundur të pranohet nga ndonjë gjykatë e arsyeshme faktike, apo ku vlerësimi i saj ka qenë i gabueshëm në tërësi*”<sup>2</sup>.

Sic është thënë më lartë, Kolegji ka rishqyrtuar vlerësimin e Gjykatës Themelore sa i përket dëshmisë së pranueshme dhe konstaton si në vijim.

*a. Deklaratat e dëshmitarëve dhurues të veshkave dhe pranuesve (dhe/ose të afërmve të tyre)*

Kolegji ka shqyrtuar analizat në tërësi të Gjykatës Themelore në lidhje me deklaratat e dëshmitarëve apo të donatorëve të veshkave, siç është cekur në faqe 53 deri 69 në aktgjykimin e kundërshtuar. Kolegji po ashtu ka shqyrtuar analizat në tërësi të deklaratave të dëshmitarëve dhe të pranuesve dhe/ose të afërmve, siç është cekur në faqe 69 deri 87 në aktgjykimin e kundërshtuar. Për më tepër Kolegji në mënyrë të pavarur ka shqyrtuar të gjitha deklaratat e dëshmitarëve. Sipas pikëpamjes së Kolegjit, Gjykata Themelore vjen me një përfundim logjik në vlerësimin e dëshmimeve, siç janë shpjeguar në

<sup>1</sup> Shihni po ashtu B. Petric në: Komentarin për nenet në Procedurën Penale të Ligjit të Jugosllavisë, Edicioni I 2-të 1986, neni 366, paragrafi I.3

<sup>2</sup> Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZi 84/2009, 3 dhjetor 2009, paragrafi 35; Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZi 2/2012, 24 shtator 2012, paragrafi 30

faqen 87-88. Kolegji konstaton se nuk ka arsye për të dyshuar në kredibilitetin e deklaratave të dëshmitarëve. Dhe Kolegji as nuk e konstaton se Gjykata Themelore në mënyrë jo korrekte i ka interpretuar deklaratat e dëshmitarëve. Kolegji plotësisht miraton dhe konfirmon se analizat e Gjykatës Themelore se donatorët e veshkave janë rekrutuar, transportuar, transferuar, janë pranuar dhe fshehur. Për më tepër, donatorët e veshkave kanë qenë subject për keqpërdorimin e pozitave të tyre e dobësisë, të detyruar dhe mashtruar dhe/ose të gënjer. Kolegji e konfirmon se donatorët e veshkave janë shfrytëzuar me heqjen e veshkave të tyre.

*b. Deklaratat e dëshmitarëve të tjerë në dijeni për aktivitetet*

Po ashtu, Kolegji ka bërë administrimin e analizave të thukëta të Gjykatës Themelore lidhur me deklaratat e dëshmitarëve tjerë me njohuri për aktivitetet siç janë paraqitur nga faqja 107 deri 112 të aktgjykimit lëndor. Për më tej Kolegji në mënyrë autonome edhe një herë ka bërë shqyrtimin e të gjitha deklaratave të dëshmitarëve. Kolegji gjen se Gjykata Themelore ka ardhur në një përfundim logjik në vlerësimin e saj lidhur edhe me këtë provë. Kolegji gjen se Gjykata Themelore në mënyrë të drejtë ka interpretuar deklaratat e dëshmitarëve. Kolegji në tërësi miraton dhe vërteton analizën e bërë nga Gjykata Themelore. Krahas provave tjera mbështetëse të përmendura më poshtë, Kolegji gjen se të pandehurit L. D., A. D. dhe S. H. ishin substancialisht të përfshirë në Trafikimin me Njerëz dhe se të pandehurit L. D., A. D. dhe S. H. ishin të përfshirë edhe në krim të organizuar.

*c. Provat mbështetëse*

Gjykata Themelore në detaje ka analizuar edhe provat tjera mbështetëse. Kolegji përsëri nuk ka gjetur ndonjë gabim në arsyetimin e dhënë nga Gjykata Themelore dhe në tërësi i miraton analizat dhe përfundimet e nxjerra. Provat në vijim mbështesin konstatimin se të pandehurit L. D., A. D. dhe S. H. ishin substancialisht të përfshirë në Trafikim me Njerëz dhe se të pandehurit L. D., A. D. dhe S. H. ishin të përfshirë edhe në krim të organizuar:

- Ekspertiza e mjekësisë ligjore e përgatitur nga Dr. C. B. lidhur me dhuruesit DS dhe AK, faqe 88 deri 89 e aktgjykimit lëndor;
- Raportet e hyrjes dhe daljes së dhuruesve, marrësve, mjekëve të huaj dhe të tjerëve, faqe 93 deri 98 të aktgjykimit lëndor;
- Shkëmbimet e postës elektronike, faqe 98 deri 104 të aktgjykimit lëndor;
- Regjistrimi i thirrjeve telefonike, faqja 112 e aktgjykimit lëndor
- Komisioni etik, faqja 112 e aktgjykimit lëndor
- Letrat e ftesave, faqja 112 e aktgjykimit lëndor.

*d. Numri i veshkave të transplantuara*

Edhe pse Kolegji mbështet vlerësimin e Gjykatës Themelore se transplantimi i veshkave është bërë në Klinikën Medikus, Kolegji gjen se mjafton dëshmia që e provon se janë bërë shtatë transplantime të veshkave, respektivisht të Dëshmitarëve të Mbrojtur W2, W1, W3, viktimat PM, DS, AK dhe Y. A.. Provat e këtyre transplantove specifike drejtpërdrejtë bazohen në dëshmitë e

viktimave (gjashtë dhurues të veshkave kanë dëshmuar gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe një dhurues i veshkës ka dëshmuar gjatë fazës së procedurës paraprake) dhe provave tjera të diskutuara nën pikat e mësipërme *a, b dhe c*. Për shtatëmbëdhjetë transplantimet tjera të veshkave të provuara fillimisht nga ana e Gjykatës Themelore, Kolegji gjen se nuk ka prova të mjaftueshme se këto transplantime të kenë ndodhur, duke e parë si provë të siguruar drejtpërdrejtë përmes bastisjes së bërë siç janë: regjistrat e Klinikës dhe dokumentet tjera, e cila provë është e papranueshme meqë nuk ka prova tjera të mjaftueshme lidhur me datën e saktë për operimet tjera të transplantimeve të pretenduara dhe nuk ka të dhëna personale për dhuruesit dhe pranuesit përkatës të pretenduar.

#### *e. Përfundim*

Në përfundimin e tij, Kolegji gjen se Gjykata Themelore ka gabuar kur ka vërtetuar se në Klinikën Medikus janë bërë njëzet e katër transplantime të veshkave. Me këtë është shkelur neni 405 i KPPK dhe Kolegji gjen se Gjykata Themelore gabimisht ka konstatuar gjendjen faktike. Prandaj Kolegji duhet që të ndryshojë aktgjykimin lëndor për sa i përket numrit të provuar të transplantimeve të veshkave të kryera në Klinikën Medikus në të cilin krimi i organizuar, duke përfshirë të pandehurit L. D., A. D. dhe S. H., duhet të ndryshohet në shtatë transplantime e jo në njëzet e katër.

Sa i përket shtatë transplantimeve të veshkave, prova të caktuara të papranueshme nuk duhet të përdoren për të vërtetuar gjendjen faktike lidhur me këto transplantime. Sidoqoftë, me pjesën e mbetur të provave të pranueshme, ekziston dëshmi e mjaftueshme se këto transplantime kanë ndodhur dhe se ka ekzistuar krimi i organizuar ku janë përfshirë të pandehurit L. D., A. D. dhe S. H.. Prandaj, sa i përket këtyre shtatë transplantimeve të veshkave, Gjykata Themelore nuk e ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike. Nuk ka as prova të cilat e vënë në pikëpyetje saktësinë ose bazueshmërinë e vërtetimit të fakteve të rëndësishme. Me këtë, sa i përket vlerësimit për shtatë transplantimeve të lartpërmendura, neni 405 i KPPK nuk është shkelur dhe Kolegji gjen se Gjykata Themelore me të drejtë dhe në tërësi e ka vërtetuar gjendjen faktike.

Ankesat e mbrojtjes pjesërisht janë aprovuar.

#### G. Ligjshmëria e transplantimit të veshkave në Kosovë

Mbrojtja ka parashtruar se transplantimi i veshkave është kryer në përputhje të plotë me Ligjin e Kosovës për Shëndetësi, në njërën anë dhe në anën tjetër, të pandehurit të kenë vepruar në mirëbesim se transplantimet e veshkave janë bërë në përputhje të plotë me Ligjin e Kosovës për Shëndetësi.

Në faqet 45 deri 52, Gjykata Themelore në detaje ka diskutuar nëse transplantimet e veshkave janë kryer apo jo në harmoni me Ligjin e Kosovës për Shëndetësi. Kolegji nuk ka gjetur ndonjë gabim në arsyetimin e dhënë nga Gjykata Themelore. Kolegji vjen në përfundim se transplantimi i veshkave i kryer në Klinikën Medikus është kryer duke shkelur Nenin 46, pika (d) e Ligjit të Kosovës për Shëndetësi<sup>3</sup> dhe se dokumenti i datës 12 maj 2008 i lëshuar nga ana e I. R.t ishte thjeshtë një letër informative e që për efekt kishte të bëjë me atë se sikur të miratohej legjislacioni konkret për autorizim në ndonjë të ardhme, atëherë Klinikës Medikus, “në parim”, do t’i lejohej kryerja e transplantimeve të veshkave. Sipas kushteve të tij, ky dokument nuk paraqiste ndonjë licencë apo autorizim; nuk ishte menduar të jetë një licencë ose autorizim; nuk ishte kuptuar nga ana e Klinikës Medikus që ai të jetë një licencë apo autorizim dhe nuk ishte përdorur si një licencë apo autorizim. Ky dokument nuk i jep ndonjë autorizim përveç se ishte vetëm i një natyre informative. Prandaj, transplantimet e veshkave të kryera në Klinikën Medikus kanë qenë të kundërligjshme.

Duke qenë drejtor, përkatësisht menaxher, përkatësisht anesteziolog kryesor i Klinikës, të pandehurit L. D., A. D. dhe S. H. më së paku është dashur të jenë në dijeni se transplantimi i veshkave është i kundërligjshëm. Duke e pasur parasysh përvojën dhe ekspertizën e tyre të kombinuar profesionale, kolegji e refuzon pohimin se të pandehuri në fjalë kanë vepruar në mirëbesim.

Me këtë, ankesat e mbrojtjes refuzohen si të pabazuara.

Për më tej, nëse transplantimet e veshkave ishin apo jo në përputhje të plotë me Ligjin e Kosovës për Shëndetësi, për pjesën më të madhe është jo-relevante për përcaktimin e veprës penale të Trafikimit me Njerëz. Kjo prekë vetëm elementin e “lajthitjes” i cili do të diskutohet me poshtë.

## H. Trafikimi me njerëz

### a. *Vepra penale*

Nuk është e kontestueshme se transplantimi i veshkave ka ndodhur në Klinikën Medikus. Megjithatë, mbrojtja konteston atë se transplantimi i veshkave përbën një vepër penale.

Neni 139 i KPPP të Kosovës paraqet atë si në vijim:

#### Trafikimi me Njerëz

(1) Kushdo që merr pjesë në trafikimin e njerëzve dënohet me burgim prej dy deri në dymbëdhjetë vjet.

---

<sup>3</sup> Aktivitetet private shëndetësore nuk lejohen në fushat në vijim:

d) Mbledhja, ruajtja, transporti dhe transplantimi i indeve dhe organeve njerëzore përveç në rastet e auto-transplantimit;

(2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet kundër personit nën moshën 18 vjeçare, kryerësi dënohet me burgim prej tre deri në pesëmbëdhjetë vjet.

(3) Kushdo që organizon një grup personash për të kryer veprën nga paragrafi 1 i këtij neni dënohet me gjobë deri në 500.000 euro dhe me burgim prej shtatë deri në njëzet vjet.

(4) Kushdo që nga pakujdesia lehtëson kryerjen e trafikimit me njerëz dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

(5) Kushdo që përdor ose siguron shërbime seksuale të një personi për të cilin e dinë se personi i tillë është viktimë e trafikimit, dënohet me burgim prej tre muaj deri në pesë vjet.

(6) Nëse vepra penale nga paragrafi 5 i këtij neni kryhet kundër personit nën moshën 18 vjeçare, kryerësi dënohet me burgim prej dy deri në dhjetë vjet.

(7) Nëse vepra penale nga ky nen kryhet nga personi zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës së tij kryerësi dënohet me burgim prej pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet për veprën penale nga paragrafët 1 ose 2, me burgim prej së paku dhjetë vjetësh për veprën penale nga paragrafi 3, me burgim prej dy deri në shtatë vjet për veprën penale nga paragrafët 4 ose 5 ose me burgim prej pesë vjetësh deri në dymbëdhjetë vjet për veprën penale nga paragrafi 6.

(8) Sipas këtij neni dhe nenit 140,

1) Shprehja "trafikim me njerëz" do të thotë rekrutim, transportim, transferim, strehim ose pranim i personave me anë të mjeteve të kërcënimit ose të përdorimit të forcës apo me forma të tjera të detyrimit, rrëmbimit, falsifikimit, mashtrimit, apo keqpërdorimit të pushtetit apo të pozitës ose të një pozite të ndjeshme ose me anë të dhënies a marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit, që ka kontroll mbi personin tjetër me qëllim të shfrytëzimit.

2) Shprehja "shfrytëzim" ashtu siç është përdorur në pikën 1 të këtij paragrafi, përfshin ndër të tjera shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, shërbimeve ose punës së detyruar, skllavërisë ose veprimeve të ngjashme me skllavërinë, robërisë ose heqjes së organeve.

3) Pëlqimi i viktimës së trafikimit me njerëz për qëllime shfrytëzimi nuk merret parasysh kur cilado prej mjeteve të parashtruara më lart në pikën 1 të këtij paragrafi është përdorur kundër viktimës së tillë.

4) Rekrutimi, transportimi, transferi, strehimi ose pranimi i fëmijës me qëllim të shfrytëzimit konsiderohet "trafikim me njerëz", madje edhe nëse kjo nuk përfshin asnjërin nga mjetet e parashtruara në pikën 1 të këtij paragrafi..

Siç mund të shihet qartë në paragrafin 8, pika 2, heqja e organeve paraqet një formë të shfrytëzimit.

Duke parë se nuk ka dyshime që veshkat e viktimave janë hequr në Klinikën Medikus, atëherë ky kusht për një veprë penale të Trafikimit me Njerëz është plotësuar.

Po ashtu, nuk ka dyshime se viktimat ishin transportuar dhe transferuar nga vendB.mi i tyre deri te Klinika Medikus me dashje konkrete të heqjes së veshkave. Për më tej Klinika Medikus i ka

strehuar viktimat në objektet e saj para, gjatë dhe pas heqjes së veshkave. Edhe ky kusht i veprës penale të Trafikimit me Njerëz është plotësuar.

Çështja kryesore qëndron nëse dhuruesit e veshkave ishin apo jo viktimat qoftë të ndonjë kërcënimi, përdorimi të forcës, detyrimi, rrëmbimit, mashtrimit, falsifikimit, keqpërdorimit të pushtetit apo të pozitës ose të një pozite të ndjeshme ose me anë të dhënies a marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit, që ka kontroll mbi personin tjetër.

Krahas Gjykatës Themelore, Kolegji ka gjetur se viktimat ishin në një pozitë financiare prej nevojtarëve. Të gjitha viktimat të cilat dhanë dëshmitë ë tyre gjatë shqyrtimit gjyqësor ishin qytetar të huaj që vinin nga shtetet relativisht të varfra dhe që personalisht po përjetonin një vuajtje akute të mungesës financiare. Me këtë, viktimat ishin në një pozitë prej nevojtarit. Për më tej viktimave iu kishin thënë se transplantimet e veshkave të tyre konkrete ishin ligjore në Kosovë gjë e cila në fakt nuk qëndronte. Sipas nenit 46, pika (d) e Ligjit të Kosovës për Shëndetësi, nuk lejohen aktivitetet shëndetësore private që lidhen me grumbullimin, ruajtjen, transportin dhe transplantimin e indeve dhe organeve njerëzore. Prandaj, transplantimet e veshkave të tyre ishin joligjore. Kjo përbën lajthitje.

Për më tej, viktimave nuk iu janë ofruar informata valide për rrezikun e intervenimit të tillë kirurgjik dhe ishin shoqëruar deri në kirurgji pa iu dhënë kohë të mjaftueshme që të mendonin edhe njëherë, duke përbërë kështu një lloj të detyrimi. Viktimave në disa raste nuk iu është dhënë e gjithë shuma e të hollave të premtuara apo nuk iu janë dhënë fare të hollat. Prandaj është plotësuar kushti i mashtrimit. Në përfundim të kësaj, janë përdorur shumë mjete me qëllim të shfrytëzimit të viktimave për veshkat e tyre.

Pavarësisht nëse dhuruesit e veshkave e kanë dhënë apo jo pëlqimin e tyre për heqjen e veshkave, kjo është jo-relevante për të konstatuar kryerjen e veprës penale të Trafikimit me Njerëz, sipas nenit 139, paragrafit 8, pika 3 e Kodit të Përkohshëm Penal.

Duke marr parasysh atë që u tha më lart, Kolegji në tërësi e mbështet vlerësimin e Gjykatës Themelore se heqja e veshkave nga viktimat dhe rrethanat e ngjarjeve në Klinikën Medikus paraqesin veprë penale të Trafikimit me Njerëz.

#### *b. Roli i të pandehurve*

##### *b.i. L. D.*

Siç mund të nxirret nga deklaratat e dëshmitarëve, shkëmbimet e postës elektronike dhe deklaratave të të pandehurve, L. D. kishte rregulluar një objekt të sofistikuar mjekësor me gjithë stafin e nevojshëm, pajisje, furnizime dhe procedura me qëllim të kryerjes së transplantimit të veshkave. L. D., për llogari të vet, kishte iniciuar kërkesën për kryerjen e transplantimit të veshkave në Klinikën Medikus. Më pastaj L. D. kishte bashkëpunuar ngushtë me Y. S., me qëllim të funksionimit të Klinikës Medikus si një vend ku do të kryheshin transplantimet e veshkave. Po ashtu L. D. kishte punësuar disa persona tjerë për ekzekutimin e transplantimit të veshkave. Intervenimet konkrete kirurgjike ishin kryer në Klinikën Medikus. L. D. ishte prezent gjatë (disa) transplantimeve të veshkave. Për më tej i pandehuri L. D. nuk e konteston se në



Klinikën Medikus janë kryer transplantime të veshkave dhe se ishte i përfshirë qoftë drejtpërdrejtë apo ishte në dijeni për transplantimet.

Prandaj Kolegji gjen se, përtej dyshimit të arsyeshëm, është provuar se i pandehuri L. D., qëllimisht, me dashje të drejtpërdrejt, është angazhuar në trafikimin me njerëz, siç parasheh neni 139, paragrafi 1 i KPP.

Prandaj ankesa e mbrojtjes se i pandehuri L. D. është i pafajshëm refuzohet si e pabazuar.

*b.ii. A. D.*

Siç mund të nxirret nga deklaratat e dëshmitarëve, shkëmbimet e postës elektronike dhe deklaratave të të pandehurve, A. D. kishte ndihmuar në rregullimin një objekti të sofistikuar mjekësor me gjithë stafin e nevojshëm, pajisje, furnizime dhe procedura me qëllim të kryerjes së transplantimit të veshkave. Intervenimet e caktuara kirurgjike ishin kryer në Klinikën Medikus. A. D. ka bashkëpunuar ngushtë me të atin L. D. për aranzhimet e funksionimit praktik të modus operandi të themeluar për transplantimin me sukses të veshkave. P.sh. aranzhimin e letrave të ftesave të Medikusit për dhuruesit dhe pranuesit e cila do të iu tregohej zyrtarëve të doganës në aeroport apo për marrjen e dhuruesve nga Aeroporti i Prishtinës dhe transportimin e tyre në Klinikën Medikus. A. D. ishte edhe në kontakt të ngushtë me Y. S..

Duke marr parasysh natyrën e akteve të kryera nga ana e të pandehurit A. D., Kolegji gjen se nuk ka asnjë rrugë tjetër përveç se i pandehuri A. D. në tërësi ka qenë në dijeni për transplantimet e veshkave që kryheshin në Klinikën Medikus.

Prandaj Kolegji gjen, përtej dyshimit të arsyeshëm, se është provuar që i pandehuri A. D., qëllimisht, me dashje të drejtpërdrejt, është angazhuar në trafikimin me njerëz, siç parasheh neni 139, paragrafi 1 i KPP.

Prandaj ankesa e mbrojtjes se i pandehuri A. D. është i pafajshëm refuzohet si e pabazuar.

*b.iii. S. H.*

Pika 1, vepra penale e Trafikimit me Njerëz, në shkelje të nenit 139 të KPP, e kryer në bashkë-kryerje (neni 23 i KPPK), kundër S. H. ishte ri-kualifikuar nga ana e Gjykatës Themelore si lehtësim i pakujdesshëm i veprës penale Trafikim me Njerëz në shkelje të nenit 139, paragrafit 4 të KPPK dhe për rrjedhojë është refuzuar. S. H. ishte gjetur fajtor sipas nenit 154, paragrafit 1, pikës 2 të KPP: Paaftësimin ose dobësimin e përhershëm ose të madh të një organi ose pjese të trupit të personit tjetër meqë kjo veprë ishte ri-kualifikuar nga vepra penale Lëndimi i Rënd Trupor në shkelje të nenit 154, paragrafit 4 të KPP.

Në refuzimin e Pikës 1, Gjykata Themelore erdhi në përfundim se i pandehuri S. H. ka kryer veprën penale të trafikimit me njerëz përmes pakujdesisë së pavetëdijshme. Megjithatë Kolegji nuk pajtohet me këtë vlerësim.

Siç mund të nxirret nga deklaratat e dëshmitarëve, shkëmbimet e postës elektronike dhe deklaratave të të pandehurve, i pandehuri S. H. ka marr pjesë në një numër të madh të operacioneve. Me këtë ai ishte dashur të jetë në dijeni se operacionet kanë të bëjnë me transplantimin e veshkave. Po ashtu, ai kishte bashkëveprim substancial dhe direkt me pacientët para intervenimit kirurgjik e me këtë ka pasur njohuri se ata ishin qytetar të huaj. Për më tej S. H. ishte një anesteziolog kryesor në Klinikën Medikus prandaj ai ka pasur një pozitë në të cilat ka pasur apo së paku do të duhej të kishte informata për procedurat e operimit të veshkave. Si provë mbështetëse Kolegji ka marr parasysht edhe atë se emri i të pandehurit ishte përmendur në shkëmbimet e postës elektronike mes S. dhe L. D.

Nga ajo që u tha më lart Kolegji gjen se veprimet e të pandehurit bëjnë atë të jetë rëndë i përfshirë për t'u konsideruar si "pakujdesi e pavetëdijshme". Duke marr parasysht rolin e drejtpërdrejtë të tij në operacione dhe rolin e tij udhëheqës në klinikë, Kolegji është i mendimit – për dallim nga ai i Gjykatës Themelore dhe i mbrojtjes – se ka prova të mjaftueshme se S. H. së paku ka pasur dashje eventuale të angazhohet në Trafikim me Njerëz. Duke marr parasysht seriozitetin e operimeve dhe përfshirjen e drejtpërdrejtë të tij në to, i pandehuri nuk mund të fshehët prapa linjës së tij mbrojtëse të ketë qenë aq shumë i zënë sa që nuk i ka kushtuar aq shumë vëmendje pacientëve ndërkombëtar dhe se asnjëherë nuk e ka pyetur L. D.n për sqarime. Kolegji gjen se ky sqarim nuk është i besueshëm. Prandaj Kolegji gjen se ekzistojnë prova të mjaftueshme për të provuar, përtej dyshimit të arsyeshëm, se i pandehuri S. H. ka kryer veprën penale të Trafikimit me Njerëz.

Prandaj ankesa e mbrojtjes se i pandehuri S. H. është i pafajshëm refuzohet si e pabazuar.

Në anën tjetër, ankesa e prokurorit është aprovuar. Sipas nenit 426, paragrafit 1 të KPPPK, paneli e ndryshon aktgjykimin e Gjykatës Themelore ashtu që i pandehuri S. H. gjendet fajtor për veprën penale të Trafikimit me Njerëz. Edhe dispozitivi duhet të ndryshohet respektivisht.

## I. Krimi i organizuar

### *a. L. D.*

Krahas Gjykatës Themelore, Kolegji gjen se ekzistojnë prova të mjaftueshme për të provuar se transplantimet e veshkave janë kryer nga ana e një grupi kriminal të organizuar. Ka ekzistuar një grup kriminal ndërkombëtar i organizuar mirë i cili ka përfituar shumë. Ndërmarrja ka qenë mirë e organizuar; ka qenë i përbërë nga shumë persona duke përfshirë L. D., A. D. dhe të tjerët; dhe se ai grup kishte në vete shumë funksione të ndërlidhura si rekrutimin, logjistikën, pagesat,

transportin, disponueshmërinë e objektit të përshtatshëm mjekësor (Klinika Medikus), disponueshmërinë e mjekëve të trajnuar dhe procedurat mjekësore të specializuara (transplantimin e veshkave). Edhe pse pjesëmarrësit jo domosdoshmërisht e kanë njohur njëri tjetrin, që të gjithë ishin pjesë e një grupi të strukturuar që ka rezultuar në një angazhim kriminal unik, respektivisht në trafikim me njerëz.

I pandehuri L. D., për llogari të vet, ka iniciuar kërkesën për kryerjen e transplantimeve të veshkave në Klinikën Medikus dhe se si duket ka qenë përgjegjës për organizimin e përgjithshëm, themelimin, mbikëqyrjen, menaxhimin dhe drejtimin e transplantimeve të veshkave të kryer në Klinikën Medikus. Me këtë, ai ka pasur rol substancial dhe vendimtar në organizimin e grupit kriminal.

Prandaj Kolegji gjen të jetë provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri L. D. ka themeluar dhe organizuar aktivitetet e një grupi kriminal të organizuar sipas nenit 274, paragrafit 3 të KPP.

Prandaj ankesa e mbrojtjes se i pandehuri L. D. është i pafajshëm refuzohet si e pabazuar.

*b. A. D.*

Krahas Gjykatës Themelore edhe Kolegji gjen se është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri A. D. ka kryer një krim të rëndë, respektivisht Trafikim me Njerëz si pjesë e grupit kriminal të organizuar e të specifikuar më lart sipas nenit 274, paragrafit 1 të KPP. A. D. ka qenë drejtor/menaxher i Klinikës Medikus dhe ngushtë ka bashkëpunuar me të atin e tij, L. D., për të aranzhuar funksionimin praktik të modus operandi të themeluar për kryerjen me sukses të transplantimit të veshkave në Klinikën Medikus. Me këtë, ai ka pasur rol substancial dhe vendimtar në grupin e organizuar kriminal.

Prandaj ankesa e mbrojtjes se i pandehuri A. D. është i pafajshëm refuzohet si e pabazuar.

*c. S. H.*

Për dallim nga Gjykata Themelore, Kolegji gjen të jetë provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri S. H. ka kryer një krim të rëndë, respektivisht Trafikim me Njerëz si pjesë e grupit kriminal të organizuar e të specifikuar më lart sipas nenit 274, paragrafit 1 të KPP.

S. H. ka marr pjesë në një numër të madh të operacioneve. Me këtë ai ishte dashur të jetë në dijeni se operacionet kanë të bëjnë me transplantimin e veshkave. Për më tej S. H. ishte një anesteziolog kryesor në Klinikën Medikus prandaj ai ka pasur një pozitë në të cilat ka pasur apo së paku do të duhej të kishte informata për procedurat e operimit të veshkave. Me këtë, ai ka pasur rol substancial dhe vendimtar në grupin e organizuar kriminal.

Si provë mbështetëse Kolegji ka marr parasysh edhe atë se emri i të pandehurit ishte përmendur në shkëmbimet e postës elektronike mes S. dhe L. D.

Prandaj ankesa e mbrojtjes se i pandehuri S. H. është i pafajshëm refuzohet si e pabazuar.

#### *d. Bashkëkryerësit*

Sa i përket të dyve, L. D. dhe A. D., Kolegji megjithatë e ndryshon dispozitivin ashtu që emrat e bashkëkryerësve tjerë të përfshirë në grupin kriminal të organizuar nuk duhet të përfshihen gjë e cila do të sqarohet më poshtë më në detaje (L.b.). Kjo megjithatë nuk e prek dispozitivin dhe vendimin për fajësinë si tërësi dhe se arsyetimi i dhënë më lart edhe më tej vlen.

### J. Akti i njëjtë kriminal

#### *a. Trafikimi me Njerëz dhe Krimi i Organizuar*

Kolegji i Gjykatës së Apelit ka gjetur se Gjykata Themelore me shumë të drejt i ka gjetur fajtor të pandehurit L. D. dhe A. D. për Trafikim me Njerëz dhe Krim të Organizuar dhe me të drejtë iu ka shqiptuar dënimin për të dy veprat penale.

Megjithatë duhet të sqarohet se të pandehurit kanë kryer një vepër penale në vend të dy veprave penale veç e veç. Respektivisht do të ndryshohet edhe dispozitivi.

Gjykata Themelore e ka gjetur fajtor të pandehurin L. D. për veprën penale të Trafikimit me Njerëz, në shkelje të nenit 139, paragrafit 1 të KPPK, në bashkëkryerje sipas nenit 23 të KPPK (Pika 1) si dhe i pandehuri është gjetur fajtor për veprën penale Krim i Organizuar, në shkelje të nenit 274, paragrafit 3 të KPPK (Pika 2). Ai është dënuar me burgim prej 8 (tetë) vite dhe me gjobë prej 10,000 (dhjetë mijë) euro.

A. D. është gjetur fajtor për kryerjen e veprës penale Trafikim me Njerëz, në shkelje të nenit 139, paragrafit 1 të KPPK, në bashkëkryerje sipas nenit 23 të KPPK (Pika 1) si dhe i pandehuri është gjetur fajtor për veprën penale Krim i Organizuar, në shkelje të nenit 274, paragrafit 3 të KPPK (Pika 3). Ai është dënuar me burgim prej 7 (shtatë) vite e 3 (tre) muaj dhe me gjobë prej 2.500 (dymijë e pesëqind) euro.

Gjykata e Apelit thekson se në këtë rast, të dy të pandehurit nuk mund të dënohen për dy vepra penale të ndara të Trafikimit me Njerëz dhe për Krim të Organizuar. Kolegji i referohet vendimeve të mëhershme të nxjerra nga Gjykata Supreme/Gjykata e Apelit përmes të cilëve është konfirmuar se “Krimi i Organizuar” paraqet një akt të kualifikuar prandaj në asnjë rast nuk mund të merret si një vepër penale e ndarë. Gjykatat vazhdimisht e kanë theksuar se i pandehuri nuk mundet që për të njëjtën akt kriminal të dënohet për të dyja veprat: (i) për Krim të organizuar, dhe (ii) për krimin e rëndë bazë që kërkohet si element i veprës penale që në këtë rast është Trafikimi me Njerëz. Nëse do të merrej një qasje tjetër, atëherë i pandehuri do të dënohej dy herë për të njëjtin akt. Gjykata Supreme e Kosovës, në aktgjykimet e mëhershme ka theksuar se vepra Krim i Organizuar kërkon kryerjen e një vepre “bazë” përtej veprës së Krimin të Organizuar. Formulimi i përdorur në gjithë nenin 274 të KPPK qartë e parasheh se kryerja e një vepre bazë paraqet elementin përbërës të kësaj vepre. Përndryshe, një individ i caktuar do të mund të gjendej fajtor për të njëjtën vepër duke formuar pjesë të të dy veprave penale, atë të

Krimit të Organizuar dhe të veprës së kryer bazë. Kjo situatë qon në shkelje të ndalimit për shqiptimin e dënimit të dyfishtë për një vepër të vetme<sup>4</sup>.

Gjykata e Apelit e mbështet interpretimin e lartpërmendur të bërë nga ana e Gjykatës Supreme dhe gjen se ai e bën të domosdoshme ndryshimin e aktgjykimit të kontestuar. Në këtë rast, vepra penale e krimit të organizuar e nënkupton veprën penale të Trafikimit me Njerëz si një vepër penale “bazë” e tij. Për rrjedhojë, të pandehurit L. D., A. D. dhe S. H. janë gjetur fajtor për një vepër penale, respektivisht për Krim të Organizuar në lidhje me Trafikimin me Njerëz. Dispozitivi duhet të ndryshohet respektivisht me këtë.

*b. Trafikimi me Njerëz dhe Lëndim i rëndë trupor*

Në harmoni me parimin e lartpërmendur se i pandehuri nuk mund të dënohet dy herë për të njëjtin akt kriminal, Kolegji me tej miraton dhe vërteton arsyetimin e Gjykatës Themelore se Pika 7 e aktakuzës kundër të pandehurit L. D. duhet të refuzohet, sipas nenit 389, paragrafit 4, për shkak të rrethanave se kjo Pikë përbën një element të Pikës 1, Trafikim me Njerëz për të cilën i pandehuri L. D. tanimë është dënuar.

Prandaj kërkesa e prokurorisë për këtë çështje refuzohet si e pabazuar.

K. I. B. dhe S. D.

Të pandehurit I. B. dhe S. D. janë gjetur fajtor nga neni 154, paragrafi 1, pika 2 e KPPK: Paaftësimin ose dobësimin e përhershëm ose të madh të një organi ose pjese të trupit të personit tjetër, meqë kjo vepër është ri-kualifikuar nga vepra penale Lëndim i Rëndë Trupor, në shkelje të nenit 154, paragrafit 4 të KPPK.

Kolegji gjen se me të vërtetë ekziston një dyshim se të pandehurit I. B. dhe S. D. ishin në dijeni për faktin se në Klinikën Medikus kryheshin në mënyrë joligjore transplantimet e veshkave dhe në fakt ata e kryenin profesionin e tyre mjekësor prej anesteziologu për dhurues dhe pranues të ndryshëm të këtyre transplantimeve të veshkave. Megjithatë, Kolegji gjen se me mospranueshmërinë e disa provave të caktuara të konfiskuara në Klinikën Medikus, ekzistojnë prova të pamjaftueshme për të provuar, përtej një dyshimi të arsyeshëm, se të pandehurit I. B. dhe S. D. ishin aq drejtpërdrejtë të përfshirë në procedura pranë Klinikës Medikus dhe në operacionet e caktuara të veshkave për të qenë në dijeni se në mënyrë të përhershme dhe substanciale po dobësonin një organ të një personi tjetër përveç pjesës se kryenin profesionin e tyre mjekësor lidhur me pacientët e rastit.

Aprovohen ankesat në emër të të pandehurve I. B. dhe S. D..

---

<sup>4</sup> Shih Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës në lëndën nr. Ap-Kz 61/2012 të datës 2 tetor 2012, para 48; shih po ashtu Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, lënda nr. PAKR 215/2014, data 14 maj 2015

Prandaj, trupi gjykues i liron të pandehurit I. B., I. B. dhe S. D. nga Pika 7, neni 154, paragrafi 1, nën-paragrafi 2, KPPK-së: Dëmtimin apo dobësimin e përkohshëm ose të konsiderueshëm të një organi vital ose një pjesë vitale të trupit të personit tjetër, pasi kjo vepër është ri-kualifikuar nga vepra penale e Lëndimit të Rëndë Trupor, në kundërshtim me nenin 154, paragrafi 4, i KPPK-së. Rrjedhimisht, trupi gjykues e modifikon aktgjykimin e Gjykatës Themelore, siç specifikohet në dispozitiv.

#### L. Dispozitivi

##### *a. Tejkalmimi i aktakuzës*

Mbrojtja pohon se diapazoni i aktakuzës është tejkaluar pasi që dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar u ka atribuar të pandehurve veprimet me të cilat ata nuk janë akuzuar, duke shkelur kështu nenin 403, paragrafi 10, i KPPPK-së lidhur me nenin 386, paragrafi 1, KPPPK-së.

Trupi gjykues konstaton se nuk ka shkelje në lidhje me tejkalmimin e aktakuzës në dispozitiv. Trupi gjykues konstaton se – në lidhje me pjesët e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore që trupi gjykues konfirmon se- faktet e provuara përputhen me akuzat siç përcaktohet në aktakuzë. Prandaj, trupi gjykues gjen se dispozitivi është në pajtim me nenin 86, paragrafi 1, i KPPPK-së, pasi që dispozitivi ka të bëjë “vetëm me të akuzuarit dhe vetëm me një vepër që është objekt i akuzës që përmbante aktakuza siç është ngritur në fillim apo siç është modifikuar apo zgjeruar gjatë shqyrtimit gjyqësor”.

##### *b. Identifikimi i bashkëkryerësve*

Bashkëkryerësit, përveç të pandehurve, nuk janë të akuzuar në këtë lëndë specifike, dhe kështu ata nuk e kanë mundësinë që ta mbrojnë vetveten. Për më tepër, procedura tjera penale janë iniciuar apo mund të iniciohen kundër këtyre bashkëkryerësve. Kështu, trupi gjykues, *ex officio* e modifikon këtë dispozitiv për sa i përket emrave të të gjithë bashkëkryerësve, të cilët nuk janë të pandehur, të cilët i heq dhe të cilët janë të përcaktuar dhe të referuar vetëm si bashkë-konspiratorët.

#### M. Vendimi për sanksionin penal

Për sa i përket dënimit, prokurori thekson si më poshtë: Dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit L. D. është me sa duket një dënim unik për dy vepra edhe pse kjo nuk thuhet në aktgjykim. Dënimi është i shkallës më të ultë, duke pasur parasysh dënimet minimale të zbatueshme për krim të organizuar dhe trafikim. Për më tepër, L. D. duhet të ishte dënuar për Lëndim të Rëndë Trupor, si dhe kjo vepër penale duhet të përfshihet në dënim. Gjykata Themelore nuk e ka shqiptuar dënimin për secilin vepër dhe pastaj ta shqiptojë dënimin unik për të gjitha veprat. Kjo duhet të modifikohet. Dënimi plotësues i ndalimit të L. D. nga ushtrimi i profesionit të urologut duhet të

modifikohet për të përfshirë ushtrimin e të gjitha praktikave nga ai dhe duhet të rritet në maksimumin prej 5 (viteve) duke filluar pas lirimit të tij nga burgu.

Për sa i përket të pandehurit A. D., prokuroria vlerëson se Gjykata Themelore nuk arriti që së pari ta shpallë dënimin për secilën vepër dhe pastaj t'ia shqiptojë dënimin unik për të gjitha veprat. Kjo duhet të modifikohet.

Sa i përket S. H. dënimi i shqiptuar është shumë i ultë. Për më tepër, dënimi plotësues i ndalimit të ushtrimit të profesionit të tij duhet të modifikohet për të përfshirë ushtrimin e të gjitha praktikave nga ai dhe duhet të rritet në maksimumin prej 5 (viteve) duke filluar pas lirimit të tij nga burgu.

Mbrojtja konsideron se dënimet janë shumë të rënda.

Gjykata e Apelit mendon se në bazë të nenit 34 dhe neneve 64 deri 71 të KPPPK-së, parimet e zbatueshme për llogaritjen e dënimin janë si në vijim:

Sanksioni penal është mjete i fundit për mbrojtjen e vlerave shoqërore dhe ky nuk mund të ndërhyjë përtej asaj që konstatohet si patjetër e domosdoshme. Sanksioni nuk guxon të jetë më i lartë sesa domosdoshmëria e zbatimit të drejtësisë dhe nuk mund të jetë joproporcional duke konsideruar vlerat shoqërore të mbrojtura. Për këtë arsye, në bazë të parimit të intervenimit minimal të sanksionit penal, duhet patjetër të supozohet se dënimi më i ulët i parashikuar me ligj do të jetë i mjaftueshëm, adekuat dhe normal për situatat standarde të cilat mund të përfshihen në dispozitën inkriminuese ligjore.

Qëllimet e dënimin janë që të sigurojë parandalimin dhe rehabilitimin e individit, të sigurojë parandalimin e përgjithshëm, të shprehë mosmiratimin shoqëror ndaj shkeljes së vlerave të mbrojtura shoqërore si dhe forcimin e ndjenjës së respektit shoqëror për ligjin.

Gjatë caktimit të dënimin, dënimi maksimal konkret do të jepet në bazë të shkallës së fajit të kryerësit ndërsa minimal në bazë të intensitetit të kërkesave për t'u qortuar nga shoqëria. Në kuadër të këtij kufiri të ri, sanksioni nuk guxon të jetë në kundërshtim me parimet e referuara të parandalimit dhe të rehabilitimit dhe duhet t'i marrë parasysh në mënyrë proporcionale të gjitha rrethanat specifike lehtësuese dhe rënduese të cilat kanë të bëjnë me faktin penal si dhe sjelljen dhe rrethanat personale dhe shoqërore të kryerësit.

Në pajtim me nenin 64 (1) të KPPPK-së, Gjykata gjatë marrjes së aktgjykimit duhet të ketë parasysh qëllimin e dënimin, të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zbutjen apo rëndimin e dënimin (rrethanat lehtësuese dhe rënduese) dhe sidomos shkallën e përgjegjësisë penale, motivet nga të cilat është kryer vepra, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, rrethanat në të cilat është kryer vepra, sjelljen e mëparshme të kryerësit, pranimin e fajit, rrethanat e tij personale të kryerësit dhe sjelljet e tij pas kryerjes së veprës penale. Dënimi duhet të jetë në proporcion me veprën si dhe me sjelljen dhe rrethanat e kryerësit.

Në përgjithësi, Gjykata e Apelit, në shqyrtimin e dënimeve, është e kufizuar nga gjendja faktike e vërtetuar në aktgjykim dhe nga vlerësimi i rregullave ligjore të zbatueshme për përcaktimin e

dënimit nga Gjykata Themelore. Trupi gjykues nuk është i lidhur me peshën specifike të përcaktuar nga Gjykata Themelore për secilën rrethanë lehtësuese dhe rënduese. Faktet tjera të supozuara në favor ose në dëm të të pandehurve, por jo të vendosura nga Gjykata Themelore, nuk mund të konsiderohen për përcaktimin e dënimit.

L. D. është shpallur fajtor se vepra penal Trafikimi me Njerëz në kundërshtim me nenin 139 paragrafi 1 i KPPK-së, e kryer në bashkëkryerje në pajtim me nenin 23 të KPPK-së (Akuza 1) dhe është shpallur fajtor për kryerjen e veprave penale të Krimit të Organizuar, në kundërshtim me nenin 274, paragrafi 3 i KPPK-së (Pika 2). Ai është dënuar me 8 (tetë) vjet burgim dhe me gjobë prej 10,000 (dhjetë mijë) Euro për të dy veprat penale në ndërlidhje. Ndalimi nga ushtrimi i profesionit të urologut për periudhën prej 2 (dy) viteve pasi vendim të jetë i formës së prerë, i është shqiptuar si dënim plotësues.

A. D. është shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale të Trafikimit me Njerëz në kundërshtim me nenin 139 të KPPK-së, e kryer në bashkëkryerje në pajtim me nenin 23 të KPPK-së (Akuza 1) dhe është shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale të Krimi i Organizuar, në kundërshtim me nenin 274, paragrafi 1 (Akuza 3). Ai është dënuar me 7 (shtatë) vite dhe 3 (tre) muaj burgim dhe me gjobë prej 2,500 (dy mijë e pesëqind) Euro për të dy veprat penale të ndërlidhura.

S. H. është shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale të Lëndimit të Rëndë Trupor në kundërshtim me nenin 154, paragrafi 1, nën-paragrafi 2 i KPPK-së (Pika 7) dhe është dënuar me 3 (tre) vjet burgim. Ndalimi i ushtrimit të profesionit të anesteziologut për periudhën prej 1 (një) vit pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit është shqiptuar si dënim plotësues.

Lidhur me të pandehurin L. D., Gjykata e Apelit konstaton se Gjykata Themelore ka konsideruar në mënyrë të rregullt të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Trupi gjykues konsideron si rrethanë lehtësuese sjelljen e tij të mëparshme në krye të familjes së tij dhe statusin e tij me respekt në shoqëri duke ofruar shërbime të nevojshme mjekësore për qytetarët e Kosovës, si dhe statusin e tij pa të dhëna penale. Si rrethanë rënduese gjykata mori në konsideratë motivet e tij egoiste, përkatësisht gjenerimin e të ardhurave të paligjshme. Ai e ka shfrytëzuar pozitën e tij si shumë i nderuar dhe i respektuar si burim i qarkullimit të të ardhurave në mënyrë të paligjshme. Veprimet e tij të papranueshme e sollën Kosovën në vëmendje të komunitetit ndërkombëtar, si vendi ku kryheshin transplantimet e veshkave, duke e krijuar një perceptim të gjerë për Kosovën si vendi ku ligji nuk përfilllet. Personat e cenueshëm janë lënduar dhe jetët e tyre i janë ekspozuar një situatë potencialisht kërcënuese për jetën, duke i lënë ata me rrezik real se gjendja jetësore mundet papritur të përkeqësohet dhe mund të përfundojnë si pacientë në reparte të urologjisë duke pritur për dializë apo transplantim. Një faktor shtesë rëndues ishte metoda profesionale e krijimit të klinikës deri në shkallë ndërkombëtare. Në përgjithësi, i pandehuri luajti një rol aktiv në një grup të organizuar ndërkombëtarësh dhe ishte – së paku për territorin e Kosovës – figura kyçe që trafikoi qenie njerëzore të varfra nga shtëpitë e tyre për në sallën e tij të operimit në një klinikë mjekësore në Prishtinë, në të cilin ai ishte bashkëpronar. Pa pjesëmarrjen e L. D. asnjë nga këto ngjarje nuk do të kishte ndodhur. Ai është personi që e ka punësuar Y. S. që të vijë në Kosovë. Ai është njeriu i cili ka kërkuar dhe pastaj ka paguar për S. H. që të veprojë si



anesteziolog për operacionet e transplantimit të veshkave në Klinikës Medicus dhe ai është njeriu i cili mbart shkallën më të lartë të përgjegjësisë për këto ngjarje. Gjykata e Apelit pajtohet plotësisht me llogaritjen e dënimit që kishte bërë Gjykata Themelore dhe vërejtjet se të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese janë marrë në konsideratë siç duhet.

Siç u konkludua më lartë, të pandehurit L. D. dhe A. D. janë shpallur fajtorë për veprën penale të Krimin të Organizuar e ndërlidhur me Trafikimin e Njerëzve. Gjykata Themelore në aktgjykimin e kundërshtuar tashmë e ka shpallur një dënim për të dy veprat penale. Prandaj, trupi gjykues konsideron se nuk ka nevojë të modifikohet dënimi në këtë drejtim.

Gjykata e Apelit e vërteton dënimin për të akuzuarin L. D. dhe gjen dënimin unik prej tetë (8) viteve si të drejtë dhe proporcional të bazuar siç është shtjelluar më lartë.

Në lidhje me të pandehurin A. D., Kolegji i Apelit kryesisht ndjek argumentimin e prokurorisë dhe e konsideron dënimin prej 7 (shtatë) viteve dhe 3 (tre) muajve shumë të butë. Gjykata Themelore konsideron si rrethanë rënduese se i pandehuri ka vepruar i shtyrë nga dëshira për të përfituar dobi të konsiderueshme pasurore, në kurriz të njerëzve të pafajshëm dhe të pambrojtur. Ai e kishte pozitën e administratorit kryesor të organizatës kriminale ilegale në Kosovë, duke qenë përgjegjës për të gjitha aranzhimet administrative dhe faktike, dhe pa të kjo ndërmarrje kriminale nuk do të kishte sukses. Trupi gjykues tutje mendon se A. D. luajti një rol po aq të rëndësishëm në grup sikurse i pandehuri L. D.. Së bashku me babanë e tij ai ishte një ndër figurat kyçe për organizimin e transplantimeve të veshkave në Kosovë. Prandaj, Gjykata e Apelit e konsideron dënimin prej 8 (tetë) viteve, të drejtë dhe proporcional me peshën e veprës, me sjelljet dhe rrethanat e të pandehurit. Lidhur me gjobën prej 2,500 (dy mijë e pesëqind) Euro, trupi gjykues e konfirmon aktgjykimin e kundërshtuar pasi ky vendim nuk është ankimuar nga prokuroria.

Në lidhje me të pandehurin S. H., Gjykata e Apelit tani e shpall të pandehurin fajtor për Trafikim me Njerëz në kundërshtim me nenin 139 të KPPK-së, e kryer në bashkëkryerje në pajtim me nenin 23 të KPPK-së. Trupi gjykues konsideron se një dënim prej 5 (pesë) viteve dhe një gjobë prej 2,500 (dy mijë e pesëqind) Euro është i përshtatshëm dhe thekson se ky dënim pasqyron nivelin e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe merr parasysh numrin e veprave që kanë shkaktuar rritje të dënimit dhe mënyrës në të cilën është kryer vepra penale. Si rrethanë lehtësuese, gjykata mori parasysh se nuk ka qenë i dënuar më parë. Si rrethanë rënduese, trupi gjykues konsideron se ky i pandehur kishte një pozitë të rëndësishme si anesteziolog i lartë që punonte në klinikë. Ai ka marrë pjesë shumë aktive në shumicën e operacioneve. Megjithatë, i pandehuri nuk e meriton të njëjtin dënim si të pandehurit L. D. dhe A. D.. Ai ishte më pak figurë kyçe për grupin kriminal por më shumë një “instrument njerëzor” i rëndësishëm i cili ia ka dhënë “duart” e tij L. D. dhe A. D.. Duke marrë parasysh veprat penale dhe rrethanat e shtjelluara më lartë, Gjykata e Apelit, pas një shqyrtimi të kujdesshëm, konstaton se burgimi prej 5 (pesë) viteve dhe një gjobë prej 2,500 (dy mijë e pesëqind) Euro, është i duhur dhe i nevojshëm për t’i shërbyer të gjitha qëllimeve të dënimit.

Në pajtim me nenet 57, paragrafi 1 dhe 2 i KPPK-së, Gjykata Themelore shqiptoi dënimet plotësuese, përkatësisht ndalimin e ushtrimit të profesionit si urolog dhe anesteziolog, për L. D.

dhe S. H., duke filluar nga dita kur aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm. Sipas gjykatës, veprat penale të kryera nga këta dy mjekë paraqesin një rrezik të madh të sigurisë publike pasi ata ekspozuan pacientët në veçanti dhuruesit para një rreziku të paprecedent. Këta mjekë ishin persona me besim të publikut, dhe si të tillë ata kanë paraqitur një nivel të lartë të integritetit moral. Ajo sjellje duhet të dënohet ashpër me këtë dënim plotësues. Andaj, trupi gjykues e modifikon aktgjykimin e kundërshtuar ashtu që ndalimi i ushtrimit të profesionit do të fillojë **pasi që** të pandehurit e kanë mbajtur dënimin e shqiptuar me burgim. Kjo do të thotë se, ndalimi i praktikës nuk do të fillojë një të njëjtën kohë me burgimin, d.m.th., kur aktgjykimi bëhet i formës së prerë, por kur të pandehurit do të lirohen nga burgu. Rrjedhimisht modifikohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në lidhje me këtë. Megjithatë, trupi gjykues konsideron se nuk ka baza për zgjerimin e dënimit plotësues përtej profesionit të caktuar të të pandehurve. Andaj, propozimi i prokurorit për të zgjeruar dënimin plotësues në të gjitha fushat e profesionit mjekësor është refuzuar.

Duke parë se trupi gjykues arrin në kualifikime të ndryshme për veprat penale të kryera në krahasim me Gjykatën Themelore, dënimet gjithashtu janë shqiptuar në bazë të kualifikimeve të reja. Kështu që, çfarëdo lëshimi i Gjykatës Themelore që së pari të shpallë dënimin për secilën vepër dhe pastaj të shqiptojë dënimin unik për të gjitha veprat, në pajtim me nenin 396, paragrafi 5, rrjedhimisht është ndryshuar me dënimet e reja të shqiptuara në këtë aktgjykimi.

#### N. Kompensimi i pjeshëm

Në lidhje me konstatimin e prokurorisë se shumica e urdhëruar për dëmet psikologjike dhe fizike gjatë transplantimeve të veshkave që kanë pësuar viktimat është shumë e ultë, trupi gjykues konstaton se shumica prej 15.000 Euro e përcaktuar nga Gjykata Themelore është adekuate. Trupi gjykues merr parasysh me këtë, se palët e dëmtuara gjithashtu e kanë shkëlur ligjin në Kosovë. Kjo është që ata nuk duhet të përfitojnë nga veprimet e tyre ilegale dhe nuk duhet të ju jepet një kompensim më i lartë.

## **VI. KONFISKIMI**

### A. PARASHTRESAT E PALËVE

#### *a. Ankesa e PSRK-së*

PRK-ja konsideron se edhe pse prokuroria pajtohet me vendimin e lëshuar nga Gjykata Themelore dhe argumentet ligjore të tij, aktvendimi përmban një lëshim serioz dhe të pafalshëm pro forma, përkatësisht një dispozitiv jo gjithëpërfshirës. Është pranuar se mungesa e dispozitivit gjithëpërfshirës ka gjasë të jetë rezultat i gabimit njerëzor. Megjithatë, gabimi i tillë duhet të korrigjohet për arsye të qartësisë dhe të ligjshmërisë.

PSRK-ja kërkon nga Gjykata e Apelit ta modifikojë aktvendimin lidhur me dispozitivin, duke thënë se gjykata vendos ta mbyll dhe konfiskojë Klinikën Medicus.

*b. Ankesa e F. I. në emër të subjektit ekonomik Qendra Mjekësore Sh.p.k.*

F. I., tani pronar i Qendrës Mjekësore Sh.p.k., thekson se është e paqartë nga dispozitivi se çfarë është vendimi.

Përveç kësaj, si pronar i pronës, F. I. është dëmtuar drejtpërdrejt nga gjykata. Ai e bleu pronën në mënyrë të ligjshme dhe Qendra Mjekësore është e regjistruar si duhet. Nuk ka asnjë aktivitet të paligjshëm në zhvillim e sipër në Qendrën Mjekësore. Prandaj, nuk ka asnjë bazë për konfiskimin dhe mbylljen e pronës.

*c. Ankesa e Linn Slattengren në emër të L. D. dhe të kompanive Klinika Kardiokirurgjike Medikus dhe Ordinanca Urologjike Medicus*

Është konsideruar se aktvendimi nuk ka dispozitiv, të paktën është jo-gjithëpërfshirës. Në vazhdim, nuk ka asnjë bazë për konfiskim. Referenca e nenit 489 të KPPK-së është pa merita. Për më tepër, nuk ka asnjë justifikim substancial për konfiskim. Në përgjithësi, aktvendimi proceduralisht është me të meta, faktikisht i pabazuar, dhe sipas ligjit që nuk ekziston, si dhe përbën një përpjekje të paligjshme për konfiskimin e pronës private në kundërshtim me nenin 1 protokollin 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kërkohej që aktvendimi të modifikohet në mënyrë që të refuzohet propozimi i prokurorisë për konfiskim.

*d. Propozimi i Prokurorisë së Apelit*

Prokurori i Prokurorisë së Apelit pajtohet me aktvendimin e kundërshtuar se janë plotësuar kushtet ligjore për mbylljen dhe konfiskimin e lokaleve të Klinikës Medicus të atëhershme. Prokurori vëren se aktvendimi i kundërshtuar duhet të ndryshohet në lidhje me dispozitivin.

## **B. KONSTATIMET E TRUPIT GJYKUES**

Trupi gjykues pajtohet me parashtrësat e palëve se dispozitivi i aktvendimit të Gjykatës Themelore është jo-gjithëpërfshirës. Dispozitivi thjesht e përcakton objektin e çështjes së konfiskimit pa lëshuar një vendim nëse duhet apo jo që të mbyllet dhe të konfiskohet objekti. Megjithatë, është mjaft e qartë nga arsyetimi i aktvendimi se lokalet e Klinikës Medicus duhet të mbyllet dhe konfiskohen, përkatësisht paragrafi 17 i aktvendimit të kundërshtuar. Prandaj, trupi gjykues do të vlerësojë nëse aktvendimi i Gjykatës Themelore për të mbyllur dhe konfiskuar lokalet e Klinikës Medicus në pajtim me ligjin.

Gjykata Themelore e ka bazuar aktvendimin e saj në nenin 6 të UNMIK/REG/2001/4, i cili përcakton:

Konfiskimi i Pronës dhe Mbyllja e Lokaleve

6.1 Pasuria e përdorur ose që del nga kryerja e trafikimit me njerëz apo me vepra të tjera penale sipas kësaj rregulloreje mund të konfiskohet në përputhje me ligjin në fuqi. Pasuria personale e viktimave të trafikimit nuk konfiskohet kudo që menjëherë identifikohet si e tillë nga ana e zyrtarit për zbatimin e ligjit.

6.2 Kur ka arsye për të dyshuar se ndonjë ndërmarrje, që vepron në mënyrë ligjore a joligjore është e përfshirë ose është e implikuar me vetëdije në trafikimin e njerëzve apo në vepra të tjera penale, gjyqtari hetues në mbështetje të kësaj rregullore mundet, me rekomandimin e prokurorit publik, të lëshojë urdhër për mbylljen e asaj ndërmarrjeje.

6.3 Me urdhëresë administrative do të krijohet një fond dëmshpërblimi për viktimat e trafikimit dhe konform nenit 6.1. do të bëhen autorizime për pranimin e mjeteve financiare inter alia edhe nga konfiskimi i pasurisë..

Lidhur me nenin 489 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penal të Kosovës, i cili thotë:

(1) Sendet, që sipas Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës duhet të konfiskohen, konfiskohen edhe kur procedura penale nuk përfundon me aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor kur ekziston rrezik se mund të përdoren për vepër penale ose kur kjo është në interes të sigurisë publike apo për arsye morale.

(2) Organi kompetent i cili e zbaton procedurën merr aktvendim të veçantë për këtë në kohën kur procedura përfundon ose pushon.

(3) Aktvendimin për konfiskim të sendeve nga paragrafi 1 i këtij neni e merr gjykata edhe kur në aktgjykim me të cilin i akuzuari është shpallur fajtor nuk ekziston një vendim i tillë. (4) Kopja e vërtetuar e vendimit për konfiskim të sendeve i dërgohet pronarit kur dihet identiteti i tij.

(5) Kundër vendimit nga paragrafi 2 dhe 3 i këtij neni pronari i sendeve ka të drejtë ankese kur ai mendon se nuk ka bazë ligjore për konfiskim. Kur aktvendimin nga paragrafi 2 i këtij neni nuk e ka marrë gjykata, ankesa shqyrtohet nga kolegji prej tre gjyqtarësh i gjykatës e cila do të ishte kompetent për gjykim në shkallë të parë..

Kështu, kodi i zbatueshëm në këtë lëndë është Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më 6 prill 2004. Më në veçanti, neni 60 i KPPK-së:

Neni 60

(1) Sendet të cilat janë përdorur apo janë dedikuar për kryerjen e veprës penale apo sendet të cilat janë rezultat i kryerjes së veprës penale mund të merren nëse janë pronë e kryerësit.

(2) Sendet nga paragrafi 1 i këtij neni mund të merren edhe kur nuk janë pronë e kryerësit nëse kjo është në dobi të sigurisë së përgjithshme, por nëse marrja e tillë nuk ndikon dëmshëm mbi të drejtat e personave të tretë për të marrë kompensimin e dëmit nga kryerësi.

(3) Me ligj mund të përcaktohet marrja e obligueshme e sendit.

Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës e zëvendëson UNMIK/REG/2001/4 lidhur me nenin 354 të KPPK-së:

Neni 354

(1) Dispozitat në Rregulloret e UNMIK-ut dhe Udhëzimet Administrative që mbulojnë çështjet e trajtuara në këtë Kod pushojnë të jenë në fuqi pas hyrjes në fuqi të këtij Kodi pos nëse shprehimisht nuk është paraparë ndryshe me këtë Kod ose në Rregulloret të UNMIK-ut.

(2) Dispozitat e Kodeve Penale në fuqi pushojnë të kenë fuqi pas hyrjes në fuqi të këtij Kodi..

Prandaj nëse Klinika Medicus duhet të mbyllet dhe konfiskohet duhet të vlerësohet në bazë të nenit 60 të KPPK-së në lidhje me nenin 489 të KPPK-së.

Me faktet siç janë paraqitur tani, trupi gjykues nuk gjen asnjë bazë për të vënë në dyshim bartjen e lokaleve të Klinikës Medicus nga L. D. te kompani Graniti Com, e përfaqësuar nga F. I. Të gjitha dokumentet ligjore janë dhënë dhe trupi gjykues konstaton se F. I. tani është pronar i lokaleve të Klinikës Medicus.

Prandaj paragrafi 1 i nenit 60 të KPPK-së nuk zbatohet, pasi që Klinika Medicus nuk është më pronë e L. D., kryerësit.

Në lidhje me paragrafin 2 të nenit 60 të KPPK-së, përkatësisht nëse është e nevojshme apo jo konfiskimi i Klinikës Medicus për interesat e sigurisë së përgjithshme, trupi gjykues konstaton si më poshtë. Edhe pse veprat penale janë kryer në lokalet e Klinikës Medicus, janë të rënda dhe të tmerrshme, nuk ka prova konkrete për të sugjeruar se aktivitetet të tilla kanë ndodhur në lokalet e Klinikës Medicus që nga bastisja e lokaleve më 4 nëntor 2008, dhe as nuk ka indikacione konkrete se veprimtari të tilla do të ndërmerren në lokalet e Klinikës Medicus në të ardhmen. Fakti i thjeshtë se i pandehuri L. D. ende e ushtron profesionin e tij në Klinikën Medicus nuk përbën tregues të mjaftueshëm. Prandaj, trupi gjykues konstaton se nuk është e nevojshme për interesat e sigurisë së përgjithshme të konfiskohen lokalet e Klinikës Medicus.

Prandaj kërkesa e prokurorit për konfiskimin e lokaleve të Klinikës Medicus të datës 29 prill 2013, duhet të refuzohet, duke parë se aktualisht nuk ka baza të njohura për mbylljen dhe konfiskimin e lokaleve të Klinikës Medicus. Rrjedhimisht, gjykata e Apelit e ndryshon aktvendimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës, P 309/10 & 340/10 të datës 25 nëntor 2013.

Ankesa e mbrojtjes miratohet dhe ankesa e PSRK-së refuzohet si e pabazuar.

### C. Vërejtjet përmbyllëse

Në lidhje me aktgjykimin e kundërshtuar të Gjykatës Themelore, Gjykata e Apelit për arsyet e shtjelluara më lartë:

pjesërisht e miraton ankesën e PSRK-së, pasi që i pandehuri S. H. është dënuar për Pikën 1, Trafikimi me Njerëz, pasi që i pandehuri A. D. është dënuar me një dënim të lartë, dhe deri sa dënimet plotësuese do të zbatohen pasi që të pandehurit do ta kryejnë dënimin e shqiptuar me burgim dhe rrjedhimisht e modifikon dispozitivin;  
i miraton ankesat e të pandehurve I. B. dhe S. D. deri sa të pandehurit I. B. dhe S. D. lirohen nga Pika 7, dhe rrjedhimisht e modifikon dispozitivin;  
i refuzon ankesat në emër të të pandehurve L. D., A. D. dhe S. H. si të pabazuara; dhe rrjedhimisht e konfirmon pjesën e mbetur të aktgjykimit të kundërshtuar;

Në lidhje me aktvendimin e kundërshtuar të Gjykatës Themelore, Gjykata e Apelit për arsyet e shtjelluara më lartë:

E miraton ankesën e F. I. në emër të subjektit ekonomik Graniti Com dhe ankesën e Linn Slattengren në emër të L. D. dhe kompanive Klinika Kardiokirurgjike Medicus dhe Ordinanca Urologjike Medicus, aq sa nuk ka bazë për t'i mbyllur dhe konfiskuar lokalet e Klinikës Medicus dhe rrjedhimisht e modifikon dispozitivin; dhe  
E refuzon ankesën e PSRK-së.

---

*Aktgjykimi i arsyetuar me shkrim është përfunduar më 22 janar 2016.*

Kryetari i kolegjit

---

Radostin Petrov  
Gjyqtar i EULEX-it

Anëtarja e kolegjit

---

Mejreme Memaj  
Gjyqtare e Kosovës

Anëtari i kolegjit

---

Dariusz Sielicki  
Gjyqtar i EULEX-it

Procesmbajtësit

---

Alan Vasak  
Zyrtar Ligjor i EULEX-it

---

Bernd Franke  
Zyrtar Ligjor i EULEX-it

**KËSHILLË LIGJORE:** I pandehuri S. H. mund të parashtojë ankesë kundër aktgjykimit në Gjykatën Supreme të Kosovës, sipas nenit 430, paragrafi 1, pika 3 i KPPPK-së. Ankesa mund të parashtrohet brenda 15 ditësh nga dita kur kopja e këtij aktgjykimi është dorëzuar.

---

**Gjykata e Apelit**  
Prishtinë

**PAKR 52/14**

**6 nëntor 2015**